



LIBËR I BARDHË

PRIORITETE DHE MEKANIZMA PËR PËRPARIMIN E BASHKËPUNIMIT
MIDIS ORGANIZATAVE CIVILE DHE MEDIAVE PËR MBROJTJEN
EFIKASE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

"Forcimi i bashkëpunimit midis organizatave civile dhe mediave për
përparimin e të drejtave të njeriut dhe të lirisë së shprehjes"

Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian

LIBËR I BARDHË

PRIORITETE DHE MEKANIZMA PËR PËRPARIMIN
E BASHKËPUNIMIT MIDIS ORGANIZATAVE CIVILE
DHE MEDIAVE PËR MBROJTJEN EFIKASE TË TË
DREJTAVE TË NJERIUT

“Forcimi i bashkëpunimit midis organizatave civile dhe mediave për përparimin e të drejtave të njeriut dhe të lirisë së shprehjes”

Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian

LIBËR I BARDHË

Prioritete dhe mekanizma për përparimin e bashkëpunimit midis organizatave civile dhe mediave për mbrojtjen efikase të të drejtave të njeriut

Botues: Media Instituti Maqedoni
Jurij Gagarin 17/1-1
1000 Shkup, Maqedoni

Për botuesin: Biljana Petkovska, drejtore e MIM-it

Redaktorë dhe autorë: Vesna Nikodinoska dhe Zoran Bojarovski

Bashkautorë:

Neda Çallovska dhe Artan Murati, *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM*

Filip Stojanovski, *Fondacioni Metamorfozis*

Margarita Gulevska, *Hapni Dritaret*

Kristina Vasilevska, *Multikultura*

Maria Todorovska, *Porta e hapur - „La strada“*

Daniel Kallajxhieski dhe Maria Matovska, *Asociacioni për edukim shëndetësor dhe humtim H.E.R.A.*

Natasha Dimitrovska, *Këshilli Nacional për Barazi Gjinore (KNBGJ)*

Zoran Bikovski, *OJQ „KHAM“*

Lulzim Haziri, *Qendra për zhvillimin e mediave të bashkësive MEDIUM*

Frosina Dimeska, *Nova Makedonija*

Nazim Rashidi, *Diversity media*

Ilir Ajdini, *Qendra për liri - Civil*

Redaksia: Biljana Petkovska dhe Petrit Saraçini

Përkthimi dhe lektura shqip: Nazif Zejnullahu

Disenji dhe përgatitja teknike: Jane Stefanov

Shtypi: Vinsent Grafika

Tirazhi: 50 ekzemplarë

Libri i Bardhë është përgatitur në kuadër të projektit “Forcimi i bashkëpunimit midis organizatave civile dhe mediave për përparimin e të drejtave të njeriut dhe të lirisë së shprehjes”, të cilin e realizon Media Instituti i Maqedonisë, me mbështetjen e Bashkimit Evropian përmes Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR).

Përmbajtjet e Librit të Bardhë në asnjë mënyrë nuk i reflektojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PARATHËNIE: PËRSE SHKRUHET KY LIBËR I BARDHË?

Problemet e bashkëpunimit midis OC dhe mediave janë treguar shumë herë në vitet e kaluara, por edhe përkundër kësaj, në relacionet ndërmjet këtyre dy sektorëve nuk po shënohet përparim i dukshëm. Qëllimi kryesor i këtij Libri të Bardhë është që të shkojë një hap më përpara – jo vetëm t’i përcaktojë problemet në bashkëpunimin midis dy sektorëve, por dhe t’i tregojë edhe mënyrat e përparimit dhe të intensifikimit të atij bashkëpunimi, me qëllim promovimin dhe përparimin e të drejtave të njeriut. Përmes një përshkrimi të shkurtër të gjendjeve dhe prioriteteve në gjashtë sfera specifike të të drejtave të njeriut – të drejtat civile dhe politike, të drejtat e grave, të romëve dhe të bashkësive të tjera etnike, të bashkësive të marginalizuara (persona me pengesa zhvillimore dhe pjesëtarë të popullatës LGBTI), të rinjtë dhe të drejtat digjitale – dokumenti ka për qëllim që t’i nxit mekanizmat e komunikimit dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë midis OC dhe mediave dhe, në këtë mënyrë, të sigurojë shikim dhe ndikim më të madh të OC në publik.

Libri i Bardhë përfshin vetëm disa aspekte nga sfera e gjerë e të drejtave të njeriut, që ishin përcaktuar në pajtim me kategorizimin e organizatave që u paraqitën në Thirrjen publike të MIM për pjesëmarrje në projekt. Ky dokument është përpiluar me ndihmën e një grupi ekspertësh nga organizatat civile dhe mediat, të cilët vunë në dispozicion përvojën dhe diturinë e tyre. Në faza të ndryshme të prodhimit të këtij dokumenti kontribuan përfaqësues këto organizata civile: *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM*, *Këshilli Nacional për Barazi Gjinore (KNBGj)*, *Porta e Hapur –“La Strada”*, *Hapni Dritaret*, *Metamorforzis*, *Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Huluntim H.E.R.A.*, *KHAM*, *Multikultura*, *Qendra për Zhvillimin e Mediave të Bashkësive MEDIUM*, *Qendra për Liri – Civil*, si dhe gazetarë e redaktorë nga: TV Alfa, Nova Makedonija dhe Diversiti Media.

Libri i Bardhë duhet të shërbejë edhe si një vegël e demokracisë participative, për të cilën gjë në procesin e përgatitjes së tij u përpoqëm të sigurojmë inkluzivitet më të madh të sektorit civil. Qëllimi përfundimtar i dokumentit dhe i këtij projekti është respektimi i të drejtave të njeriut të bëhet imperativ i shoqërisë civile dhe i aktivizmit qytetar në Maqedoni.

Vesna Nikodinoska,

udhëheqëse e programeve në Media Institutin Maqedoni

1

KAPITULLI



HYRJE

I.1. ORGANIZATAT CIVILE DHE MEDIAT

Bashkëpunimi midis mediave dhe organizatave civile është me rëndësi thelbësore për zhvillimin socio-ekonomik të shteteve, sidomos në shoqëritë që synojnë drejt një demokracizimi më të madh, siç është kjo e jona¹. Të dy sektorët kanë rol kyç në balancimin e fuqisë së strukturave të pushteteve përmes krijimit të presionit për një transparencë dhe llogaridhënie më të madhe, si dhe në promovimin e interesit publik dhe të qeverisjes së mirë. Edhe organizatat civile edhe mediat duhet të kenë rol integruar në shoqëritë që karakterizohen me shumëllojshmëri mbi disa baza, me të cilën gjë do të promovojnë vlera pozitive dhe tolerancë. Për këtë shkak, nevoja për dialog, për bashkëpunim dhe mirëbesim të vazhdueshëm në relacionet midis të tre sektorëve – sektorit civil, mediave dhe pushteteve, bëhet domosdoshmëri në një shoqëri demokratike.

Në Maqedoni, edhe krahas numrit të madh të organizatave civile (rreth 4.700 në 2012), mund të thuhet që një numër i kufizuar, përkatësisht mezi nja 100 janë të pranishme aktivisht në media. Shkaqet për dukjen e dobët të OC dhe nivelin e pavolitshëm të komunikimit janë shumështresore (shih Aneksin 1 të Librit të Bardhë). Pjesëtarët e sektorit civil dhe të mediave e përshkruajnë bashkëpunimin si funksionalisht të pamjaftueshëm dhe shpeshherë të partizuar, ndërkohë që të dy sektorët kritikohen ndërmjet vete për qasje josistematike ndaj temave, për mungesë iniciative dhe jokonzistencë në relacione, përkatësisht për pasivitet gjatë promovimit ose imponimit të temave. Plus kësaj, ndryshimet radikale në teknologjitë informative dhe në mënyrat e komunikimit në dhjetë vitet e kaluara, si dhe proceset globalizuese, kontribuan në ndërlikimin, por dhe në rritjen e dinamikës në relacionet midis organizatave civile dhe mediave edhe në nivel botëror, por edhe në nivel nacional.

Sferat e të drejtave të njeriut e të mediave gërshetohen në dy pika. Nga njëra anë, një pjesë e madhe nga raportimet mediale iu referohen çështjeve të cilat në mënyrë direkte ose indirekte janë të lidhura me të drejtat e njeriut, ndërsa nga ana tjetër, qëndron fakti që liria e mediave, vetëm për vetëm, përbën të drejtën e njeriut. “Mediat konvencionalisht janë një nga mekanizmat me të cilët qytetarët ‘e mbajnë’ qeverinë të përgjegjshme”, thuhet në botimin *“Gazetaria, mediat dhe sfida e raportimit për të drejtat e njeriut.”*²

Mund të thuhet që tek opinioni më i gjerë në Maqedoni, bile edhe te gazetarët, nuk ka njohje të kënaqshme të të drejtave të njeriut dhe të mekanizmave për mbrojtjen nga keqpërdorimet eventuale. Ky konkluzion ka dalë nga hulumtimi që bëri MIM me përfaqësuesit e organizatave civile dhe të mediave (shih Aneksin 1 të Librit të Bardhë). Sipas pjesëmarrësve në intervista, kjo rezulton kështu shkak i informimit të pamjaftueshëm të qytetarëve si nga ana e mediave, ashtu dhe nga ana e sistemit arsimor. Nga ana tjetër, ndërkaq, mediat i trajtojnë çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut në

1 TACSO (2012) Hallka që mungon. Sarajevë: Zyra rajonale e TAKSO. Arritur përmes: <http://www.tasco.org/documents/reports/?id=8589>

2 International Council of Human Rights (2002) Media, Journalism and Challenge of human rights reporting. Arritur përmes: http://www.ichrp.org/files/reports/14/106_report_en.pdf

mënyrë të pamjaftueshme, e ndonjëherë edhe të gabuar, nuk janë të interesuara për sektorin civil përgjithësisht, ndërsa edhe ndikimet politike ndaj mediave dhe politikës redaktuese janë shkaqet se përse disa organizata civile, iniciativa dhe tema janë injoruar, përkatësisht marginalizuar nga ana e mediave. Vërejtjet në llogari të organizatave civile që punojnë në sferën e të drejtave të njeriut kanë të bëjnë me shkathtësinë, këmbënguljen dhe kreativitetin e tyre të pamjaftueshëm gjatë qasjes në media, me qëllim që të nxisin interesimin e tyre për punën që bëjnë.

Projekti Mbështetje teknike për organizatat e shoqërisë civile – TACSO në vitin 2012 e realizoi hulumtimin me titull “Hallka që mungon”³, që i përfshiu vendet nga rajoni IPA, përfshi dhe Maqedoninë. Në hulumtim thuhet se relacionet midis OC dhe mediave janë të ngarkuara shkak i mungesës së dijes dhe mirëkuptimit për sektorin tjetër, si dhe nga kapacitetet e dobëta të të dy sektorëve që të realizojnë relacione me të tjerët. Në konkluzionet e hulumtimit thuhet se mediat nuk kanë vetëdije të zhvilluar mjaftueshëm për potencialin, kapacitetin dhe rëndësinë e OC për shoqërinë; të dyja palët kanë mungesë procedurash, standardesh dhe strategjish sesi t’u qasen OC ose mediave – derisa OC iu mungojnë aftësitë për qasje sistematike ndaj mediave, mediave iu mungon njohuria gjithëpërfshirëse për sektorin civil, gjë që krijon mosbesim të përgjithshëm për to.⁴

Mbulimi mediatik i sektorit civil me vite mbetet si problem me të cilin përballen OC. Edhe në Indeksin e vetëqëndrueshmërisë të organizatave civile për 2011 të USAID,⁵ përfaqësuesit e sektorit civil kanë theksuar se interesimi mediatik për mbulimin e aktiviteteve të tyre varet nga prania e personave të lartë publik, si ministra dhe kryetar komunnash, si dhe ajo që mbulimi mediatik është më i mirë në nivel lokal sesa në nivel nacional. Në Raport theksohet edhe vërejtja e OC se mbulimi mediatik dhe vetëdija për punën e tyre ka rënë pas vitit 2005, kur u bë reforma e Servisit publik, me të cilën serviset lokale e ndërprejnë punën. Mediat komerciale, ndërkaq, sipas analizës tregojnë më pak interes për aktivitetet dhe ngjarjet e shoqërisë civile. OC kanë besim të vogël te mediat për shkak të pavarësisë së tyre të kufizuar, thuhet në raport. Në Raportin e USAID për vitin 2012,⁶ ndërkaq, potencohet se mediat vazhdojnë të promovojnë stereotipa negativ për OC dhe ta nënçmojnë rolin e tyre të partneritetit. Sipas të njëjtit burim, perceptimi i OC nga ana e Qeverisë, por dhe nga publiku në përgjithësi, mbetet negativ, përkatësisht i pakënaqshëm. Perceptimi në publik për OC, ndërkaq, është se ato funksionojnë që t’u shërbejnë interesave private, thuhet në hulumtimet e USAID-it.

3 TACSO (2012) Hallka që mungon. Sarajevë: Zyra rajonale e TAKSO. Arritur përmes: <http://www.tacso.org/documents/reports/?id=8589>

4 Ibid

5 USAID (2011) Indeksi i vetëqëndrimit të organizatave civile për Evropën Qendrore dhe Jugore dhe Euroazinë. Arritur përmes: <http://www.usaid.gov>

6 USAID (2012) Indeksi i vetëqëndrimit të organizatave civile për Evropën Qendrore dhe Jugore dhe Euroazinë. Arritur përmes: <http://www.usaid.gov/europe-urasia-civil-society/cso-sustainability-2012/macedonia>

I.2. KORNIZA NORMATIVE DHE MEKANIZMAT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Maqedonia ka një kornizë dhe mekanizma normativ të kënaqshëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, megjithatë implementimi i ligjeve, si dhe kapaciteti dhe funksionimi i institucioneve kompetente shpeshherë janë vërejtjet që drejtohen nga ana e organizatave dhe institucioneve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga vendi dhe bota.

Raportet relevante tregojnë më shumë pika “të dobëta” në sferën e të drejtave të njeriut, në mesin e të cilave si më të përsëritura janë ato që lidhen me sundimin e të drejtës dhe sistemin gjyqësor, implementimin dhe mungesat e ligjeve (siç është, për shembull, Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi); gjendja në burgje dhe në entet edukative – përmirësuese; gjendja me romët në përgjithësi, e sidomos me gratë dhe vajzat e kësaj bashkësie etnike; trajtimi i grave – viktimat të dhunës; shkelja e lirisë së mediave, diskriminimi ndaj pjesëtarëve të popullatës LGBTI etj.⁷

Problem shtesë në këtë sferë është niveli i ulët i vetëdijes për të drejtat e njeriut në publik, midis segmenteve të caktuara të tij që përfshijnë një tip të caktuar të drejtash, si dhe midis disa institucioneve të caktuara dhe profesionistëve në fokusin e të cilëve është mbrojtja e të drejtave të njeriut. Kjo, sipas hulumtimit të *Media Institutit Maqedoni (MIM)*, të cilin e realizoi me përfaqësues nga organizatat civile dhe mediat (shih Aneksin 1 të Librit të Bardhë), ka të bëjë me më shumë faktorë, mes të cilëve edhe me shikimin e dobët të temave që lidhen me të drejtat e njeriut në media, por dhe sistemin arsimor, ku nuk ka përmbajtje të mjaftueshme që lidhen me këtë sferë.

Në pikëpamje të kornizës normative dhe institucionale, Maqedonia i ka ratifikuar instrumentet kryesore që lidhen me të drejtat e njeriut në nivel ndërkombëtar dhe evropian, siç janë konventat e Kombeve të Bashkuara, të Këshillit të Evropës, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe të UNESCO-s. Këto dokumente ndërkombëtare, me ratifikimin e tyre janë bërë pjesë e legjislacionit vendor dhe qëndrojnë më lart në raport me ligjet vendore. Për këtë shkak, rendi juridik dhe praktika e gjyqeve, e organeve publike dhe shtetërore, duhet të harmonizohen me këto standarde ndërkombëtare.⁸ Parimet që dalin nga këto dokumente janë përcaktuar me Kushtetutë, e cila garanton respektimin e lirive dhe të të drejtave bazë të njeriut dhe të qytetarit. Akti më i lartë konstitutiv përmban një listë të tërë të drejtash themelore civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale, të cilat janë shkrirë në legjislacionin vendor.

Maqedonia, si vend-anëtar i Kombeve të Bashkuara (KB), e ka për obligim që në çdo 4 vjet të dorëzojë raport për gjendjet me të drejtat e njeriut në Këshillin për të Drejtat e Njeriut të KB. Në periudhën prej vitit 2009, kur raportoi për herë të fundit, Maqedonia ka ratifikuar dhe është aderuar në më shumë marrëveshje ndërkombëtare, të cilat duhet

7 Amnesty Interneshënell (2013) „Maqedonia: Kontribut në Raportin periodik universal të KB.“ Arritur përmes: <http://www.amnesty.org/en/library/asset/EUR65/003/2013/en/8a9c56b1-0967-43e4-8844-ca37a8e45a88/eur650032013en.pdf>

8 UNDP (2009) Korniza ligjore ndërkombëtare dhe nacionale për të drejtat e njeriut për Maqedoni. Fq. 9. Shkup: UNDP

të kontribuojnë në përparimin e gjendjeve në këtë sferë. Njëri prej ligjeve më të rëndësishëm që është nxjerrë në periudhën e kaluar katërvjeçare, Ligji për mbrojtjen dhe pengimin e diskriminimit (2010), paraqet një hap përpara në vënien e rregullativës për adresimin e këtij problemi me të cilin përballet edhe shoqëria maqedonase. Megjithatë, sipas dëftimeve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare, ligji ka mangësi në raport me përmbushjen e disa standardeve ndërkombëtare, sidomos të atyre që kanë të bëjnë me bashkësinë LGBTI. Në vitin 2012 u nxor edhe Ligji për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave, i cili i precizoi përgjegjësitë e palëve të prekura dhe i obligoi pushtetet që të miratojnë plane dhe buxhete strategjike që kanë të bëjnë me çështjet gjinore. Në mesin urdhëresave më të rëndësishme ligjore, në vitin 2012 ishin miratuar edhe amendamentet në Ligjin për marrëdhënie në punë, me të cilat në mënyrë eksplicite ndalohet diskriminimi kundër grave punëtore gjatë kohës së shtatzënisë, gjatë rolit amnor dhe prindëror, pavarësisht nga tipi ose kohëzgjatja e punës. Në lidhje me lirinë e shprehjes u nxor Ligji për dekriminalizimin e shpifjes dhe të ofendimit, mirëpo liritë e mediave edhe më tej mbeten të kërcënuara nga legjislacioni restriktiv dhe nën ndikimin e qendrave me fuqi politike dhe ekonomike. Në periudhën e kaluar janë miratuar edhe më shumë strategji dhe plane nacionale, si për shembull për barazi gjinore, për pengimin e tregtisë me njerëz dhe migrantë, për mbrojtjen nga dhuna në familje, për promovimin e statusit të gruas rome. Megjithatë, duke i marrë parasysh resurset e kufizuara me të cilat ballafaqohen institucionet, implementimi i këtyre dokumenteve duhet të ndiqet në mënyrë të vazhdueshme.

Kur flitet për **trupat dhe mekanizmat** për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel nacional, Gjykata Kushtetuese, veç tjerash, ka kompetenca që t'i mbrojë liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit sa i takon lirisë së bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe të shprehjes publike të mendimit, të bashkimit dhe të veprimit politik e të ndalimit të diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të gjinisë, racës, përcaktimit fetar, nacional, social dhe politik.

Në Kushtetutë është paraparë edhe institucioni Avokati i Popullit (Ombudsman), i cili i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve, kur ato shkelen nga ana e organeve të administratës shtetërore dhe nga organe e organizata të tjera që kanë autorizime publike. Në kuadër të Avokatit të Popullit është formuar edhe Mekanizmi preventiv nacional, detyrë e të cilit është parandalimi i torturës dhe llojet tjera të veprimit ose të dënimit të egër, jonjerëzor dhe nënçmues. Në periudhën e kaluar, po ashtu në kuadër të Zyrës së Ombudsmanit, ishte formuar Seksioni për Mbrojtjen e Qytetarëve nga Diskriminimi, ndërkohë që është themeluar edhe trupi i pavarur – Komisioni për Pengimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Nga trupat tjerë nacionalë që janë kompetentë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave duhet të theksohen edhe Komisioni i Përherëshëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit dhe Komiteti për Marrëdhënie midis Bashkësive në kuadër të Kuvendit të RM, Komisioni për Mundësi të Barabarta të Grave dhe të Burrave, Komisioni Nacional për Luftë Kundër Tregtisë me Njerëz dhe Migrim Ilegal, koordinuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Komisioni Nacional për të Drejtat e Fëmijëve, Komisioni për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik, si dhe trupa

të tjerë midis-dikasteresh dhe brenda-dikasteresh për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Nga organizatat joqeveritare të vendit që merren me mbrojtjen e aspekteve të ndryshme të të drejtave të njeriut më aktive janë *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM*, për aspekte të ndryshme të lirive civile dhe politike, *Ambasada e fëmijëve „Megjashi“*, e cila angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, koalicioni për të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara *Porta e Hapur - „La Strada“*, që punon me viktime të tregtisë me njerëz, *Hapni Dritaret*, si e vetmja organizatë e cila merret me promovimin e teknologjisë asistive si vegël për nxitjen e inkluzionit të personave me pengesa zhvillimore, *Asociacioni për edukim shëndetësor dhe për hulumtim – H.E.R.A*, *Këshilli Nacional për Barazi Gjinore (KNBGJ)*, që mbulon aspekte të ndryshme lidhur me të drejtat e grave, *KHAM* dhe *Roma S.O.S.* punojnë në drejtim të përmirësimit dhe mbrojtjes të të drejtave të romëve, *Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni (FSHHM)*, i cili është aktiv në sfera të ndryshme të të drejtave të njeriut, *Metamorfozis*, që angazhohet në promovimin e të drejtave digjitale, *Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë*, *Media Instituti Maqedoni* dhe *Qendra për Zhvillimin e Mediave*, që punojnë në drejtim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave mediatike etj.

Në nivelin ndërkombëtar, organizata dhe institucione të ndryshme i ndjekin gjendjet me të drejtat e njeriut. Kështu, Organizata e Kombeve të Bashkuara, e cila i integron objektivat për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në thelbin e vet, ka krijuar një strukturë komplekse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel botëror, me mbështetje para së gjithash në Kartën e KB, pastaj në deklarata joobligative, pakte dhe konventa juridikisht obligative dhe aktivitete të tjera për përparimin e gjendjes me të drejtat e njeriut në korniza globale. KB ka në dispozicion më shumë trupa dhe mekanizma për monitorimin e vendeve-anëtare në sferën e të drejtave të njeriut, siç janë, për shembull, raportet universale periodike që i përgatit shteti-anëtar, raportues specialë për ndonjë tip të caktuar të drejtash ose komitetet për ndjekjen e çdo konvente të veçantë. Qeveritë e të gjitha vendeve-anëtare të KB e kanë për obligim që t'i dorëzojnë raport nacional Këshillit për të Drejtat e Njeriut të KB në çdo 4 vjet, për atë se cilat masa janë ndërmarrë për përmirësimin e situatës me të drejtat e njeriut në vendet e tyre dhe për përmbushjen e obligimeve të tyre sipas sferave. Maqedonia duhet ta dorëzojë raportin e radhës në fillim të vitit 2014.

Komisioni Evropian në raportet e tij vjetore për progresin e shtetit rregullisht ndalet në gjendjen e të drejtave të njeriut, sikurse dhe Stejt Departamenti, ndërsa Këshilli i Evropës ka themeluar Komisionin Evropian për Luftë kundër Racizmit dhe Jotolerancës (EKRI, ang. ECRI), si trup i pavarur për mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut, special për çështje që lidhen me racizmin dhe jotolerancën.

Plus kësaj, më shumë organizata përgatitin të a.q. „raporte në hije“ (ang. shadow reports) për aspekte të ndryshme nga sfera gjegjëse, si për shembull *Amnesti Interneshënell* dhe *Hjuman Rajts Uoç*, organizata udhëheqëse ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, *Fridom Haus* dhe *Reporterët pa Kufij* për Lirinë e Mediave, *Asociacioni Ndërkombëtar për Personat LGBTI* (ang. ILGA), për të drejtat e pjesëtarëve të këtyre

grupeve, *Asociacioni për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave* (ang. ESE), *Qendrës Evropiane për të Drejtat e Romëve* (ang. ERRC) etj.

1.3. GJENDJA ME TË DREJTAT E NJERIUT NË MAQEDONI

Avokati i Popullit ka vërejtur një rritje të vazhdueshme të numrit të parashtrësive nga ana e qytetarëve në katër vitet e kaluara, gjë që rezultoi jo vetëm nga informimi më i shtuar i qytetarëve për liritë dhe të drejtat e tyre, por edhe nga niveli i ulët i respektimit, realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe të dobësive gjatë punës së administratës publike dhe institucioneve dhe organeve të tjera publike.⁹ Numri më i madh i parashtrësive, 948 (21,81%) janë dorëzuar nga sfera e të drejtave konsumatore, pastaj nga gjyqësia (710 ose 16,34%), pastaj nga marrëdhëniet në punë, më tej parashtrësia që kanë të bëjnë me kushtet në entet ndëshkimore-përmirësuese dhe edukuese-përmirësuese, marrëdhëniet pronësore-juridike, sigurimin pensional dhe invalidor, mbrojtjen sociale, veprimet policore, mbrojtjen shëndetësore etj.¹⁰ Nga numri i përgjithshëm i shkeljeve që ka konstatuar AP në vitin 2012, sugjerimet e dëftuara, rekomandimet dhe reagimet më shpesh nuk i kanë respektuar Ministria e Punëve të Brendshme, njësitë e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, shërbimet dhe entet, Ministria e Financave, Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale etj.¹¹

Gjyqësia, realizimi i të drejtave themelore politike dhe civile mbeten pikat e dobëta të demokracisë maqedonase, e cila gjë konfirmohet në raportet e më shumë organizatave dhe institucioneve relevante ndërkombëtare dhe vendore. Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e RM i vitit 2013¹² bën të ditur se procesi reformativ në gjyqësi është i rrumbullakuar, por se është e domosdoshme që në praktikë të zbatohen standardet evropiane lidhur me pavarësinë dhe kualitetin e gjyqësorit.

Sipas Raportit të Stejt Departamentit për gjendjet me të drejtat e njeriut në Maqedoni të vitit 2012, problem kyç në këtë sferë ka qenë mospushtetë e Qeverisë që tërësisht ta respektojë sundimin e të drejtës, „që shihet në mospushtetë e saj për t’i ndjekur procedurat parlamentare, në përzierjen në gjyqësi dhe media, ndjekjen selektive të kundërshtarëve politik të liderëve të vendit, si dhe nivelet e ndjeshme të korrupsionit të pushtetit dhe mosdënimin e policisë“.¹³

Edhe *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut* thekson se pushteti gjyqësor është nën ndikimin e vazhdueshëm të pushtetit ekzekutiv, për të cilën gjë gjyqet nuk arrijnë

9 Avokati i Popullit (2012) Raporti vjetor për shkallën e sigurimit, respektimit, përparimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Fq. 45-46. Arritur përmes: www.ombudsman.mk

10 Ibid. Fq. 23-24

11 Ibid. Fq. 33

12 Komisioni Evropian (2013) Raporti i progresit për Republikën e Maqedonisë. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/mk_rapport_2013.pdf

13 Stejt Departament (2012) Raport për praktikimin e të drejtave të njeriut në Maqedoni. Arritur përmes: <http://www.state.gov/documents/organization/204523.pdf>

t'i mbrojnë të drejtat e qytetarëve dhe as të sigurojnë gjykim fer e të drejtë në një pjesë të procedurave.¹⁴ Në sferën e të drejtave themelore, institucionet relevante siç janë Komisioni Evropian, Avokati i Popullit dhe Komiteti i Helsinkit, paralajmërojnë edhe për ekzistimin e rasteve të torturës dhe të veprimit të keq të të punësuarve nëpër burgje.

Lidhur me **të drejtën e grave dhe barazinë gjinore**, në vitin 2012 u nxor Ligji i ri për barazi midis grave dhe burrave. Megjithatë, institucionet ndërkombëtare që e ndjekin këtë sferë, si për shembull komitetet kompetente të KB-së, shprehen të shqetësuara se ka mungesë transparence, autorizim gjatë marrjes së vendimeve dhe koordinim të institucioneve shtetërore, që tregon se shteti nuk i jep përparësi parimit të barazisë. Në raportet e trupave të KB-së dhe të Komisionit Evropian bëhet e ditur edhe mbijetimi i stereotipave tradicionalë që ekzistojnë në shoqërinë maqedonase në raport me rolet e burrit dhe të gruas në familje dhe në shoqëri, si dhe të problemit me mediat të cilat vazhdimisht transmetojnë pamje stereotipe, e ndonjëherë edhe nënçmuese për gratë. Kjo reflektohet në mënyrë plotësuese ndaj rolit të grave në politikë, në ekonomi dhe në jetën e përditshme.

Komisioni Evropian në vitin 2012 ka notifikuar përpjekje të caktuara për zgjidhjen e problemeve shëndetësore të grave, por dhe atë se një numër i vogël grash kanë leverdi nga përmirësimet për shkak të kufizimeve financiare. „Mbështetja e pamjaftueshme e Planit aksional nacional për gruan rome e bën realizimin e tij pothuajse të pamundur. Pjesëmarrja e grave në marrjen e vendimeve në shoqëri mbetet e ulët, sidomos në nivel lokal,”¹⁵ thuhet në raportin e vitit 2012. Në vitin 2013, Komisioni e pohon ekzistimin e zakoneve, traditave dhe stereotipave diskriminuese në shoqëri. Ai konstaton se Sektori për Mundësi të Barabarta në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale ka mungesë resursh adekuate, si dhe ajo që Strategjia nacionale për të luftuar dhe për të penguar dhunën në familje (2012-2015) po implementohet ngadalë. Në praktikë shpesh ka huti midis koncepteve për mosdiskriminim dhe për mundësi të njëjta, që tregon nevojën e ngritjes së vetëdijes publike për të dy çështjet. Në një situatë veçanërisht të rëndë janë gratë që u takojnë grupeve të marginalizuara dhe bashkësive minoritare, për shkak se ato i nënshtrohen diskriminimit të dyfishtë.

Sipas Komisionit Evropian, përparimi në raport me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të **bashkësive minoritare** është penguar nga resurset e kufizuara financiare dhe nga bashkëpunimi joadekuat midis institucioneve kompetente, me ç'rast theksohet nevoja për më tepër aktivitet në raport me implementimin e politikave, e sidomos të strategjisë për romët.¹⁶ Romët, si njëra prej bashkësive më të lëndueshme, edhe më tej mbeten në margjinat e shoqërisë edhe krahas disa hapave dhe obligimeve që Qeveria i ndërmerr për përmirësimin e gjendjeve. Është sidomos alarmante gjendja me fëmijët në rrugë dhe

14 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM (2012) Raporti vjetor i Komitetit të Helsinkit të RM për gjendjet në sferën e të drejtave të njeriut në RM në vitin 2012. Arritur përmes: www.mhc.org.mk

15 Komisioni Evropian (2013) Raporti i progresit për Republikën e Maqedonisë. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/mk_rapport_2013.pdf

16 Komisioni Evropian (2013) Raporti i progresit për Republikën e Maqedonisë. Fq. 46. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/mk_rapport_2013.pdf

me arsimin e tyre, numri i stërmadh i fëmijëve në shkollat speciale, sigurimi shëndetësor, të drejtat e grave dhe të vajzave nga bashkësia etnike rome dhe diskriminimi i dyfishtë me të cilin ato ballafaqohen, kushtet substandarde të jetesës. *Amnesti Interneshënell* në kontributin që ka bërë për Raportin periodik universal të KB, që pritet të dalë në vitin 2014, ka notifikuar disa hapa në përmirësimin e të drejtave të bashkësisë rome, por edhe atë se Qeveria nuk po angazhohet mjaftueshëm për implementimin e Planit aksional në kuadër të iniciativës rajonale Dekada e inkluzionit të romëve.

Trende brengosëse janë shënuar në raport me realizimin e të drejtave të njeriut të **bashkësive të marginalizuara**, si dhe në raport me realizimin e rregullativës ekzistuese e cila i rregullon marrëdhëniet në shoqëri me këto bashkësi. Në vitin 2012 dhe në vitin 2013 në qendër të sulmeve të disa grupeve konservatore, por edhe të institucioneve publike të caktuara, kanë qenë bashkësitë me orientim të ndryshëm seksual (bashkësia LGBTI), si dhe të varurit nga narkotikët. *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut* konkludon se edhe në vitin 2012 pjesëtarët e bashkësisë LGBTI janë ballafaquar me paragjykime juridike dhe sociale, me diskriminim, si dhe me një mjedis jashtëzakonisht homofobik, që ua rëndon qasjen në legjislacion dhe në mbrojtjen juridike. Raporti konstaton se këta njerëz nuk llogariten për qytetarë me të drejta dhe liri të njëjta sipas dhe para ligjeve të shtetit, ndërsa Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, edhe përkundër dëftimeve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare, nuk përmban dispozita për mbrojtje nga diskriminimi mbi bazë të orientimit seksual.¹⁷

Personat me pengesa zhvillimore vazhdojnë të ballafaqohen me stereotipa dhe paragjykime, por dhe me diskriminim kur ata e kërkojnë mbrojtjen shëndetësore, pastaj në arsim, punësim, në transportin publik dhe gjatë shërbimeve të tjera, ndërkohë që shteti bën shumë pak lëvizje në raport me implementimin e Strategjisë nacionale për të drejta të njëjta të personave me pengesa zhvillimore 2010-2018.

Në kategoritë e qytetarëve që mbeten në margjinat e interesave të pushteteve lokale dhe qendrore shumë shpesh janë edhe **të rinjtë** në moshën prej 15 deri 24 vjeç, të cilët ballafaqohen me probleme në kuadër të procesit arsimor, punësimit, pjesëmarrjes në krijimin e politikave që kanë të bëjnë me ta etj. Komisioni Evropian në raportin e vitit 2013 ka shënuar se numri i studentëve të regjistruar në fakultete është rritur, gjithashtu dhe numri i të diplomuarve, megjithatë konstaton se progresi i përgjithshëm në sferat e arsimit, stërvitjes, të rinjve dhe kulturës mbetet i kufizuar.

Të drejtat digjitale janë përmbledhje e të drejtave themelore të njeriut në rrethimin digjital dhe përfshin të drejtën e privatësisë, të drejtën e mbrojtjes të të dhënave personale, të drejtën e gjuhës dhe të shprehjes së lirë, të drejtës së autorit, të drejtës së informimit e të ngjashme. Kohëve të fundit gjithnjë e më shumë aktualizohen këto të drejta, duke marrë parasysh penetrimin rapid të teknologjive informative në jetën e përditshme dhe profesionale, si dhe numrin e qytetarëve që i shfrytëzojnë ato.

¹⁷ Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në RM (2012) Raporti i Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në RM për vitin 2012. Fq. 43. Arritur përmes: www.mhc.org.mk

I.4. AMBIENTI SHOQËROR-POLITIK KU REALIZOHEN TË DREJTAT E NJERIUT

Proceset shoqërore nëpër të cilat kalon shteti në dhjetë vitet e fundit në masë të madhe ndikojnë në realizimin e të drejtave të njeriut. Në ato procese i veçantë është roli i fenomeneve të caktuara shoqërore-politike, siç janë diskriminimi, politizimi dhe partizimi, liria e gjuhës dhe e shprehjes, si dhe liria e mediave.

A. Brengos fakti se **diskriminimi** në Maqedoni në vitet e kaluara ka shënuar trend rritjeje. Hulumtime të ndryshme detektojnë diskriminim mbi baza të ndryshme, me ç'rast më të shpeshta janë ai etnik, seksual, gjinor, ndërsa kohëve të fundit rritje po shënon diskriminimi mbi bazë të përcaktimit politik. Në vitin 2010 ishte nxjerrë Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa ishte themeluar edhe trupi i pavarur Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe Seksioni për Pengimin e Diskriminimit në kuadër të institucionit Avokat i Popullit. Raportet e organizatave ndërkombëtare konstatojnë se Komisioni ballafaqohet me deficit financiar dhe të kuadrove, dhe se ai duhet ta rrisë transparencën dhe aktivitetin e tij në publik, me qëllim që ta parandalojë diskriminimin dhe ta rrit mirëkuptimin për Ligjin për antidiskriminim.¹⁸

Edhe pse Maqedonia i plotëson obligimet ndaj organizatave ndërkombëtare sa i përket harmonizimit të rregullativës dhe themelimit të trupave për mbrojtjen nga diskriminimi, komitetet kompetente në kuadër të KB shprehen të shqetësuara se shteti nuk arrin që në mënyrë eksplicite ta pengojë diskriminimin mbi bazë të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor,¹⁹ ndërsa Ligji nuk përfshin sfera si banimi, mbrojtja shëndetësore dhe qasja në servise. Raportet e komiteteve të KB bëjnë të ditur ekzistimin e diskriminimit me shtrirje të gjerë në më shumë sfera: ndaj grave, sidomos ndaj grave dhe vajzave rome dhe pjesëtare të bashkësive të tjera etnike, si dhe grave nga viset rurale, diskriminim me rrënjë të thella mbi vija etnike, diskriminim mbi bazë të orientimit seksual, përcaktimit politik, diskriminim të personave me pengesa shëndetësore, por dhe të fëmijëve që u takojnë bashkësive të tjera etnike, sidomos romëve, pastaj fëmijëve në institucione, në rrugë, fëmijëve me pengesa zhvillimore dhe fëmijëve që janë në konflikt me ligjin.²⁰

Amnesti Interneshënell në raportin e vet në hije bën vërejtje se Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk është i financuar mjaftueshëm, nuk ka mjaft kompetenca, kapacitet dhe ekspertizë për të kryer punën e vet. Plus kësaj, disa prej vërejtjeve bëjnë të ditur se ka përputhje dhe përzierje kompetencash ndërmjet Komisionit dhe Seksionit në kuadër të Avokatit të Popullit.²¹ Në prill të vitit 2013 Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskri-

18 Komisioni Evropian (2012, 2013) Raporti i progresit për Republikën e Maqedonisë. Arritur përmes: <http://ec.europa.eu>

19 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit të Grave (CEDAW) (2013) Vërejtje përmbyllëse në raportin periodik të katërt dhe të pestë të RM miratuar nga Komiteti në sesionin e 54-të. Paragrafi 10. Arritur përmes: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cedaw/cedaws54.htm>

20 Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve (2010) Vërejtje përmbyllëse për RM. Paragrafi 26. Arritur përmes: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/CRC.C.MKD.CO.2.doc>

21 Amnesti Interneshënell (2013) „Maqedonia: Kontribut në raportin periodik universal të KB.“ Arritur përmes: www.amnesty.org

minimi kritikoi Komisionin për atë se çfarë kishte bërë ose çfarë nuk kishte bërë në raste të caktuara të diskriminimit të paraqitur.²²

Avokati i Popullit ka ndërmarrë një sërë aktivitete për të informuar publikun me diskriminimin gjatë vitit 2012, por dhe krahas kësaj ka konstatuar se “qytetarët në mënyrë të pamjaftueshme i njohin format e diskriminimit dhe ende në një numër të vogël i paraqesin rastet e këtilla”, bile dhe tek institucionet nuk ka vetëdije të mjaftueshme për nevojën e trajtimit të njëjtë ose për mbrojtjen nga diskriminimi.²³

Në vitin 2012 nuk ka pasur asnjë rast gjyqësor për përcaktimin e diskriminimit, që është indikator për vetëdijen e ulët të qytetarëve për mekanizmat e mbrojtjes nga diskriminimi. Hulumtimet bëjnë të ditur se pjesëtarët e policisë shpeshherë i trajtojnë më keq shfrytëzuesit e drogës, punëtorët seksual ose romët, ndërkohë që gjyqet “janë mjaft të kujdesshme kur kanë raste të kinse diskriminimit, për shkak se hyjnë në një zonë të panjohur”.²⁴ Ombudsmeni nga praktika ka vërtetuar se diskriminimi më shpesh është i pranishëm në sferën e marrëdhënieve të punës, ndërsa baza më e shpeshtë për diskriminim është përkatësia etnike. Ndërkaq, për vetëdijen e ulët rreth diskriminimit flet edhe e dhëna se gjatë vitit 2012 Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i janë dorëzuar gjithsej 75 parashtresa, që është për 15 më shumë në krahasim me vitin 2011, kur ishte themeluar kjo trupë. Numri më i madh i parashtresave kanë qenë të lidhura me diskriminimin e bërë nga ana e shtetit, pushtetet lokale dhe institucionet tjera publike, gjë që sipas raportit të Komisionit është brengosës, për shkak se pikërisht prej këtyre organeve pritet që ta respektojnë parimin e mosdiskriminimit. Më shumë parashtresa, gjithsej 16, kanë qenë të lidhura me diskriminimin mbi bazë të përkatësisë etnike, ndërsa janë dorëzuar edhe tri parashtresa mbi bazë të përkatësisë politike.²⁵

Sipas organizatave vendore që i ndjekin gjendjet në sferën e të drejtave të njeriut, shoqëria maqedonase ende vlen si e mbyllur dhe diskriminuese, ku vështirë pranojnë diversitetet.²⁶ Vlerësimi i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në raportin për vitin 2012 është se edhe pas dy viteve nga nxjerrja dhe aplikimi i legjislacionit antidiskriminator, ende nuk mund të flitet për mbrojtje efektive nga diskriminimi, sidomos kur bëhet fjalë për grupet e marginalizuara. Komiteti dëfton se ligji mbetet i pandryshuar, edhe përkundër kritikave nga ana e opinionit profesional dhe nga sektori joqeveritar, sidomos për pjesët me të cilat lejohet që të punësuarit në administratën shtetërore të jenë anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por dhe për mospërfshirjen e orientimit seksual dhe të identitetit gjinor në legjislacion si baza për mbrojtjen nga diskriminimi. Komiteti vlerëson se Komisioni nuk e ka shtuar as intensitetin

22 Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2013) Komunikatë. Arritur përmes: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/347/Soopshtenie_do_javnost_-_29_april_MK-FINAL.pdf

23 Avokati i Popullit (2012) Raporti vjetor për shkallën e sigurimit, respektimit, përparimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Fq. 37. Arritur përmes: <http://ombudsman.mk/>

24 Krzalovski, Aleksandar (2010) Diskriminimi mbi bazë të përkatësisë etnike. Fq. 129. Shkup: OSBE

25 Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi (2012) Raporti i rregullt vjetor i Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Arritur përmes: <http://www.kzd.mk>

26 Raporte të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të RM. Arritur përmes: <http://www.mhc.org.mk/>

e punës së vet, as transparencën e vet në publik në vitin 2012, kështu që qytetarët kanë mbetur të painformuar për mundësitë për mbrojtje nga diskriminimi. Në dallim nga Komisioni dhe Avokati i Popullit, sipas të cilëve shtrirje më të gjerë ka diskriminimi mbi përkatësinë etnike, sipas *Komitetit të Helsinkit* më të diskriminuar kanë qenë pjesëtarët e bashkësisë LBGTI, ndaj të cilëve ushtrohet diskriminim sistematik për shkak të mospërfshirjes së orientimit seksual dhe të identitetit gjinor në një numër të madh ligjesh, me të cilat do të sigurohej mbrojtja dhe inkluzioni i tyre efektiv në shoqëri.²⁷

Plus kësaj, Komiteti shprehet i shqetësuar për shkak të diskriminimit dhe marginalizimit të bashkësive që janë nën 20%, gjë që është trend edhe në nivel shtetëror edhe në nivel lokal. Bashkësia romë, sipas tyre, mbetet më e diskriminuara në shtet edhe përkundër aktiviteteve të parapara në kuadër të Dekadës së Romëve.

Sipas *Komitetit të Helsinkit*, përcaktimi politik, gjithashtu, përbën njërën prej bazave udhëheqëse mbi bazë të së cilës diskriminohet, sidomos në administratën shtetërore dhe publike, gjatë tre viteve të fundit. Kjo kthehet në problem me të cilin shteti vështirë ia del, më shumë për shkak se me diskriminimin mbi këtë bazë qytetarëve iu kufizohet e drejta e punës dhe e drejta për jetë private dhe familjare, ka konstatuar Komiteti. Diskriminimi politik në marrëdhëniet e punës sidomos është forcuar pas mbarimit të zgjedhjeve lokale të vitit 2013 dhe ndërrimit të pushtetit lokal në disa prej komunave. Në këtë kontekst, një numër i caktuar qytetarësh kanë reaguar në Komitetin e Helsinkit dhe kanë paraqitur diskriminim për shkak të kufizimit të së drejtës për të kryer funksionin e drejtorit në disa shkolla fillore, të së drejtës për të kryer pozicionin udhëheqës në administratën komunale ose të së drejtës që të përparohet në karrierë, si dhe lëshime nga puna për shkak të ndërrimit të pushtetit lokal.²⁸

Sipas *Komitetit të Helsinkit*, edhe barazia gjinore është vënë në pyetje gjatë viteve 2012 dhe 2013, sidomos për shkak të paraqitjes së gruas vetëm në rolin e nënës dhe të bashkëshortes nga ana e përfaqësuesve qeveritarë dhe kishtarë. Edhe disa ndryshime në rregullativën ligjore, si për shembull, Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë, kanë iniciuar reagime të bujshme rreth pozitës së gruas në shoqëri. Këto ndodhi hapën tema për debat lidhur me diskriminimin e drejtuar kah gruaja, për barazinë dhe inkluzionin e përgjithshëm shoqëror të saj.

B. Politizimi dhe partizimi po bëhen fenomene vazhdimisht të pranishme në sektorin mediatik dhe civil në dhjetë vitet e fundit, siç bëjnë të ditur më shumë hulumtime dhe dëftime të opinionit profesional. Si rezultat i kësaj, brengosin edhe pasojat korruptive nga këto procese ndaj strukturave shoqërore.

Politizimi dhe partizimi reflektohen në punën edhe të organizatave civile edhe të mediave, kështu që i rëndojnë kushtet që këta dy sektorë të mund ta përmbushin misionin dhe funksionin e tyre të korrektorit të pushtetit. Në intervistat që ka bërë MIM

27 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM (2012) Raporti i Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në RM për vitin 2012. Fq. 19-20. Arritur përmes: <http://www.mhc.org.mk/>

28 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM (2013) „Diskriminimi mbi bazë të bindjes dhe të përkatësisë politike.“ Arritur përmes: <http://www.mhc.org.mk/announcements/127#.Unuwdyd9iP5>

me përfaqësuesit e OC dhe të mediave në lidhje me qëndrimet dhe perceptimet e tyre për bashkëpunimin midis dy sektorëve, problemin e politizimit – edhe të OC edhe të mediave – këtë e theksojnë pothuajse të gjithë bashkëbiseduesit e intervistuar (shih Aneksin 1 të Librit të Bardhë). Raportet e USAID për vetë konsistencën e shoqërisë civile në vitet 2011 dhe 2012, bëjnë të ditur se sektori civil sidomos është devaluuar në vitet e kaluara me paraqitjen e së ashtuquajturës “OSNOS” (ang. GONGO), ose organizata joqeveritare të organizuara nga ana e qeverisë, që paraqiteshin si zë për të mbështetur politikat qeveritare, me qëllim që të “hedhin hije” ndaj organizatave civile me qëndrime dhe pikëpamje politike.²⁹ Imazhi dhe kapacitetet publike për përfaqësimin e OC gjithashtu kanë shënuar prapambetje, ndërsa ndikimi i tyre ndaj politikave mbetet minimal, ka notifikuar Raporti i USAID për vitin 2012. I njëjti burim konstaton edhe atë se mediat promovojnë stereotipi negative për organizatat civile dhe e nënçmojnë rolin e tyre të partnerit në proceset shoqërore. E gjithë kjo ka rezultuar me mbulim të kufizuar të sektorit civil në kohën qendrore të mediave.

Sa i takon sferës mediatike, ndërkaq, Bashkimi Evropian me vite në raportet e veta për përparimin e vendit ka paralajmëruar për ndikimet politike dhe të biznesit që reflektohen në politikën redaktuese të mediave, në selektimin e lajmeve, mënyrën e raportimit, ose dhe rezultojnë me vetëcensurë të gazetarëve. Rezultati përfundimtar është ai që opinioni publik është i kufizuar në arritjen e informatave të balancuara, si dhe të një spektri të gjerë të pikëpamjeve të ndryshme.

Në hulumtimin e MIM, përfaqësuesit e sektorit civil dhe gazetarët e theksojnë besimin e ulët që kanë ndërmjet vete pikërisht për shkak të ndarjes partiake dhe etnike të sektorit civil dhe të hapësirës mediatike. Një pjesë e organizatave civile të intervistuar konsiderojnë se ka media që janë “nën kapuçin e qeverisë” dhe nuk duan të raportojnë për një numër të caktuar OC, për të cilat llogaritet se janë me orientim kritik ose opozitar. Perceptimi, nga ana tjetër, i përfaqësuesve të mediave është i kundërt – se ka OC që kanë rënë nën ndikimet politike, kështu që gazetarët ballafaqohen me një situatë të mbyllur për disa ekspertë nga sektori civil, me mungesë vullneti për të komunikuar me mediat, ndërsa nga ana tjetër edhe vetë mediat i ikin komunikimit me ta. Plus kësaj, ndarja etnike e mediave dhe e sektorit civil kontribuon për një shkallë më të ulët informimi dhe për transparencë të vogël mediatike të OC që ju takojnë bashkësive të tjera në Maqedoni. Kështu, në vend që të kenë rol integruar, mediat shpeshherë paraqesin pamjen parciais të shoqërisë, të shikuar nën prizmin e etnive të ndryshme, ose nën prizmin e ideologjive të ndryshme politike. (shih Aneksin 1 të Librit të Bardhë)

Këto perceptime konfirmohen edhe në hulumtimin e TACSO, ku thuhet se „establishmenti“ politik paraqitet pengesë për punën e suksesshme të organizatave civile, por nga ana tjetër, mediat, ndërkaq, janë të ndara dhe nuk marrin pjesë në mënyrë të mjaftueshme në ndërtimin e shoqërisë mbi bazë të konceptit qytetar.³⁰

29 USAID (2011, 2012) Indeksi i vetekzistimit të shoqërisë civile. Arritur përmes: www.usaid.gov

30 TACSO (2012) Hallka që mungon. Fq. 23. Arritur përmes: <http://www.tacso.org/documents/reports/?id=8589>

Në dhjetor të vitit 2012 ishte prezantuar edhe hulumtimi “Korrupsioni në media dhe shoqëria civile” për nevojat e Komisionit Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit dhe *Transparensi Interneshënell – Maqedoni*, me mbështetjen e OSBE-së. Hulumtimi ka treguar që më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) konsiderojnë se mediat në Maqedoni nuk raportojnë objektivisht, e madje 60% besojnë se korrupsioni ka shtrirje të madhe ose të mesme mbi baza të ndryshme, sikurse promovimi i politikave partiake dhe shpërndarja e të hollave qeveritare për reklamim, që janë mënyrat përmes të cilave mund të korruptohen mediat.³¹ Një përqindje jashtëzakonisht e lartë e qytetarëve janë pajtuar me pohimin se mediat janë dorë e zgjatur e partive (83%) dhe se ka lidhje midis biznesit, politikës dhe mediave (81%).³² Ky hulumtim gjithashtu tregoi se madje 44,3% e të anketuarve besojnë se shpërndarja e mjeteve për fushata qeveritare në media paraqet korrupsionin me shtrirje më të gjerë, ndërsaq 35,2% e qytetarëve nuk besojnë se qeveria me të vërtetë angazhohet për të penguar korrupsionin në media.³³

Nga aspekti i analizës për sektorin civil hulumtimi tregoi se pothuajse një e treta e qytetarëve (29%) konsiderojnë se korrupsioni ka shtrirje të gjerë edhe në organizatat joqeveritare, si dhe 22% që konsiderojnë se korrupsioni ka shtrirje të mesme.³⁴ Gjetjet treguan se ka një përqindje të lartë të qytetarëve që konsiderojnë se ka korrupsion gjatë ndarjes së mjeteve nga buxheti për organizatat joqeveritare (63%). Kësaj të dhëne i shtohet edhe ajo se kuazi-organizata për realizimin e qëllimeve politike marrin mbështetje financiare nga Qeveria. Kjo konfirmohet edhe me anketën ku më shumë qytetarë të Maqedonisë pajtohen me pohimin se organizatat joqeveritare në Maqedoni themelohen për realizimin e qëllimeve të partive politike (67,5%).³⁵

C. Liria e mediave dhe pluralizmi politik janë shtyllat thelbësore të demokracisë dhe pjesë e Kartës për të Drejtat Themelore të BE, ku në mënyrë eksplicite theksohet se liria dhe pluralizmi i mediave duhet të respektohen. Liria e shprehjes është e garantuar me më shumë instrumente të të drejtës ndërkombëtare, siç janë Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Karta Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike, Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut, Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këto dokumente e garantojnë të drejtën e lirisë së shprehjes, të mendimit personal, marrjes dhe transmetimit të informacioneve ose të ideve pa kurrfarë përzierje të pushteteve. Edhe pse e drejta e lirisë së shprehjes shpeshherë lidhet me gazetarët dhe me punëtorët e mediave, me shumë rëndësi është që të kuptohet se mediat janë vetëm kanal përmes të cilit manifestohet kjo e drejtë, por ajo i takon çdo qytetari të një shoqërie demokratike.

Në një ambient shoqëror-politik të këtyllë në shtet, kornizat e të cilit i vunë gjendjet

31 Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit, *Transparensi Interneshënell-Maqedoni dhe OSBE (2012) „Korrupsioni në media dhe shoqëria civile”*. Shkup. Arritur përmes: http://www.transparency.org.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=823&Itemid=57

32 Ibid

33 Ibid

34 Ibid

35 Ibid

që u përshkruan më parë me praktikimin e të drejtave të njeriut, realizohet edhe funksionimi i mediave dhe puna e gazetarëve. Liria e mediave pati momente dramatike në disa vite të kaluara. Sa i takon kornizës ligjore, në vitin 2012 u nxor Ligji për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje, me të cilin këto vepra u dekriminalizuan dhe u bartën në të drejtën civile, me të cilën gjë Maqedonia e plotësoi njërin prej rekomandimeve të BE-së. Megjithatë, një pjesë e publikut mediatik u shpreh i shqetësuar se Ligji në të vërtetë do ta nxisë vetë censurën te gazetarët dhe plus kësaj disa nene të tij janë problematike për shkak të mundësisë për të ngulatur gazetarinë hulumtuese dhe kritike.

Gjatë vitit 2013 ishte aktual propozimi i ri për ligjin që rregullon sferën mediatike, i cili pasi pati disa versione, kështu që në Kuvend përfundimisht arriti i ndarë në dy propozim-ligje të veçanta – për media dhe për serviset audio-vizuale.³⁶ Legjislacioni i propozuar u prit me mendime të ndara nga ana e esnafit mediatik, ndërsa vërejtjet më të mëdha kishin të bënin me atë se ligji e zgjeron kompetencën ndaj shtypit dhe publikimeve në internet, ndërkohë që prek dhe profesionin e gazetarit dhe aspektet redaktuese të funksionimit të mediave. Me Ligj propozohet formimi i trupit rregullator Agjenci për Media dhe Servise Audio-Vizuale, kompetenca e së cilës do të shtrihej edhe ndaj shtypit dhe mediave në internet. Mënyra e propozimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të kësaj trupe e vë në pyetje pavarësinë e saj. Kritikat nga ana e bashkësisë mediatike kishin të bënin edhe me atë se ky legjislacion nuk e zgjidh reklamimin qeveritar në media, që paraqet burimin serioz të mjeteve për disa media dhe mundësinë për ndikim politik dhe ekonomik ndaj mediave, si dhe nuk e sanksionon gjuhën e urrejtjes, gjithnjë e më të pranishme në hapësirën mediatike.

Në lidhje me atë se çka ndodh në praktikë, ndikimet politike dhe ekonomike ndaj mediave janë problem kronik në sferën mediatike, ndërsa reflektohen përmes politikës së njëanshme redaktuese, keqësismit të standardeve profesionale, vetëcensurës së gazetarëve, si dhe qasjes së kufizuar të publikut për një raportim të balancuar dhe për një spektër të gjerë pikëpamjesh. Vërejtjet nga institucionet ndërkombëtare në vitet e kaluara ishin që liria e mediave përgjithësisht është e “ndotur” nga ndikimi i partive politike në politikën redaktuese, gjë që është shumë e qartë. Vendi shënon prapambetje drastike në sferën e lirisë së mediave në vitet e kaluara.

Plus kësaj, një problem që i bën distorzim hapësirës mediatike në Maqedoni është edhe **gjuha e urrejtjes**, gjithnjë më e pranishme, e cila veç disa përjashtimeve, mbetet e pasanksionuar edhe krahas rregullativës ligjore ekzistuese. Gjuha e urrejtjes është e ndaluar me Kushtetutë dhe me ligje (Kodi penal, nenet 319, 417, 173), të cilat sanksionojnë përqeshjen e individëve ose të grupeve mbi bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë nacionale ose etnike të ndryshme, përmes sistemeve informative, si dhe përmbajtjeve programore që bëjnë thirrje në urrejtje dhe jotolerancë nacionale, racore, ose fetare (Ligji për veprimtari radiodifuzive, nenet 69, 166). Në Kodin etik të gazetarëve të Maqedonisë neni 10 i referohet konkretisht gjuhës së urrejtjes, duke theksuar se: “Gazetarët nuk do të krijojnë as përpunojnë informacione që i rrezikojnë të

³⁶ Në nëntor 2013 ligji ende nuk ishte nxjerrë.

drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do ta shfrytëzojnë gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisin në diskriminim të cilitdo lloji qoftë (nacional, religjioz, gjinor, shoqëror, klasor, gjuhësor, orientimi seksual, orientimi politik...).”

Në mars të vitit 2013 Agjencia për të Rinj dhe Sport startoi fushatën nacionale kundër gjuhës së urrejtjes në Internet,³⁷ në kuadër të së cilës ishin organizuar stërvitje dhe konferenca, por mbetet konkluzioni se duhet të intensifikohen aktivitetet në këtë sferë. Prandaj, disa organizata civile mjaft janë aktive në sferën e identifikimit dhe të pengimit të gjuhës së urrejtjes, siç është *Komiteti i Helsinkit*, *Koalicioni për të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara*,³⁸ *Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni (FSHHM)*, *Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë*, *Media Instituti Maqedoni* e të tjerë.

Në analizën e *MIM “Gjuha e urrejtjes në Internet”*, konstatohet se mediat ‘mejnstrim’ në të shumtën e rasteve kufizohen nga gjuha e hapur e urrejtjes, por ajo shpesh paraqitet në formë të fshehtë. Te mediat virale, rrjetet sociale (sidomos Fejsbuk dhe Tviter), forumet, si dhe te përmbajtjet që i krijojnë shfrytëzuesit (komentet e teksteve, për shembull), gjithnjë e më shumë përdoret gjuha e urrejtjes dhe stereotipizimi negativ.³⁹ Në shumë raste, kur në media gjendet gjuha e urrejtjes ose gjuha nxitëse, hulumtimet kanë treguar se kjo i referohet transmetimit jokritik të deklaratave të politikanëve, kolumnistëve dhe kreatorëve të tjerë të mendimit publik nga ana e vetë mediave.⁴⁰

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vazhdimësi i ka ndjekur mediat, rrjetet sociale dhe deklaratat e bartësve të funksioneve të larta publike dhe të përfaqësuesve të partive politike dhe ka konstatuar se në vitin 2012 gjuha e urrejtjes ka shënuar rritje, ndërsa janë regjistruar edhe raste që kanë mbaruar edhe me dhunë fizike.⁴¹ Edhe pse gjuha e urrejtjes është gjithnjë e më e pranishme në media, gjyqet maqedonase ende nuk kanë shpallur asnjë për fajtor. Edhe organet tjera kompetente, si për shembull Ministria e Punëve të Brendshme dhe Prokuroria Publike, nuk kanë ndërmarrë ndonjë iniciativë për dorëzimin e fletëparaqitjeve për gjuhën e urrejtjes.⁴² Masat që i ndërmori Këshilli i Radiodifuzionit sa i përket emetimit të përmbajtjeve që e nxisin gjuhën e urrejtjes, u përmblohdën në vetëm dy “paralajmërime joformale” (për TV Sitel dhe TVM) dhe një ndalesë për emetimin e reklamave në kohëzgjatje dyditore (për TV Kanal 5 për gjuhën e urrejtjes në “Milenko Nedelkovski Show”).

37 Agjencia për të Rinj dhe Sport. Arritur përmes: <http://www.ams.gov.mk/odnosi-so-javnosta/soopstenija/258-oznachen-pochetokot-na-nacionalna-kampanja-protiv-govorot-na-omraza-na-internet>.

38 Trajanoski, Zharko (2011) Diskurset mediatiche dhe diskriminimi ndaj pjesëtarëve të grupeve të margjinalizuara (shfrytëzues drogash, punëtorë seksualë, LGBT, persona që jetojnë me HIV). Shkup: Koalicioni „Të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore për Bashkësitë e Margjinalizuara“.

39 Saraçini, Petrit (2013) „Gjuha e urrejtjes në internet“, MIM: Shkup. Arritur përmes: www.mim.org.mk

40 Shkolla e Lartë për Gazetari dhe për Marrëdhënie me Publikun (SHLGMP) (2013) Raporti i parë dhe i dytë i Shkollës së Lartë për Gazetari dhe për Marrëdhënie me Publikun, nga monitorimi i raportimit mediatic në kuadër të Katedrës së UNESCO-s për Media, Dialog dhe Mirëkuptim të Ndërsjellë. Shkup: SHLGMP

41 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM. Arritur përmes: <http://zlostorstvaodmraza.com/>

42 Saraçini, Petrit (2013) „Gjuha e urrejtjes në internet“, MIM: Shkup. Arritur përmes: www.mim.org.mk

Është veçanërisht e rëndësishme që të përmendet se në Maqedoni definimi i gjuhës së urrejtjes dhe kriminalizimi i saj manipulohen, për shkak se shpeshherë konsiderohet se përmes sanksionimit të gjuhës së urrejtjes do të ishte kufizuar liria e shprehjes. *Komiteti i Helsinkit* ka konstatuar se me këtë pretekst tashmë një kohë të gjatë po udhëhiqen fushata negative kundër disa personave publik, nxirje, homofobi, transfobi dhe mizogjini të theksuara, si dhe nxitet urrejtja etnike dhe politike.⁴³ Kohëve të fundit bëhet aktual termini “krime nga urrejtja”, që do të thotë kriminalitet i motivuar nga jotoleranca, përkatësisht nga paragjykimet ndaj grupit të caktuar në shoqëri.⁴⁴ Numri i krimeve të kryera nga urrejtja në Maqedoni, gjatë periudhës prej marsit deri në fund të nëntorit të vitit 2013, ka qenë mbi 100. Në numrin më të madh nga këto raste të regjistruara nga ana e *Komitetit të Helsinkit* viktimat kanë qenë të rinjtë, edhe atë për shkak të përkatësisë së tyre etnike ose religjioze. Megjithatë, cak i krimeve që janë kryer nga urrejtja kanë qenë edhe personat e bashkësisë LGBTI, të cilët janë sulmuar për shkak të orientimit të tyre seksual ose të identitetit gjinor. Fakti që gjuha e urrejtjes e drejtuar kah kjo kategori njerëzish vjen madje edhe nga ana e disa organeve dhe institucioneve shtetërore, paraqet fenomenin i cili dhunuesve iu jep alibinë për sulmet e tyre, konstatojnë nga Komiteti.

43 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM (2012) Raporti vjetor i Komitetit të Helsinkit të RM për gjendjet në sferën e të drejtave të njeriut në RM në vitin 2012. Arritur përmes: <http://www.mhc.org.mk>

44 Ueb-faqja www.zlostorstvaodomraza.com

Gjuha e urrejtjes vs. lirisë së shprehjes

Me qëllim që ta kufizojmë gjuhën e urrejtjes nga liria e shprehjes, i transmetojmë definicionet e rekomanduara në dokumentet ndërkombëtare.

“Termi ‘gjuha e urrejtjes’ përfshin të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose arsyetojnë urrejtje racore, ksenofobi, antisemitizëm ose forma të tjera të urrejtjes të bazuara në jotolerancë, përfshi: jotolerancën e shprehur përmes nacionalizmit dhe etnocentrizmit agresiv, diskriminimit dhe armiqësisë ndaj pakicave, migrantëve dhe personave me prejardhje imigrante.”⁴⁵

Nga ana tjetër, ndërkaq, liria e shprehjes është e drejtë fundamentale e njeriut, e cila është e normuar në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: *“Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit personal, marrjen dhe transmetimin e informacioneve dhe ideve, pa çfarëdo lloj përzierjeje të pushteteve publike dhe pavarësisht kufijve shtetërorë. Ky nen nuk i pengon shtetet që të ndajnë licenca për punën e ndërmarrjeve nga radiodifuzioni, transmetimi televiziv dhe kinematë.”*

Neni 10 mund të mbrojë edhe informacione dhe ide që ofendojnë, shokojnë ose shqetësojnë, edhe atë në emër të “pluralizmit, tolerancës dhe mendimit të lirë, pa të cilat nuk ka shoqëri demokratike” ose mendime të thëna me shprehje të ashpra dhe të stërtheksuara, “por shkalla e mbrojtjes së tyre varet nga konteksti dhe nga qëllimi i kritikës”. Këto mendime mund të tolerohen në rastet kur fjala është për interes publik, kur kritikohet pushteti ose në periudhat e fushatës zgjedhore.⁴⁶

Megjithatë, liria e shprehjes nuk është vetëm e drejtë, por edhe përgjegjësi dhe mu për këtë nuk është e pakufizuar. Realizimi i pakufizuar i të drejtës për realizimin e lirisë së shprehjes në situata të caktuara mund të rrezikojë të drejta dhe liri të tjera, si për shembull të drejtën e gjyqimit fer, të drejtën e privatësisë ose lirinë e besimit fetar.⁴⁷ Përgjigjja në pyetjen se deri ku mund të kufizohet liria e shprehjes, është dhënë në paragrafin 2 të nenit 10 të Konventës, ku thuhet: *“Realizimi i këtyre lirive...mund t’u nënshtrohet formaliteteve, kushteve, restriksioneve, ose dënimeve të caktuara me ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit nacional, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtje nga trazirat ose veprat penale, të shëndetit ose të moralit, reputacionit ose të drejtat e tjetrit, për mbrojtjen nga zbulimi i informacioneve të besueshme ose për ruajtjen e autoritetit dhe të paanshmërisë së gjyqësisë.”*

Neni 10 e vë theksin në lirinë e shprehjes, që mund të përfshijë gjuhën e ashpër dhe ofenduese kur bëhet fjalë për kritikë në emër të interesit publik. Por, kjo nuk do të thotë se e mbron edhe gjuhën e urrejtjes. Neni 10 nuk i mbron deklaratat me të cilat me qëllim dhe në mënyrë direkte bëhet thirrje në dhunë ose në veprime që mund të shkaktojnë dhunë, ku hyn edhe gjuha e urrejtjes. Duhet qartë të përkufizohet se gjuha kritike ose e ashpër nuk është e njëjtë sikurse që është gjuha e urrejtjes, diçka rreth së cilës shumica kanë hutim.

45 Këshilli i Evropës. Rekomandimi nr. P (97) 20 për gjuhën e urrejtjes i Komitetit të Ministrave drejtuar vendeve-anëtare. Arritur përmes: http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/cm/rec%281997%29020&expmem_EN.asp

46 Tërpevska, Snezhana (2010) Liria e shprehjes, interesi publik dhe rregullacioni mediatik. Fq. 7. Shkup: SHLGMP.

47 Ibid. Fq. 13

2

KAPITULLI

**PRIORITETET E BASHKËPUNIMIT MIDIS
ORGANIZATAVE CIVILE DHE MEDIAVE NË SFERËN E
TË DREJTAVE TË NJERIUT**

II.1. PRIORITETET NË SFERËN E TË DREJTAVE CIVILE DHE POLITIKE

Funksionimi efikas i gjyqësisë në praktikë, pavarësia e saj dhe kualiteti i drejtësisë përgjithësisht ende tregohen si sfera të cilat shqetësojnë, edhe përkundër rrumbullakimit të procesit reformator në sferën e gjyqësisë që është në rrjedhë e sipër në dhjetë vitet e fundit. Sa i takon pavarësisë së gjyqësisë, Komisioni Evropian në raportin e progresit për vitin 2013 thekson se ka informacione për drejtësi selektive, presion indirekt politik, vendime të pazakonshme në kuptim të rezultatit ose të shpejtësisë së shqiptimit, si dhe të kualitetit të vendimeve, të cilat ndonjëherë kanë pasoja direkte ndaj karrierës së gjykatësve të prekur, sidomos kur është fjala për rastet politike ose për ato të profilit të lartë. Vetë fakti se ka dyshime, paraqet problem për pavarësinë e gjyqësisë dhe për besimin publik ndaj saj, thuhet në Raport.⁴⁸

Nga sfera e të drejtave politike dhe civile, organizatat⁴⁹ vendore dhe ndërkombëtare vërejtje shtesë bëjnë për lirinë e mediave, lirinë e gjuhës dhe lirinë e bashkimit; punën e policisë, sidomos të njëjve speciale, dhe nevojën për përforcimin e pavarësisë dhe të efikasitetit të Sektorit për Kontroll të Brendshëm; dhunën ndaj të burgosurve nga ana e personave zyrtarë; incidentet që përfshijnë torturën dhe sjelljen jonjerëzore në burgje; stërngarkimin, financimin e dobët dhe deficitin kadrovik në burgje; kushtet substandarde dhe mbrojtjen e dobët shëndetësore për të burgosurit etj.

Të drejtat politike dhe civile janë në fokusin e monitorimit, si të Avokatit të Popullit, ashtu dhe të disa organizatave civile relevante në vend, siç janë *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut*, *Qendra për Liri – Civil*, *Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”*, *Instituti për të Drejtat e Njeriut* dhe organizata të tjera civile. Vlerësimet rreth situatës në sferën e të drejtave politike dhe civile në këtë pjesë të Librit të Bardhë mbështeten kryesisht në ekspertizën, raportet dhe konsultimet e bëra me *Komitetin e Helsinkit*, si dhe në vërejtjet e institucioneve të tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare.

• **Liria e mediave dhe liria e shprehjes.** Liria e shprehjes, sipas raporteve të më shumë organizatave vendore dhe ndërkombëtare viteve të kaluara shënon trend negativ dhe rënie drastike. Në kuadër të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave në kuadër të raportit të Komisionit Evropian për vitin 2013, kjo është sfera e parë e cila tregohet si problematike.

Raportet e Komisionit Evropian dhe të organizatave ndërkombëtare e vendore me renome që disa vjet me radhë paralajmërojnë për trendet brengosëse në skenën mediatike në Maqedoni. Qeveria është shpallësi më i madh në stacionet televizive komerciale, me të cilën gjë iu jep përparësi të konsiderueshme financiare sidomos mediave proqeveritare.⁵⁰ Në vitet e kaluara janë mbyllur më shumë media, janë hequr më shumë emis-

48 Komisioni Evropian (2013) Raport për progresin e Republikës së Maqedonisë. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/mk_rapport_2013.pdf

49 Avokati i Popullit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM dhe Komisioni Evropian

50 Këshilli i Radiodifuzionit (2013) Analizë tregut të veprimtarisë radiodifuzive për vitin 2012. Shkup: Këshilli i Radiodifuzionit. Arritur përmes: http://www.srd.org.mk/images/Analiza_z_a_radiodifuznata_dejnost.pdf;

Komisioni Evropian (2013) Raport për progresin e Republikës së Maqedonisë

ione debati nga programet, ndërsa shumë gazetarë mbeten pa punë. Kjo rezultoi me heshtjen e opinionit publik kritik. Njëra prej ngjarjeve më kontradiktore në sferën mediatike ndodhi më 24 dhjetor të vitit 2012, kur gazetarët u larguan me dhunë nga galeria e Kuvendit dhe u penguan që ta ndjekin mbledhjen e Parlamentit, gjë që i çrregulloi relacionet dhe besimin midis mediave dhe qeverisë. Kushtet e këqija në të cilat punojnë gazetarët dhe të drejtat e brishta punëtore, varshmëria politike dhe financiare e servisit radiodifuziv publik dhe e trupave rregullatore, autocensura e gazetarëve, janë vetëm disa prej indikatorëve për gjendjen e mediave në Maqedoni.⁵¹

Ngjarja e fundit që i bëri shok bashkësisë mediatike ndërkombëtare dhe vendore ishte vendimi gjyqësor prej katër vjet e gjysmë burg për gazetarin Tomislav Kezharovski. Ai ishte dënua për zbulimin e identitetit të kinse dëshmitarit të mbrojtur në rastin për vrasje, në tekstin që e ka shkruar në vitin 2008, edhe pse dëshmitari më parë deklaroi se ka dëshmuar rrejshëm kundër të akuzuarve për vrasje. Rasti me Kezharovskin e ngriti në këmbë bashkësinë mediatike vendore, ndërsa me dënim reagan edhe organizatat dhe institucionet ndërkombëtare. Përfaqësuesi për lirinë e mediave i OSBE-së, Dunja Mijatoviç, u shpreh “e tmerruar” nga vendimi, duke theksuar se me të u dërgohet porosi e qartë për censurë gazetarëve të tjerë. Ajo shtoi se vendimi do të ketë pasoja serioze për lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave në vend.⁵² Më parë, raportuesi special për të drejtën e mendimit dhe shprehjen e lirë i Kombeve të Bashkuara, Frank Laru, reagoi se ky rast ndikon negativisht në lirinë e mediave në Maqedoni.⁵³ Ai në raportin e tij theksoi se ka qenë i njoftuar për më shumë raste të përdorimit të instrumenteve legale për kërcënimin e gazetarëve dhe të mediave të pavarura, gjë që sipas tij paraqet rrezik nga heshtja e zërave të rëndësishëm në vend.⁵⁴ Me vendimin për Kezharovskin, Maqedonia u bë shteti i vetëm në Evropën Juglindore me gazetar në burg.

• **Liria e përbashkimit.** Liria e përbashkimit dhe e shprehjes së pakënaqësisë përmes formës së protestës së qetë paraqet korrelacionin e të drejtave civile dhe politike, të cilat të gjithë njerëzit në shtet duhet t’i gëzojnë në mënyrë të barabartë. *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut* në raportin vjetor për vitin 2012 ka konstatuar se të drejtat civile dhe politike kanë qenë të theksuara sidomos përmes praktikimit të së drejtës për protestë paqësore (tubim publik), lirinë e përbashkimit dhe lirinë e shprehjes nga ana e disa grupeve shoqërore, organizatave dhe bashkimeve joformale të qytetarëve. Megjithatë, Komitetit i janë dorëzuar më shumë reagime nga individë dhe grupe për shkak të frikës së shprehur; për shkak të mospajtit me zyrtarët e policisë që e sigurojnë të drejtën e protestës paqësore; për shkak të kërcënimeve, shantazheve, kufizimeve të së drejtës; për shkak të presioneve në formën e kundërprotestave, si dhe për shkak të diskriminimit politik mbi bazë të anëtarësisë në parti politike. Komiteti e thekson

51 Raporte dhe hulumtime të Media Institutit Maqedoni. Arritur përmes: www.mim.org.mk

52 Deklaratë e Dunja Mijatoviçit, përfaqësuese për lirinë e mediave e OSBE-së. Arritur përmes: <http://www.osce.org/fom/107265>

53 Media onllajn [www.javnost.mk](http://javnost.mk). Arritur përmes: <http://javnost.mk/?p=6110>

54 Konkluzione preliminare nga ana e raportuesit special për të drejtën e lirisë së mendimit e të gjuhës të KB, z. Frank Le Ru, Shkup, 21 qershor. Arritur përmes: <http://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=13480&LangID=E>

rëndësinë e këtyre të drejtave në zhvillimin e demokracisë parlamentare, për shkak se me praktikimin e tyre arrihet kontrolli ndaj pushtetit ekzekutiv nga ana e qytetarëve dhe mundësohet shprehja e pakënaqësisë ndaj një politike të caktuar, mënyrës së qeverisjes e të ngjashme. Komiteti konsideron se çfarëdo pengese ose përpjekje për kufizimin e këtyre të drejtave paraqet thyerje të të drejtave civile dhe politike, që janë pjesë e korpusit të të drejtave dhe lirive ndërkombëtare të njeriut. Në këtë pikëpamje, kjo organizatë ka konstatuar shkeljen e të drejtave të sipërtheksuara në vitin 2012, me ç'rast ishte vërejtur edhe eskalimi i protestave paqësore në protesta të dhunshme, në kuadër të të cilave qytetarë dhe nëpunës të policisë kishin marrë lëndime më të lehta trupore.

- **Diskriminimi dhe etiketimi mbi bazë politike.** *Komiteti i Helsinkit* ka përcaktuar diskriminim dhe etiketim nga ana e mediave për një pjesë aktivistësh të iniciativës civile AMAN, të cilët në të njëjtën kohë kanë qenë edhe pjesëtarë të partive të ndryshme politike. Sipas konstatimeve të Komitetit, disa prej mediave i kanë etiketuar këta aktivistë si të papërshtatshëm për ta shprehur pakënaqësinë e tyre si qytetarë, përmes formave të protestave paqësore dhe aktivizmit qytetar. Komiteti llogarit se me këtë në mënyrë të drejtpërdrejtë bëhet diskriminim politik ndaj qytetarëve, të cilët, krahas të drejtave civile, kanë dhe të drejta politike dhe tërheq vërejtjen se instalohet trendi i mospërshtatjes për shkak të përkatësisë politike ose afilacionit, me të cilën gjë imponohet pamja e gabuar në publik se qytetarët që janë anëtarë të partive nuk mund t'i kënaqin të drejtat e tyre civile, siç është e drejta e protestës.

- **Keqpërdorimi i masës - paraburgim.** Është sidomos brengosëse gjendja me keqpërdorimin e masës së paraburgimit dhe e shkeljes së të drejtës së lirisë dhe sigurisë garantuar me nenin 5 paragrafi 3 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. *Komiteti i Helsinkit* ka vërejtur më shumë raste gjatë të cilave paraburgimi ka zgjatur më shumë dhe ai është shqiptuar për vepra më të lehta penale, ndërkohë që shumë rrallë janë shfrytëzuar masa alternative. Komiteti në mënyrë të vazhdueshme ka reaguar ndaj kësaj praktike të gjyqeve, përkatësisht, siç thonë – në marrjen e vendimeve me arsytetime të pambështetura për shqiptimin dhe vazhdimin e kësaj mase, mosaplikimin e masave më të buta dhe shfrytëzimin e paraburgimit si dënim. Edhe krahas numrit të madh të dëftimeve nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare, vendore dhe ndërkombëtare, rreth kësaj gjendje, Komiteti ka konstatuar se mungon reagimi konkret nga ana e gjyqeve, ndërsa gjyqi e shkel ligjin po qe se bën arsytetime me të cilat këtyre personave iu vazhdohet paraburgimi mbi bazë të përshkrimit të bazave ligjore për shqiptimin e kësaj mase.⁵⁵ Ky lloj vendimesh sipas *Komitetit të Helsinkit* janë problematike edhe për Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si për shembull në rastin “Syri i gjarprit”, ku u konstatua se shteti e ka shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak se nuk ka siguruar arsytetime të mjaftueshme për të mbajtur qytetarët e vet më shumë se 8 muaj në paraburgim të përhershëm.

⁵⁵ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Komunikatë „Paraburgosja e Tomislav Kezharovskit është në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut“. Arritur përmes: <http://www.mhc.org.mk/announcements/143#.UoY-DXD-NWI>; Dojçe Vele, intervistë me Voislav Stojanovskin, këshilltar juridik në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Arritur përmes: <http://www.dw.de>

- **Prezumimi i pafajësisë.** Institucionet dhe organizatat vendore, në mesin e të cilave edhe *Komiteti i Helsinkit* edhe Avokati i Popullit, kanë konstatuar raste të mosrespektimit të parimit për prezumim të pafajësisë edhe nga ana e institucioneve, siç janë Ministria e Punëve të Brendshme, funksionarët e lartë shtetërorë, e në disa raste – edhe nga ana e gjyqeve. *Komiteti i Helsinkit* thekson edhe atë se, edhe pse mund të konstatohet përparim në transparencën e punës së gjyqeve, gjë që në masë të madhe ndikon ndaj perceptimit të publikut dhe të mirëbesimit ndaj institucioneve, raporti i tyre me mediat ka mbetur kontrovers në pikëpamje të rrezikimit serioz të prezumimit të pafajësisë dhe të privatësisë së qytetarëve – pjesëmarrës në procese gjyqësore.

Kështu, për shembull, ka ndodhur që MPB ta thyejë prezumimin e pafajësisë kur ka dalë në konferencë për shtyp me emër dhe mbiemër, ose, ndërkaq, ka publikuar fotografinë e gjoja shkelësit të ligjit pa ia mbuluar fytyrën/sytë ende pa u dënuar ai, ndërsa gjyqi e ka rrezikuar prezumimin kur, për shembull, në vendimet për shqiptimin e masës paraburgim e ka cekur mënyrën se si është bërë vepra penale, ose kur ka folur për shkallën e përgjegjësisë penale. Megjithatë, rastet e këtilla kanë qenë më të shpeshta në vitet e kaluara. Pas shumë reagimeve drejtuar institucioneve, ato bëhen gjithnjë e më të kujdesshme gjatë publikimit të informacioneve. Mediat, ndërkaq, shumë shpesh vetëm i transmetojnë materialet e marra nga institucionet, gjithashtu duke mos e respektuar parimin për prezumimin e pafajësisë.

Sidomos brengos mungesa e standardeve të qarta për mënyrën dhe vëllimin e raportimit nga procedura gjyqësore dhe për shpalljen e të dhënave në internet. Për këtë shkak, Komiteti propozon që të vihen standarde të shkruara për mediat për mënyrën e raportimit nga rastet dhe gjyqet penale, ndërsa MPB të mund të dalë me konferenca shtypi vetëm pasi të lejohet dhe të mbikëqyret nga Prokuroria Publike, siç është tani rasti në Kroaci dhe në shtete të tjera evropiane.

- **Kushtet në burgje dhe në entet edukuese-përmirësuese.** Ndërmarrjet reformatore për përmirësimin e kapaciteteve të vendosjes për qëndrimin e personave të dënuar po zhvillohen ngadalë. Projekti “Rikonstruktimi i ENP”, që filloi në vitin 2011, rezultoi me hapjen e burgut të ri të ndërtuar në “Kumanovë” në vitin 2013, ndërkohë që ka filluar të ndërtohet edhe ENP “Idrizovë”. Si pjesë e këtij projekti duhet të rikonstruktohet edhe enti për të mitur, Shtëpia Edukuese- Përmirësuese në Tetovë, e cila nuk shfrytëzohet prej vitit 2001, si dhe burgu “Shkupi”. Më shumë institucione dhe organizata konstatojnë se kushtet për të jetuar në burgje janë të këqija, stërngarkimi rritet, ndërsa personeli që punësohet ka arsim joadekuat. Kushtet për të jetuar në paraburgim, ndërkaq, janë madje më të këqija sesa ato nëpër burgje, ndërsa rekomandimet e Komitetit për Mbrojtje nga Tortura në kuadër të KB nuk janë realizuar. Sipas raporteve të Drejtorisë për Kryerjen e Sanksioneve, në periudhën midis viteve 2008 deri 2010, numri i të paraburgosurve është rritur për 45%.⁵⁶ *Komiteti i Helsinkit* ka regjistruar një numër të madh ankesash nga personat e paraburgosur e që kanë të bëjnë me mbrojtjen shëndetësore joadekuate dhe me mosfunksionimin e ndihmës juridike. Janë marrë disa ankesa

⁵⁶ Raportet vjetore arrihen në: <http://www.pravda.gov.mk/tekstoviuis.asp?lang=mak&id=godizv>

për torturë nga ana e policisë së burgjeve, sidomos nga personat e akuzuar për pedofili, ndërkohë që kontrolli gjyqësor, ndërkaq, nuk ka dhënë rezultate, bëjnë të ditur nga Komiteti. Të burgosurit me të cilët *Komiteti i Helsinkit* ishte në kontakt të përhershëm janë ankuar për mosfunksionimin e programeve për risocializim dhe riintegrim. Ankesa ka pasur edhe për edukatorët, të cilët kanë pasur arsimim joadekuat, si dhe për korrupsion gjatë shfrytëzimit të beneficioneve për sjellje të mirë (dalje nga institucioni, shtimi i numrit të vizitave etj.). Nga *Komiteti i Helsinkit* bëjnë të ditur se nuk ka trajtim të veçantë për personat e dënuar me burg të përjetshëm, ndërsa kur kanë kërkuar të vizitojnë 29 të dënuarit me burg të përjetshëm në burgun “Idrizovë”, vizita nuk iu është lejuar “për shkaqe të sigurisë”. Vizita nuk janë lejuar edhe kur këtë e kanë kërkuar mediat. *Komiteti i Helsinkit* në vitin 2012 ka marrë një paraqitje anonime me fotografi nga paraburgimi në Shkup, ku shihej se policia ka shfrytëzuar mjete lidhëse (pranga të lidhura për duart e të paraburgosurve dhe radiatorët e ngrohjes qendrore).

Komiteti konstaton se Ligji për ekzekutimin e sanksioneve nuk realizohet në tërësi, ndërsa *Komisioni Shtetëror për Mbikëqyrje në entet ndëshkimore – përmirësuese dhe në entet edukuese – përmirësuese*, i themeluar në vitin 2010, nuk është aktiv dhe nuk po i kryen kompetencat e veta. Për këtë shkak, përveç Avokatit të Popullit nuk ka mekanizëm mbikëqyrjeje mbi të burgosurit dhe mbi *Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve*, rekomandimet dhe dëftimet e të cilave do të ishin të obligueshme për këto institucione.

Problemet më të mëdha të cilat *Komiteti i Helsinkit* i ka regjistruar janë të lidhura me higjienën joadekuate në burgje, angazhimin e pamjaftueshëm me punë të personave të dënuar, mbrojtjen shëndetësore joadekuate, mungesën e çfarëdo lloj arsimit, të burgosurit nuk kalojnë mbi 1 orë në ambient të hapur, e kanë të rënduar korrespondencën përmes postës, shërbime juridike jofunksionale etj.

- **Tortura dhe brutaliteti policor.** Në kuadër të të drejtave themelore ndahen dy sfera, të cilat, ndërkaq, zvarriten si problematike me vite të tëra – pengimi i torturës dhe veprimi i keq në sistemin e paraburgimit dhe të burgimit, si dhe Sektorin e Kontrollit të Brendshëm dhe të standardeve profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Raportet e *Komitetit të Helsinkit*, të Avokatit të Popullit, Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës (KPT), vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe i më shumë organizatave të tjera qeveritare dhe joqeveritare relevante, flasin se janë të nevojshme përpjekje plotësuese nga ana e pushteteve që t’i eliminojnë burimet e shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut kur është në pyetje brutaliteti policor.

Sipas *Komitetit të Helsinkit*, rasti i Martin Neshkovskit ka treguar se PP (Prokuroria Publike) nuk ka pasur kontroll të drejtpërdrejtë dhe efikas në udhëheqjen e hetimeve penale kundër gjoja keqpërdorimeve të policisë. Maqedonia e ka për obligim që të bëjë hetime efikase, të paanshme dhe me themel në të gjitha rastet e brutalitetit të policisë. Sidomos kur viktima paraqiten personat nga bashkësitë etnike të cilat janë veçmas të lëndueshme ndaj brutalitetit të policisë. Për fat të keq, shteti edhe më tej është lëndë

kritikash e institucioneve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të cilat dëftojnë se për tejkalimet policore duhet të përgjigjen jo vetëm autorët konkretë të tyre, por edhe të gjithë ata që kanë ditur se ka ndodhur diçka e tillë, por nuk e kanë penguar ose nuk e kanë paraqitur atë. Lëvizja “Stop për brutalitetin policor” përmes protestave të mijëra qytetarëve që zgjatën 40 ditë gjatë vitit 2011, kërkonte mbikëqyrje të jashtme mbi policinë dhe në përgjithësi për vdekjen e Martin Neshkovskit, si rezultat i përdorimit të tepruar të forcës. Koalicioni qeverisës nuk i pranoi këto kërkesa. Të gjitha partitë opozitare në vitin 2012 dorëzuan në Kuvend propozim-ligjin për avokat policie, por propozimi ishte refuzuar nga shumica e deputetëve.

Edhe Avokati i Popullit, nga parashtresat që ka marrë në vitin 2012, ka konstatuar se respektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara nga ana e personave që iu është hequr liria vazhdon të jetë në një nivel të pakënaqshëm, për shkak të kapaciteteve të stërm-bushura, problemeve me mbrojtjen shëndetësore, situatave të shpeshtuara me konflikte ndërmjet personave të dënuar dhe rasteve të vërejtura të raportit joprofesional dhe të torturës nga ana e personave zyrtarë.⁵⁷

- **Demokracia participative.** Iniciativa qytetare AMAN është një prej shembujve të rrallë të suksesshëm për praktikimin e të drejtës së demokracisë së drejtpërdrejtë dhe të propozimit të ndryshimeve ligjore në Kuvend direkt nga ana e qytetarëve. Krahas shprehjes së pakënaqësisë së saj përmes protestave, kjo iniciativë qytetare arriti që me ndihmën e nënshkrimeve të 13.000 qytetarëve të dorëzojë edhe propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjetikë. Propozim-ligji i ministrisë kompetente ishte mbështetur nga shumica e deputetëve të partisë në pushtet qysh në fillim të debatit në Kuvend, kështu ishte vendosur që të mos ketë lexim të dytë për ndryshimet e propozuara. *Komiteti i Helsinkit* ka konstatuar se familjet si konsumatorë aspak nuk janë të mbrojtura nga rritja e vazhdueshme e çmimeve të energjisë elektrike dhe nga organika monopoliste e distributorëve të energjisë termike. Për këto shkaqe nevojitet që të precizohen më tej dispozitat ligjore, përmes të cilave do të mbroheshin të drejtat e amvisërive si konsumatorë nga aktet nënligjore të Komisionit Rregullator për Energjetikë, me të cilat rrezikohet ekzistenca e një numri të madh të qytetarëve.

Lidhur me të njëjtën iniciativë, *Komiteti i Helsinkit* ka konstatuar mungesa edhe në Ligjin për referendum dhe forma të tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, në pjesën e realizimit të iniciativës qytetare në nivel të shtetit. Në këtë ligj nuk ka afat të përcaktuar qartë, gjatë të cilit kryeministri duhet ta njoftojë organin e administratës shtetërore, që është kompetent për evidencën e të drejtës zgjedhore, se mund të fillojë me tubimin e nënshkrimeve të nevojshme për ngritjen e iniciativës qytetare. Mbi këtë bazë, afati prej tre muajsh i paraparë për tubimin e nënshkrimeve dukshëm zvogëlohet, me të cilën gjë shkelet e drejta e pjesëmarrjes në marrjen e vendimeve publike përmes formave të demokracisë direkte. Kjo ishte rast edhe me iniciativën qytetare AMAN, e cila më 18 tetor 2012 filloi me procedurën për tubimin e 10.000 nënshkrimeve konform Ligjit

⁵⁷ Avokati i Popullit (2012) Raport vjetor për shkallën e sigurimit, respektimit, përparimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Fq. 51. Arritur përmes: www.ombudsman.mk

për referendum dhe formave të tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, me qëllim që të bëhen ndryshime në Ligjin për energjetikë. Por, sipas *Komitetit të Helsinkit*, kryeministri e keqpërdori afatin e padefinuar, gjatë të cilit do të duhet ta njoftojë organin e Administratës shtetërore që është kompetent për evidencën e të drejtës zgjedhore, në këtë rast Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve. Edhe pse iniciativa ishte në rregull, e lejuar nga ana e kryetarit të Kuvendit dhe dy komisioneve kuvendore në afatet ligjore, Qeveria nuk e njoftoi KSHZ që të vepronte menjëherë mbi bazë të iniciativës, me të cilën gjë afati prej 3 muajsh për tubimin e 10.000 nënshkrimeve do të ishte shkurtuar dukshëm. Procedura filloi më 6 dhjetor 2012 dhe zgjati deri më 30 janar 2013. Me këtë Qeveria në mënyrë të drejtpërdrejtë e rrezikoi këtë të drejtë dhe e shkurttoi kohëzgjatjen e procedurës në më pak se tre muaj, sa parashihet në ligj.

Prioritete në lidhje me bashkëpunimin midis OC që punojnë në këtë sferë dhe mediave

- **Njohja e opinionit me të drejtat politike dhe civile, si dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre.**

Qytetarët kanë njohje të vogla për të drejtat e njeriut dhe për mekanizmat për mbrojtje dhe reagim po qe se ato të drejta iu shkelen. Ky është konkluzion i institucioneve dhe organizatave relevante, siç është *Avokati i Popullit*, por dhe pjesa më e madhe e përfaqësuesve të OC që ishin pjesë e hulumtimit që MIM e realizoi për nevojat e këtij projekti. Kjo ndodh kështu për faktin se mediat informojnë në një nivel të pamjaftueshëm për tema që lidhen me të drejtat e njeriut, gabim i trajtojnë ose i interpretojnë këto çështje, por dhe fakti që kjo sferë nuk është boll e pranishme në kuadër të sistemit arsimor. Nga ana tjetër, ndërkaq, edhe vetë OC nuk realizojnë fushata të vazhdueshme edukative për opinionin e gjerë, shkaku i mungesës së mjeteve, e ndonjëherë edhe shkaku i mungesës së iniciativave, paqëndrueshmërisë në shtyrjen e temave, mosnjohjes së problemeve dhe mosnjohjes së mënyrave kreative se si të vihet deri te mediat dhe qytetarët.

- **Rritja e transparencës në punën e organizatave joqeveritare që punojnë në këtë sferë**

Hulumtimet⁵⁸ tregojnë se mediat përgjithësisht nuk janë mjaft të interesuara për punën e OC. Në intervistat që i bëri MIM me përfaqësuesit e OC dhe mediave para se të shkruhej Libri i Bardhë, bashkëbiseduesit kanë bërë të ditur se OC dhe mediat në të shumtën e rasteve bashkëpunojnë kur bëhet fjalë për disa ngjarje aktuale, edhe atë më shpesh në nivelin e transmetimit të informacioneve nga OC, pa i analizuar ose interpretuar më thellë ngjarjet dhe të dhënat. Mediat, ndërkaq, sektorin civil shpeshherë e përjetojnë si të politizuar dhe të varur nga qendra të ndryshme të fuqisë. Për këtë shkak, si dhe për shkak të “etiketave” që i bartin vetë OC, mediat nuk i mbulojnë aktivitetet e disa prej tyre. Nga ana tjetër, ndërkaq, politika redaktuese e vetë mediave, si dhe ndikimet

⁵⁸ Hulumtimet e MIM, TACSO dhe USAID-it.

politike dhe ekonomike që “thyhen” mbi to, shpeshherë janë shkak që OC ose iniciativa të caktuara nuk mund të depërtojnë në media dhe të arrijnë te qytetarët.

- **Polarizimi i shoqërisë dhe refleksionet në hapësirën mediatike.**

Një prej vërejtjeve të organizatave civile është se polarizimi i shoqërisë mbi bazë etnike reflektohet edhe në hapësirën mediatike, për të cilën gjë shumë informacione për shkeljen e të drejtave të njeriut, për shembull, në kuadër të bashkësisë etnike shqiptare, mbeten “të robëruara” në mediat në gjuhën shqipe. Në këtë situatë, as organizatat civile që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, as edhe opinioni më i gjerë, nuk kanë informacione të mjaftueshme për raste të caktuara të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe as mund t’i regjistrojnë, as të reagojnë. Ky problem është me rëndësi të identifikohet për shkak se është ngushtë i lidhur me funksionimin e shoqërisë dhe të sistemit juridik, si dhe me realizimin e të drejtave politike dhe civile.

Polarizimi politik i mediave, ndërkaq, është problem kronik dhe në rritje i vërejtur nga ana e organizatave relevante vendore dhe ndërkombëtare. Mbyllja e emisioneve debative, lëshimi i gazetarëve nga vendet e punës për shkak të papërshtatshmërisë politike, njëanshmëria dhe vetë censura e gazetarëve dhe shtëpive mediatike, kualiteti i dobët i përmbajtjeve mediatike, vetëm e ngushtojnë spektrin e pikëpamjeve që artikuloohen në publik dhe e kufizojnë qasjen e qytetarëve në informacionet e balancuara dhe kritike.

- **Pengimi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit**

Gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi gjithnjë e më tepër po gjejnë pasqyrim në hapësirën mediatike, qoftë në mediat tradicionale, qoftë dhe në ato të rejtat e sociolet. Viteve të fundit, mediat shpeshherë gjenden në rolin e nxitësve ose forcuesve të porosive diskriminuese, por dhe të shpërndarësve të gjuhës së urrejtjes, gjë që shumë rrallë sanksionohet nga ana e organeve kompetente. Në këtë kontekst, trend brengosës është edhe i ashtuquajturit solidarizim i heshtur i gazetarëve ose mediave me kolegët e tyre, përkatësisht mungesa e reagimit ose dënimit kur gazetarët diskriminojnë ose përdorin gjuhën e urrejtjes.

Bashkëpunimi midis OC dhe mediave duhet të fokusohet në atë se si t’u ndihmojnë qytetarëve që më lehtë t’i njohin format e ndryshme të diskriminimit, që pastaj të mund t’i alarmojnë mediat dhe OC dhe ato në kohë të reagojnë. Nga ana tjetër, edhe gazetarët duhet të bëhen “më të ndjeshëm” gjatë identifikimit të rasteve të diskriminimit, me të cilën gjë do ta zbusin efektin ose do ta ndërpresin trendin e zgjerimit të diskursit diskriminues. Njëkohësisht, duhet të zhvishet praktika e tolerimit të gjuhës së urrejtjes, edhe atë për shkak të gjoja mbrojtjes, përkatësisht mundësimin të lirisë së shprehjes, siç kuptohet shpesh edhe nga ana e vetë profesionistëve mediatik. Përzjerja e këtyre dy koncepteve, në të vërtetë, paraqet argumentin për përdorimin e gjuhës së urrejtjes.

Fokus plotësues në bashkëpunimin midis OC dhe mediave duhet të jetë edhe krijimi i presionit ndaj institucioneve siç është *Komisioni për Mbrojtje dhe Pengim të Diskriminimit*, *Avokati i Popullit*, *Këshilli i Radiodifuzionit* dhe trupa dhe institucione të tjera kompetente për t’i treguar dhe për t’i sanksionuar këto dukuri.

- **Mbrojtja e prezumimit të pafajësisë.**

Edhe pse ky është njëri prej parimeve kryesore, sipas të cilit duhet të udhëhiqet gazetaria, njësoj si dhe institucionet, megjithatë shkëlja e rregullës për prezumim të pafajësisë dukshëm është e pranishme në media. *Avokati i Popullit* dhe *Komiteti i Helsinkit* konfirmojnë se vazhdon të përsëritet praktika e publikimit të emrave ose e paraqitjes së fytyrave të personave të dyshuar, me të cilën gjë ata stigmatizohen në opinion.

Organizatrat civile, por edhe organizatat mediatike profesionale, duhet të alarmojnë dhe t'i përkujtojnë gazetarët dhe mediat që t'i respektojnë pafajësinë, privatësinë dhe dinjitetin e secilit individ. Gazetarët duhet t'u përmbahen me dinjitet parimeve etike që i obligojnë të publikojnë informacione të sakta dhe të konfirmuara. Vetë institucionet, ndërkaq, edhe krahas asaj që video-materialet prej arrestimeve të të dyshuarve në raste ndryshme mund të shërbejnë si argument për transparencë dhe korrektësi ndaj veprimit, duhet të kenë kujdes faktin se me "rrjedhjen" e materialeve, edhe vetë marrin pjesë në thyerjen e parimit të prezumimit të pafajësisë.

Komiteti i Helsinkit propozoi precizimin e standardeve etike dhe profesionale edhe për mediat edhe për institucionet, për raportim, përkatësisht për informim nga rastet penale dhe procedurat gjyqësore.

II.2. PRIORITETE NË SFERËN E TË DREJTAVE TË GRAVE

Në raport me kornizën normative që prek të drejtat e grave duhet të theksohet se Maqedonia në vitin 2012 nxori Ligjin për mundësi të njëjta midis grave dhe burrave, si dhe amendamentet në Ligjin për marrëdhënie pune, me të cilët në mënyrë eksplicite ndalohet diskriminimi i grave punëtore gjatë kohës së shtatzënisë, rolit amnor dhe prindëror. Shteti i ka plotësuar obligimet e veta normative në pjesën e nxjerrjes së Strategjisë nacionale (2011-2020) dhe të Planit aksional për barazi gjinore (2013-2016), Strategjisë nacionale për pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje (2012-2015), Planit aksional nacional për promovimin e statusit të gruas rome (2008), Strategjisë nacionale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrantë ilegal (2009-2013), si dhe Strategjisë për buxhetim të përgjegjshëm gjinor (2012-2015), konform të të cilëve organet e administratës shtetërore obligohen që ta inkorporojnë parimin e mundësive të njëjta për gratë dhe burrat në planet dhe buxhetet e tyre strategjike. Plus kësaj, Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi përfshin definicione për diskriminim mbi bazë të gjinisë.

Megjithatë, gjendja faktike tregon se implementimi i ligjeve në praktikë po zhvillohet me mjaft vështirësi, për shkak të lëshimeve në raport me masat dhe mekanizmat për aplikimin e tyre gjegjësi, si dhe për shkak të mungesës së sanksioneve gjegjëse për mosrespektimin dhe mosrealizimin e dispozitave ligjore. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në nivel lokal ende nuk aplikohet në masë të duhur, për shkak se çështjet gjinore dhe nevojat e ndryshme të grave dhe të burrave aspak nuk trajtohen si të rëndësishme, të

cilat mund të ndihmojnë në realizimin e objektivave të vetëqeverisjes lokale.⁵⁹ *Këshilli Nacional për Barazi Gjinore (KNBGJ)* ka konstatuar se Komisioni për Mundësi të Njëjta të Grave dhe të Burrave në nivel nacional dhe komisionet për mundësi të njëjta në nivel lokal nuk e kryejnë funksionin e tyre, nuk i njohin boll kompetencat e tyre dhe nuk kanë programe adekuate për punë, gjë që rezulton me mungesë të aksioneve konkrete dhe të rezultateve të dukshme në fushën e barazisë gjinore.

Shteti përpiqet që përmes programeve dhe masave të ndryshme për punësim aktiv t'i përfshijë edhe gratë nga mjediset rurale, si njëra prej grupeve më të rrezikuara, por këto përpjekje nuk janë të mjaftueshme, para së gjithash për mungesë të serviseve shtesë në ato mjedise, si për shembull, çerdhe ose shtëpi azili për pleqtë. Hulumentimi i USAID⁶⁰ në vitin 2011 konstatoi se në Maqedoni njëri prej problemeve më të mëdha është papunësia te gratë. Këtu ndërlihet edhe problemi me segregacionin horizontal, përkatësisht përfshirjen më të madhe të grave në profesione të caktuara, të cilat përgjithësisht janë më pak të paguara (industria e tekstilit, shitja, shërbimet sociale e të ngjashme).

Vërejtjet nga ana e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB bëjnë të ditur se mungojnë informacionet për rezultatet e pritura nga Strategjia nacionale dhe nga Plani aksional për barazi ndërmjet gjinive dhe procedurave për implementimin, monitorimin dhe evaluimin e politikave, si dhe ajo që mungojnë resurse nacionale për implementimin e këtyre dokumenteve që duhet të nxisin luftën kundër diskriminimit të grave, sidomos të atyre që iu takojnë bashkësive të tjera etnike, grave shqiptare dhe rome, të cilat i nënshtrohen diskriminimit të dyfishtë.⁶¹

Prej asaj që ndodhte në praktikë në disa vite të fundit, duhet të shënohet rritja e trendit të vlerave tradicionale dhe patriarkale retrograde, edhe atë përmes masave legislative dhe programore. Kjo u shoqërua me fushata mediatike intensive për promovimin e familjes me më shumë fëmijë, si dhe të fushatave për pasojat e dëmshme nga aborti. Edhe përfaqësuesit kishtarë u përfshinë në krijimin e pamjes stereotipe për gruan në familje dhe shoqëri. Këto ndodhi, e sidomos miratimi i shpejtë i Ligjit të ri për ndërprerjen e shtatzënisë, ngritën një mori aksionesh nga ana e organizatave joqeveritare dhe opinionioni profesional, i cili në të pa kufizimin e “zgjedhjes së lirë të gruas për të ndërprerë shtatzëninë dhe fushatën qeveritare kundërkushtetuese kundër abortit, me të cilën degradohet dhe stigmatizohet gruaja, partnerët e saj dhe familja më e afërt”.⁶²

59 Këshilli Nacional për Barazi Gjinore. „Çështjet gjinore dhe mbrojtja sociale në komunën Qendër dhe Goshtar“. Raport i përgatitur në kuadër të projektit „Promovimi i politikave të përgjegjshme gjinore në Evropën Juglindore“ (2011-2013) i UN Women

60 USAID (2011) Promovimi i mekanizmave vetëpërmbytës të grave në Evropë dhe në Euroazi. Arritur përmes: http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADW786.pdf

61 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB (CEDAW) (2013) „Shikime përfundimtare për raportin e katërt dhe të pestë periodik të Maqedonisë“. Paragrafi 16. Arritur përmes: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G13/421/54/PDF/G1342154.pdf?OpenElement>

62 Ueb-faqja e OC Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumentim-H.E.R.A. Arritur përmes: <http://hera.org.mk/?p=281>

Në përgatitjen e pjesës që vjen në vazhdim, që i takon të drejtës së grave, kanë marrë pjesë organizatat civile: *Këshilli Nacional për Barazi Gjinore (KNBGj, ish-LOGM), Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe për Hululumtim H.E.R.A. Dera e Hapur- "La strada", dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RM.* Për "diagnostikimin" detal të disa prej problemeve të kësaj sfere, si dhe për përcaktimin e prioritetëve në bashkëpunim me OC dhe mediat, në një pjesë të madhe janë shfrytëzuar konstatimet dhe rekomandimet e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB, por edhe raporte të tjera relevante.

- **Transparenca dhe koordinimi i institucioneve shtetërore.** Mungesa e transparencës, në vendosje dhe koordinim mes institucioneve shtetërore, dëfton se shteti i jep prioritet të ulët parimit të barazisë gjinore, bën të ditur Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB⁶³ në raportin për vitin 2013. Kjo trupë është shprehur e brengosur në lidhje me shikimin dhe qasjen e dobët në mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të grave, siç janë përfaqësuesi ligjor në kuadër të Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale, Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Seksioni për Mbrojtjen e Qytetarëve nga Diskriminimi në kuadër të Zyrës së Avokatit të Popullit, për puqjen e kompetencave të tyre, si dhe për numrin e vogël të ankesave për diskriminim mbi bazë të gjinisë që janë marrë prej tyre dhe që iu janë dorëzuar gjyqve.

Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Maqedonisë për vitin 2013 konstaton se nuk ka qasje strategjike për realizimin e strategjive dhe planeve aksionale nacionale dhe se këto procese zhvillohen ngadalë.

- **Diskriminimi dhe stereotipizimi i grave.** Më shumë raporte⁶⁴ bëjnë të ditur për shtrirjen e gjerë të traditës dhe të zakoneve diskriminuese në Maqedoni, si dhe mbetjen e vazhdueshme të stereotipave që e stërthejnë rolin tradicional të grave si nëna dhe bashkëshorte, me të cilën gjë nënçmohet statusi social i grave, kapacitetet e tyre arsimore dhe profesionale. Ky problem është i theksuar sidomos te gratë e mjediseve rurale. Në këtë kontekst dëftohet se mediat me ngulm transmetojnë pamje stereotipe, e ndonjëherë edhe nënçmuese, të grave.⁶⁵ Në drejtim të ngritjes së pamjes stereotipe për gruan kanë kontribuar edhe më shumë deklarata nga përfaqësuesit e lartë kishtarë dhe qeveritarë në vitet e kaluara. Këto deklarata janë përputhur me fushatat me të cilat janë promovuar vlerat familjare. Prej vitit 2009 Qeveria realizon fushatën për shpjegimin e pasojave nga aborti "Zgjidh jetën, ke të drejtën e zgjedhjes", e cila sipas organizatave joqeveritare i diskriminon dhe i shkel të drejtat riprodhuese të gruas, e në të njëjtën kohë i stigmatizon ato që kanë bërë ose që planifikojnë të bëjnë abortin. Problem kyç me fushatat, siç tregohet në një broshurë të shkurtër të Shoqatës për Emancipim, Solidaritet dhe

63 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB (CEDAW) (2013) "Shikime përfundimtare për raportin e katërt dhe të pestë periodik të Maqedonisë". Arritur përmes: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G13/421/54/PDF/G1342154.pdf?OpenElement>

64 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB (CEDAW) (2013) „Shikime përfundimtare për raportin e katërt dhe të pestë periodik të Maqedonisë“; Komisioni Evropian (2013) Raport për progresin e Republikës së Maqedonisë

65 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB (CEDAW) (2013) „Shikime përfundimtare për raportin e katërt dhe të pestë periodik të Maqedonisë“. Paragrafi. 20. Arritur përmes: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G13/421/54/PDF/G1342154.pdf?OpenElement>

Barazi të Grave në RM –ESE dhe OC H.E.R.A., është që Qeveria harxhon më shumë mjete për fushata sesa për përparimin e shëndetit të grave. Kështu, sipas të njëjtit burim, në vitin 2009, për shembull, Qeveria ka harxhuar 36 milionë denarë për këtë fushatë, që është më shumë se sa mjetet që i ndanë për programet për mbrojtje shëndetësore aktive të nënave dhe fëmijëve dhe për detektimin e hershëm të sëmundjeve malinje.⁶⁶ Pas shumë reagimeve që i shkaktoi fushata, një nga spotet kundër abortit ishte larguar nga eteri nga ana e Këshillit të Radiodifuzionit.

Gratë, përfshi edhe ato nga grupet tjera etnike, nuk janë të përfshira mjaftueshëm në jetën politike dhe në pozitat e larta udhëheqëse, sidomos në nivel lokal⁶⁷. Kjo vërejtje e Komitetit kompetent në kuadër të KB është plotësuar me brengosjen se mungojnë masa të veçanta për promovimin dhe rritjen e përfshirjes. Komiteti, gjithashtu, e notifikon edhe numrin e vogël të ankesave mbi bazë të diskriminimit seksual drejtuar institucioneve dhe trupave kompetente ose gjyqeve.⁶⁸

• **Gjendja me gratë rome.** Pjesëtarët e bashkësisë rome janë në margjinat e shoqërisë dhe ballafaqohen me diskriminim të shumëfishtë, por dhe me probleme rreth qasjes tek institucionet dhe te serviset shtetërore. Gratë rome kanë mundësi të pabarabarta në arsim dhe punësim, gjë që rezulton nga kufizimet tradicionale dhe religjioze të arsimimit të tyre, si dhe të rolit të tyre në familje.⁶⁹ Problemet më të shpeshta me të cilat ballafaqohen ato lidhen edhe me banimin dhe mbrojtjen shëndetësore gjegjëse, me dokumentet për identifikim, mbrojtjen nga dhuna dhe qasjen te drejtësia. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB, kompetent në kuadër të KB, ka vërejtur se Qeveria nuk ndërmerr masa të mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave rome, dhe për diskriminimin e dyfishtë mbi bazë të gjinisë dhe të përkatësisë etnike me të cilat ato ballafaqohen në realizimin e të drejtave të tyre civile dhe politike. Institucionet vendore dhe ndërkombëtare, që e mbikëqyrin këtë sferë, raportojnë se dokumentet strategjike siç janë Plani nacional për promovimin e statusit të gruas rome dhe Strategjia, miratuar në vitin 2008, nuk zbatohen, as që financohen në mënyrë adekuate.⁷⁰ *Amnesti Interneshënell* është relativisht i ashpër në raportin e vet, duke konstatuar se shteti në pesë vitet e fundit nuk ka ndërmarrë masa që t'i adresojë rekomandimet e Komitetit kompetent në kuadër të KB që kanë të bëjnë me diskriminimin e shumëfishtë me të cilin ballafaqohen gratë dhe vajzat rome.⁷¹

66 Broshurë e Shoqatës për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave në RM-ESE dhe OC H.E.R.A. Arritur përmes: www.hera.org.mk.

67 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB (CEDAW) (2013) „Shikime përfundimtare për raportin e katërt dhe të pestë periodik të Maqedonisë“; Komisioni Evropian (2012) Raport për progresin e Maqedonisë

68 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB (CEDAW) (2013) „Shikime përfundimtare për raportin e katërt dhe të pestë periodik të Maqedonisë“. Paragrafi 10, 12. Arritur përmes: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G13/421/54/PDF/G1342154.pdf?OpenElement>

69 Ibid

70 Amnesti Interneshënell (2013) „Masa speciale për gratë dhe vajzat rome – brifing për Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB.“ Arritur përmes: <http://www.amnesty.org>

71 Ibid

Shkalla e vajzave rome që e braktisin shkollën është e lartë, ndërsa numri i grave rome që vazhdojnë në shkollë më të larta të arsimit është i vogël. Në shkollat për fëmijë me nevoja të veçanta, sipas të dhënave të Avokatit të Popullit, ka një numër të madh fëmijësh nga bashkësia rome, përfshi edhe vajza.

Qeveria ndërmerr disa prej masave për përmirësimin e gjendjes së grave rome, si për shembull miratimin e Planit të dytë aksional nacional për përpërimin e gjendjes shoqërore të grave rome në Republikën e Maqedonisë (2011-2013), që përfshin katër sfera me prioritet: punësimin, shëndetësinë, arsimin dhe të drejtat e njeriut. Në këtë kuadër, janë realizuar dy stërvitje, është shtypur doracaku për të drejtën e trajtimit dhe të mbrojtjes së barabartë nga diskriminimi, si dhe një material drejtues për qasjen të shërbimit e institucioneve shtetërore nga ana e romëve, sidomos e graveve. Megjithatë, këto aktivitete nuk janë të mjaftueshme për përmirësimin e statusit dhe të gjendjes së gruas rome.

- **Gratë në viset rurale dhe grupe të tjera të grave të marginalizuara.** Gratë që jetojnë në viset rurale në Maqedoni, gjithashtu gjenden në një pozitë mjaft të pavolitshme, për shkak të qasjes së kufizuar në shërbimet shëndetësore dhe sociale, pjesëmarrjes së vogël në procesin e marrjes së vendimeve në nivel të bashkësisë, në arsim, si dhe në tregun formal të punës, vlerëson Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB.

Sipas disa hulumtimeve, vetëm 1-2% e tokës në mjediset rurale është në pronësi të grave, para së gjithash për shkak të mënyrës tradicionale të të menduarit, ku patundshmeritë vihen në emrin e anëtarëve meshkuj të familjes. Për këtë shkak gratë nuk mund t'i shfrytëzojnë beneficionet (si, për shembull, subvencionet etj.) që i ofron Qeveria, si pjesë e masave për ndihmë.

Në kategorinë e grupeve të marginalizuara të grave hyjnë edhe gratë shqiptare, veçuesht, gratë më të moshuara dhe gratë me nevoja të veçanta, të cilat po ashtu ballafaqohen me diskriminim, ndërkohë që nuk ndërmerren masa të mjaftueshme për përfshirjen e tyre efektive në shoqëri.

Në një situatë sidomos të rëndë janë gratë që janë të marginalizuara mbi bazë të prostitucionit, shtojnë nga *Këshilli Nacional për Barazi Gjinore (KNBGJ)*. Prostitucioni trajtohet si problem individual, ndërkohë që përgjigje institucionale për këtë problem nuk ka. Aktivitetet që janë ndërmarrë deri tani nga ana e shtetit nuk kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së punëtoreve seksuale, sidomos kur kihet parasysh shkelja e të drejtave që ato kanë dhe rritja e stigmatizimit dhe diskriminimit të tyre.

- **Dhuna në familje.** Në korrik të vitit 2012 Qeveria ka miratuar Strategjinë nacionale për pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje (2012-2015), që do të implementohet përmes pesë sferave strategjike: pengimi, mbrojtja, ndihma dhe mbështetja ndaj viktimave të dhunës në familje; ndjekja e autorëve të veprave; bashkëpunimi në më shumë sektorë dhe ngritja e kapaciteteve institucionale; ndjekja dhe evaluimi i situatës. Nga ana e Qeverisë është formuar edhe Trupa Koordinuese Nacionale për Pengimin dhe

Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, ku anëtarësojnë përfaqësues nga ministritë e dikasterit, deputetë në Kuvend dhe përfaqësues nga Rrjeti Nacional për Dhunën në Familje, përbërë nga organizatat joqeveritare që punojnë në këtë fushë.

Dhunimi, përfshi edhe në kuadër të martesës, është jolegal, por për shkak të implementimit të dobët të ligjeve në Maqedoni, dënimet nuk e pengojnë në masë të mjaftueshme këtë dhunë, thuhet në Raportin e Stejt Departamentit për vitin 2012. Policia dhe gjyqet janë mëdyshur për ta ndjekur dhunimin gjatë martesës, e në të shumtën e rasteve edhe vetë viktimat i janë shmangur paraqitjes dhe ngritjes së padisë për shkak të stigmës së mundshme shoqërore dhe kulturore.

Këshilli Nacional për Barazi Gjinore angazhohet dhe punon në drejtim të ratifikimit sa më të shpejtë të Konventës për Pengimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, të cilën shteti e ka nënshkruar në vitin 2011.⁷² Ratifikimi dhe aplikimi i kësaj Konvente dukshëm do të kontribuojë në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Për viktimat e dhunës në familje ka strehimore (shellter-qendra) me kapacitete të kufizuara, të cilat i hapi Qeveria dhe sektori joqeveritar, si dhe linja telefonike SOS. Ato tashmë një periudhë të gjatë ballafaqohen me jofunksionalitet të sistemeve për mbrojtje dhe uljen e numrit të qendrave mbrojtëse (prej 6 tani funksionojnë 2 – një në Shkup dhe një në Strumicë, si dhe një qendër krize “Shpresa” për përkujdesjen e viktimave të dhunës deri në 48 orë, gjithashtu, në Shkup), që është rezultat i mungesës së mbështetjes financiare dhe i masave të tjera sistemore që çojnë në forcimin e kapaciteteve të strukturave profesionale, konsiderojnë nga KNBGJ. Plus kësaj, strehimoret ekzistuese kanë kapacitete të kufizuara, për të cilën gjë viktimat ndonjëherë detyrohen që të vendosen në qendrat shelter nëpër qytetet tjera, gjë që shkakton vështirësi gjatë udhëheqjes së procedurave gjyqësore, ka vërejtur *Komiteti i Helsinkit*. Edhe pse në Ligjin për ndihmë juridike falas, viktimat e dhunës në familje janë përfshirë si kategori e veçantë e kërkuesve të ndihmës juridike falas, megjithatë një numër fare i vogël i rasteve kanë marrë ndihmën juridike.

Komiteti i Helsinkit konsideron se imponohet nevoja e ndryshimit të ligjit dhe lehtësimin e kushteve të viktimave të dhunës në familje për të marrë ndihmën juridike falas. Në tetor të vitit 2013 OC H.E.R.A. e hapi qendrën e parë familjare për dhunën në familje të qytetit të Shkupit, e cila do të duhet t’i integrojë të gjithë faktorët e përfshirë në dhunën në familje, qoftë gratë dhe fëmijët – viktimat e dhunës në familje, ashtu dhe autorët e dhunës në familje.⁷³ Për shkak të numrit të kufizuar të aktiviteteve në drejtim të ngritjes së vetëdijes publike për dhunën në familje, ka tendencë të rënies së paraqitjes së dhunës në familje nga ana e grave rome dhe shqiptare, konstatojnë nga *Komiteti i Helsinkit*.

⁷² Shih më shumë në këtë ueb-faqe: <http://www.potpisuvam.org/>

⁷³ Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim-H.E.R.A. Arritur përmes: http://hera.org.mk/?page_id=877

• **Tregtia me njerëz.**⁷⁴ Maqedonia është vend tranzit, vend-destinacion për viktimat e tregtisë me njerëz, por edhe vend i lindjes së saj. Informatat nga burime të ndryshme dëftojnë se disa prej viteve të fundit po shënohet rritje e numrit të shtetasve maqedonase, në të shumtën e rasteve të mitura, të cilat janë tregtuar nga njëri skaj në skajin tjetër të Maqedonisë. Bëhet fjalë për tregtinë e ashtuquajtur “të brendshme” me njerëz. Këto informata i pohn edhe statistika e OC *Dera e Hapur – La Strada*. Në të vërtetë, prej vitit 2005 deri 2012 gjithsej 100 persona, pjesa më e madhe gra dhe vajza, kanë qenë të përfshirë në programin për asistencë sociale të kësaj OC. Sidomos brengos fakti që viktimat nga tregtia me njerëz gjithnjë janë më të reja – madje 69% e numrit të përgjithshëm të viktimave të tregtisë me njerëz, të cilëve “Porta e Hapur” iu ka ofruar ndihmë, kanë qenë të mitur, të moshës prej 13 deri 18 vjeç.

Prej shtatorit të vitit 2009 deri në qershor të vitit 2013 Ministria e Punëve të Brendshme ka zbuluar gjithsej 15 vepra “tregti me njerëz” dhe “tregti me persona të mitur”, për të cilën gjë janë paraqitur 56 autorë. Viktimat në veprat e theksuara penale kanë qenë 18 gra, prej të cilave 13 kanë qenë të mitura.

Rritja e numrit të viktimave vendore nga tregtia me njerëz është rezultat i varfërisë dhe i shkallës së papunësisë, si dhe i kushteve të këqija sociale në shtet, konstatojnë në *Porta e Hapur*, si rezultat i përvojës dhe hulumtimit të tyre. Rrjedhimisht me këtë, shkalla e lartë e të gjitha llojeve të dhunës, sidomos e dhunës në familje, në mënyrë indirekte kontribuon në rritjen e numrit të viktimave nga tregtia me njerëz.

Sipas të dhënave nga *Porta e Hapur*, eksploatimi seksual është forma më e përfshirë e tregtisë me njerëz në Maqedoni. Edhe pse ka informata për tregti me njerëz, qëllimi i së cilës është eksploatimi në punë, megjithatë numri i rasteve të këtilla është i vogël, ashtu sikurse dhe numri i viktimave të identifikuar dhe të mbrojtura ose i autorëve që penalisht janë të ndjekur dhe të dënuar. Në mënyrë plotësuese, duhet pasur kujdes për një vëmendje të shtuar në migrimin ilegal, që ka trend rritjeje, por edhe në identifikimin më aktiv të viktimave potenciale të tregtisë me njerëz midis migrantëve dhe sigurimin e qasjes në programet dhe shërbimet gjegjëse për ta.

Konstatim i përgjithshëm i organizatave vendore dhe ndërkombëtare është se numri i përgjithshëm i viktimave të identifikuar të tregtisë me njerëz nga ana e institucioneve në nivel vjetor është shumë i vogël në krahasim me të dhënat nga rajoni, gjë që, veç tjerash, çon në konstatimin se kompetentët nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për njohjen e indikatorëve për identifikim. Me këtë kufizohen mundësitë që të gjitha viktimave t’u sigurohet mbrojtja, mbështetja dhe riintegrimi i garantuar ligjor.

Maqedonia ka miratuar Strategjinë nacionale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrantë ilegalë (2009-2013), megjithëkëtë *Komiteti për Eliminim të Diskriminimit Kundër Gruas* në raportin e tij për vitin 2013 shprehet i shqetësuar për shkak të mungesës së transparencës dhe koordinimit të mekanizmave institucional relevant, numrit të madh të vajzave që janë tregtuar për shkak të eksploatimit seksual, mungesës së masave preventive

⁷⁴ Kjo pjesë është përgatitur në bashkëpunim me OC Porta e hapur – “La Strada” dhe bazohet në hulumtimet dhe përvojat e tyre

për adresimin e rrënjëve që e shkaktojnë tregtinë me njerëz, sidomos të gruas rome, si dhe për shkak të mungesës së informatave për programet për risocializim.

Sipas praktikës së sotme, numri më i madh i serviseve me qasje për viktimat e tregtisë me njerëz, siç janë ndihma mjekësore, ndihma juridike, arsimi dhe kualifikimi i mëtejshëm, janë në shpinë të organizatave civile. Qendra shtetërore për personat viktimë të tregtisë me njerëz, edhe pse është nën kompetencat e Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale, në një pjesë shumë të vogël është e financuar nga institucioni, ndërsa për funksionimin e saj 24 orë janë të ngarkuara dy organizata joqeveritare të cilat sigurojnë kapacitetet e veta njerëzore dhe financiare.

Plus kësaj, viktimave iu shkurtohet e drejta e riintegrit, për shkak të mungesës së programit riintegruës institucional për viktimë të rritura të tregtisë me njerëz, ndërsa programi ekzistues i MPPS për riintegrim të fëmijëve-viktima të tregtisë me njerëz realisht nuk realizohet dhe duhet të rivedohet.

Fëmijët-cak i lehtë për tregtarët me njerëz

Fëmijët janë cak i lehtë i tregtarëve për shkak se kanë kapacitet të zvogëluar për ta njohur rrezikun. Si viktimë më të shpeshta paraqiten fëmijët që kanë qenë lëndë e shfrytëzimit seksual, dhunës, braktisjes nga prindërit, fëmijëve që kanë qenë të ndarë nga familja, fëmijët e paregjistruar, fëmijët jashtë procesit arsimor dhe fëmijët e rrugës. Të gjitha këto kategori fëmijësh janë nën rrezik të madh që të bëhen pjesë e rrjeteve të tregtisë me fëmijë. Fëmijët – viktimë të tregtisë shpesh vijnë nga familjet e varfra, me mungesë mundësish ekonomike dhe arsimore.

Prioritete në lidhje me bashkëpunimin midis OC që punojnë në këtë sferë dhe mediat

• Pengimi dhe mbrojtja nga diskriminimi përmes mediave

Është e nevojshme që të punohet në ngritjen e vetëdijes të vet mediave për temat që lidhen me të drejtat e gruas, me të cilën gjë do të eliminohen stereotipat negativ dhe në vend të kësaj do të promovohen tregime pozitive për gratë që kanë arritur të realizohen si profesioniste në sfera të ndryshme.⁷⁵ Gazetarët vazhdimisht duhet të kujtohen se duhet ta respektojnë Kodin etik në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të dinjitetit dhe të lirisë, si dhe pluralizmin e ideve dhe të qëndrimeve dhe të raportojnë në pajtim me këto parime. Mediat, përmes mekanizmave vetërregullatorë dhe përmes bashkëpunimit me OC duhet të paralajmërojnë dhe ta pengojnë paraqitjen degraduese të gruas në media. Plus kësaj, gazetarët duhet të jenë të stërvitur në mënyrë adekuate që t'i identifikojnë dhe t'i njohin këto dukuri, por edhe të mos i transmetojnë, përkatësisht mos ta forcojnë mesazhin negativ.

⁷⁵ Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB (CEDAW) (2013) „Shikime përfundimtare për raportin e katërt dhe të pestë periodik të RM miratuar nga Komiteti në Sesionin e 54-të. Paragrafi 21. Arritur përmes: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cedaw/cedaws54.htm>

- **Rritja e pragut të “ndjeshmërisë” te mediat në lidhje me çështjet gjinore**

Mediat shpeshherë transmetojnë pamje dhe mesazhe stereotipe për gratë dhe rolin e tyre në familje dhe shoqëri. Për këtë shkak, nevojitet ndjeshmëri më e madhe e gazetarëve kur mbulojnë tema që lidhen me gratë. Nga KNBGJ (Këshilli Nacional për Barazi Gjinore) kanë vërejtur se ndonjëherë edhe zgjedhja e shprehjeve dhe fjalëve të gazetarëve kontribuon në krijimin e pamjes me stereotipi të gruas në shoqëri. Pikërisht për këtë, kjo gjithnjë duhet të identifikohet dhe të tregohet nga ana e OC që punojnë në këtë sferë. Bashkëpunimi midis OC dhe gazetarëve duhet të përfshijë edhe mekanizmin e këtillë të korrekturës – përkatësisht OC t’i paralajmërojnë mediat gjithnjë kur do të vërejnë se përhapin stereotipi, paragjykime ose pamje nënçmuese për gratë.

- **Nevojë për raportim mediatik më të thelluar**

Përmes raportimit të qëndrueshëm, të vazhdueshëm dhe të thelluar për tema thelbësore që lidhen me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të gruas, do të shtohet transparenca e OC në media dhe do të ndikohet në rritjen e vetëdijes për këto tema. Në Maqedoni çdo e katërta grua është viktimë e dhunës në familje, për shembull, por në media kjo çështje përpunohet në një mënyrë mjaft sipërfaqësore, e më rrallë gjenden analizat e thelluara për shkaqet e kësaj gjendjeje. Kundrejt kësaj, nga KNBGJ tërheqin vërejtjen se interesimi i mediave ndaj “temave të grave” rritet në periudha të caktuara, si për shembull për 8 Mars, ose kur do të paraqitet ndonjë problem. Vetëm atëherë organizatat e grave marrin termin qendror dhe shikim më të madh në media, ndërsa në kohën tjetër, mund të depërtojnë vetëm te një publik i kufizuar.

- **Ngritja e vetëdijes publike për pengimin e dhunës ndaj grave**

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB, në raportin e tij të vitit 2013 i rekomandon shtetit se duhet ta rrit vetëdijen publike përmes mediave dhe përmes programeve edukative, si dhe përmes sigurimit të stërvitjeve të domosdoshme për gjykatësit, prokurorët, avokatët, policinë, serviset shëndetësore dhe sociale, si dhe për profesorët, me qëllim që të arrihet sensibilizimi për **të gjitha format e dhunës kundër grave dhe vajzave. Në këtë kontekst, OC duhet të jenë vazhdimisht të pranishme në opinion, jo vetëm gjatë promovimit të aktiviteteve të tyre dhe vetëm me shkase konkrete, por dhe përmes punës në terren. OC që punojnë në sferën e të drejtave të grave duhet t’i zhvillojnë shkathtësitë e tyre për komunikim me mediat, me qëllim që qasja e tyre të jetë më e lehtë tek ato dhe të krijojnë interesimin e tyre për punën që bëjnë. Në këtë mënyrë do ta ngrenë vetëdijen te vetë qytetarët për problemet të cilat si aktivistë përpiqen që t’i zgjidhin, shikimi i tyre do të jetë më i madh, e me këtë edhe kredibiliteti i tyre.**

- **Ngritja e vetëdijes publike për të drejtat e gruas rome dhe gratë nga grupet tjera të marginalizuara**

Këto tema shumë rrallë janë pjesë e mbulimit gazetaresk, kështu që edhe vetëdija e opinionit për gjendjen me këto grupe është shumë e vogël. Temat e lidhura me gratë rome në të shumtën e rasteve janë pjesë e raportimit gazetaresk kur bëhet fjalë për

shembuj negativë. Mediat, përgjithësisht sikurse dhe për tërë bashkësinë etnike të romëve, përhapin pamje dhe paragjykime stereotipe për gratë rome, gjë që reflektohet edhe në perceptimin nga ana e opinionit. Mediat duhet të jenë shumë të kujdesshme kur raportojnë për tema të lidhura për gratë dhe vajzat nga bashkësia rome, por njëkohësisht duhet të gjejnë dhe mënyrat që ta kthejnë vëmendjen e opinionit kah këto grupe të marginalizuara.

- **Ngritja e vetëdijes publike për tregtinë me njerëz**

Edhe përkundër asaj që bashkëpunimi midis organizatave civile dhe shtetit është në nivel të kënaqshëm, sipas përvojave të *Porta e Hapur*, megjithatë, ka nevojë për njohje më të mëdha të rolit të OC që punojnë në këtë problem dhe që janë aktor të rëndësishëm në procesin e riintegrit. Mediat mund të kenë rol kyç në promovimin e OC që punojnë aktivisht në këtë sferë. Por, ato, gjithashtu, duhet t'i alarmojnë dhe vazhdimisht t'i nxisin institucionet shtetërore për nevojën e mbrojtjes së plotë të viktimave dhe risocializimin e tyre. Megjithatë, gjatë mbulimit të temave të këtyre mediave duhet ta respektojnë parimin e mbrojtjes së privatësisë të viktimave nga tregtia me njerëz.

Nga ana tjetër, ndërkaq, është e nevojshme rritja e vetëdijes edhe tek institucionet edhe te mediat, për identifikim dhe njohje të suksesshme të rasteve të tregtisë me njerëz. Është e nevojshme edhe promovimi më i madh në opinionin i linjave SOS që janë në dispozicion, me qëllim përforcimin e rolit të tyre në procesin e identifikimit dhe të udhëzimit të viktimave nga tregtia me njerëz.

- **Krijimi i presionit ndaj institucioneve që t'i implementojnë obligimet e marra në lidhje me të drejtat e grave**

Organizatave civile dhe mediat duhet të veprojnë bashkë dhe të krijojnë front të përbashkët për presion ndaj institucioneve me qëllim që ta përshpejtojnë procesin e implementimit të strategjive dhe të planeve që janë miratuar. OC, të cilat për çdo ditë janë në kontakt me grupet e synuara, të drejtat e të cilave i mbrojnë, në bashkëpunim me mediat duhet të identifikojnë probleme dhe prioritete thelbësore në sferën që i prek të drejtat e grave dhe të punojnë në gjetjen dhe krijimin e mekanizmit për reagim dhe alarmim gjithnjë kur do të dalë përpara ndonjë çështje e nxehtë.

II.3. PRIORITETE NË SFERËN E TË DREJTAVE TË ROMËVE DHE TË Pjesëtarëve TË BASHKËSIVE JOSHUMICË NË MAQEDONI

Romët vazhdojnë të jenë njëra prej bashkësive më të marginalizuara në shtet, që shpeshherë ballafaqohet me segregacion dhe diskriminim në lidhje me mundësitë për të gjetur punën, arsimin, shërbimet shëndetësore dhe banimin. Në lidhje me përmirësimin e gjendjes së romëve dhe të inkluzionit të tyre në shoqëri, shteti parasheh aktivitete në kuadër të Strategjisë nacionale për romët dhe të Dekadës për përfshirjen e romëve (2005-2015), si dhe në Planet aksionale gjegjëse për implementim në sferat e arsimit, banimit, shëndetësisë dhe punësimit. Implementimi i këtyre dokumenteve shkon ngadalë, për shkak të deficitit institucional dhe të kuadrove, si dhe për shkak të mbështetjes së kufizuar financiare, e cila megjithatë mbetet në nivelin e njëjtë të vitit 2009. Në vitin e fundit mjetet nga shteti janë rritur për shkak të ndërtimit të hapësirave shkollore në lagjen Shuto- Orizare. Strategjia nacionale për romët, e financuar nga ana e Qeverisë, dha pjesërisht rezultate në sferën e arsimit, por jo të mjaftueshme edhe në sferën e banimit, punësimit, zhvillimit të infrastrukturës dhe, sidomos, të mbrojtjes shëndetësore.⁷⁶ Në më shumë komuna filloi të realizohet programi për mediatorë romë të shëndetësisë (në vitin 2013 punuan 11, ndërsa prej vitit 2014 me punë do të fillojnë edhe pesë mediatorë), ndërkohë u hapën qendra informative me qëllim që t'u ndihmohet personave pa dokumente. Komisioni Evropian në raportin për vitin 2013 konstaton se projektet në sferën e shëndetësisë, të arsimit, punësimit, banimit dhe të mbrojtjes sociale janë me rrezik, për shkak se janë të financuara nga donacionet, se trupi që është kompetent për realizimin e Strategjisë për romët në kuadër të Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale mbetet pamjaftueshëm i ekipuar në aspektin e kuadrove dhe se është i nevojshëm azhureteti më i madh dhe qasja e integruar për implementimin e politikave.

Në vitet e fundit janë vërejtur raste të më shumë fëmijëve romë nëpër shkolla të veçanta për fëmijë me pengesa zhvillimore, ndërsa shteti ishte kritikuar nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare se nuk ndërmerr masa adekuate. Një numër i romëve nuk kanë letërnjoftime të nevojshme për të marrë shërbimet publike, siç janë arsimi, mbrojtja sociale dhe shëndetësore. Komisioni Evropian në raportin e tij për vitin 2013⁷⁷ konstaton vetëm një përparim të caktuar në lidhje me realizimin e të drejtave të romëve, ndërsa vërejtjet kanë kryesisht të bëjnë me qasjen e rëndë të shërbimit shëndetësor dhe sociale, shkallën e lartë të papunësisë, implementimin e ndryshimeve ligjore me të cilat duhet të zgjidhet përfshirja e tepruar e fëmijëve romë në shkollat speciale, rritja e pamjaftueshme e numrit të fëmijëve romë në shkollat e mesme etj. Problem shtesë me të cilin ballafaqohen pjesëtarët e bashkësisë etnike romë është edhe kufizimi i lirisë së lëvizjes, kur merren parasysh rastet e kthimit të romëve nga pikat kufitare të kalimit për shkak të profilimit të tyre si azilantë potencialë.

⁷⁶ Stejt Departamenti (2012) Raport për praktikimin e të drejtave të njeriut në Maqedoni. Arritur përmes: <http://www.state.gov/documents/organization/204523.pdf>

⁷⁷ Komisioni Evropian (2012) Raport për progresin e Republikës së Maqedonisë. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/mk_rapport_2012_en.pdf

Implementimi i Marrëveshjes-kornizë të Ohrit është baza e promovimit dhe sigurimit të marrëdhënieve të mira dhe të mirëkuptimit midis të gjitha bashkësive etnike në Maqedoni. Në lidhje me mbrojtjen e bashkësive të tjera, Komisioni Evropian konstaton se mungojnë financa, bashkëpunimi efikas midis pushteteve dhe raporti proaktiv ndaj politikave të miratuara. Në raportin për vitin 2013 theksohet se turqit dhe bashkësitë tjera më të vogla janë të përfaqësuara në shkallë të pamjaftueshme në administratë, sidomos në pozicionet udhëheqëse.

Praktika dhe një varg hulumtimesh bëjnë të ditur ekzistimin e tensioneve midis bashkësive të ndryshme etnike, të cilat manifestohen përmes lloj-lloj rrahjeve midis nxënësve, në ndeshjet sportive, në incidente të ndryshme në rrugë. Te disa media në shumë raste në vitet e kaluara ishte vërejtur përsëritja dhe forcimi i stereotipizimit negativ ndaj “tjetrit”, përhapja e gjuhës së urrejtjes, e nacionalizmit, etnocentrizmit dhe e ksenofobisë.

Kjo pjesë e Librit të Bardhë është përgatitur në konsultim dhe bashkëpunim me shoqatën KHAM nga Dellçeva, Komitetin e Helsinkit, Qendrën për zhvillimin e mediave të bashkësive MEDIUM nga Gostivari, Roma S.O.S. nga Prilepi (të cilat morën pjesë në intervistat që i paraprinë këtij hulumtimi), ndërkohë që janë konsultuar dokumente të Komisionit Evropian, të komiteteve kompetente në KB që e monitorojnë gjendjen, Stejt Departamentit, Avokatit të Popullit, Shkollës së Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun dhe burime të tjera relevante.

- **Stereotipizimi dhe diskriminimi.** Maqedonia ende llogaritet si një shoqëri e cila vështirë i pranon dallimet, përfshi dhe bashkësitë etnike. Jotoleranca dhe diskriminimi mbi bazë etnike janë shpesh të pranishme, ndërsa romët janë grupi veçanërisht i lëndueshëm. Gjendja e keqe ekonomike dhe shkalla e lartë e varfërisë, papunësia, shkalla e ulët e arsimit dhe kriza sociale, bëjnë që ky grup etnik t’i nënshtrohet më së shumti diskriminimit, vlerëson Komiteti i Helsinkit. Organizatat ndërkombëtare konstatojnë se romët ballafaqohen me një diskriminim me shtrirje të gjerë gjatë qasjes në punësim, në ndihmë sociale, mbrojtje shëndetësore, arsim dhe banim, ndërkaq një numër i tyre nuk kanë pasur dokumente personale.⁷⁸

Duhet të theksohet se në vitet e kaluara ka pasur më shumë incidente midis nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike, ndërsa prindërit kanë refuzuar që t’i dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla të përziera etnike, gjë që ka ndikuar në shkallën e mirëbesimit midis bashkësive. Incidente në bazë ndëretnike, me përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe të fjalorit diskriminues, kanë ndodhur edhe në ndeshjet sportive në vitet e kaluara. Hulumtimet kanë treguar se te disa media është vërejtur raportimi në prizmin e grupit etnik personal, përmbajtje ku ka porosi nacionaliste dhe etnocentrike, si dhe stereotipizim negativ ndaj grupeve të tjera etnike, kryesisht shqiptarëve dhe maqedonasve.⁷⁹

78 Komisioni Evropian (2013) Raport për progresin e Republikës së Maqedonisë. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/mk_rapport_2013.pdf

79 SHLGMP (2012) „Raportimi mediatic për çështjet ndëretnike dhe ndërreligjioze në RM“, (2012) „Mbikëqyrja e raportimit të mediave për çështjet partiako-politike dhe ndëretnike gjatë periudhës parazgjedhore.“ Arritur përmes: www.vs.edu.mk

Organizatat joqeveritare rome dhe ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar raste kur punëdhënës të ndryshëm ua kanë shkurtuar të drejtat romëve, ndërsa disa romë janë ankuar për qasje të rënduar tek fondet publike.⁸⁰

Sipas Raportit të *Stejt Departamentit*, edhe turqit etnikë janë ankuar për diskriminim në vend, sidomos në drejtim të arritjes së përfshirjes së drejtë në institucionet qeveritare, përdorimit zyrtar të gjuhës turke në mjediset ku janë shumicë, për arsim joadekuat dhe për mungesë të mediave në gjuhën turke.

Diskriminim ndaj bashkësive më të vogla etnike

Një shembull konkret, të cilin *Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i RM* e ka konstatuar se si diskriminim direkt që i është bërë popullit boshnjak mbi bazë të përkatësisë etnike, ka qenë moslogaritja e tij si popull që jeton në shtet, në librin shkollor “Njohja e rrethinës” për klasën e tretë në shkollë fillore. Në të vërtetë, në mësimin për popujt që jetojnë në Maqedoni thuhet se në vend jetojnë maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vllleh dhe serbë, me ç’rast janë përshkruar veçantitë dhe traditat e tyre kulturore, ndërsa populli boshnjak ka munguar. Nga ana e Komitetit i është dorëzuar një parashtrësë *Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, e kundër Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë dhe autoreve të librit shkollor.⁸¹

- **Arsimi.** Raportet ndërkombëtare dhe vendore ⁸² kanë konstatuar njëfarë përparimi në sferën e arsimit, për shkak të përfshirjes më të madhe të fëmijëve romë në programet arsimore parashkollore dhe rritjen e numrit të nxënësve romë. Megjithatë, situata ende është brengosëse duke i marrë parasysh shkallët e braktisjes së shkollës nga ana e fëmijëve romë, si dhe numrin e vogël të vajzave që shkruhen në shkollët më të larta të arsimit. Sipas të dhënave të Avokatit të Popullit dhe të *Komitetit të Helsinkit*, viteve të kaluara janë zbuluar raste të numrit të madh jologjik të fëmijëve romë, përfshi këtu edhe vajzat, në shkollat speciale.

80 Stejt Departamenti (2012) Raport për praktikimin e të drejtave të njeriut në Maqedoni. Arritur përmes: <http://www.state.gov/documents/organization/204523.pdf>

81 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM (2013) Raport mujar për janarin e vitit 2013. Arritur përmes: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/305/Mesecen_Izvestaj_Januari_2013.pdf

82 Komisioni Evropian (2013) Raport për progresin e Republikës së Maqedonisë. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/mk_rapport_2013.pdf

Diskriminimi dhe segregacioni i fëmijëve romë

Hulumtimi i Komitetit të Helsinkit i realizuar në disa shkolla fillore të veçanta për fëmijë me pengesa zhvillimore në fillim të vitit 2011, dëshmon se diskriminimi racor, paragjykimet dhe stereotipet janë të pranishme në shoqëri. Konkluzionet nga ky hulumtim kanë të bëjnë me të dhënat që dëftojnë faktin se fëmijëve të nacionalitetit rom nuk u është mundësuar qasja në të gjitha shkollat fillore në shtet, për të cilën gjë të njëjtët ridërgohen në shkollat e veçanta për fëmijë me pengesa zhvillimore, pa dëshmi gjegjëse se fjala është për fëmijë që kanë nevojë për të mësuar në shkolla të këtilla. Kjo konfirmohet me faktin se pjesa më e madhe e fëmijëve me nevoja të veçanta në këto shkolla janë të nacionalitetit rom, edhe pse kjo bashkësi është ndër bashkësitë më të vogla etnike në Maqedoni. Edhe përkundër vërejtjeve të shumta të Komitetit të Helsinkit për diskriminimin ndaj romëve, sidomos kur në pyetje është arsimit dhe segregacioni i fëmijëve romë, ka munguar iniciativa efikase për zgjidhjen e këtij problemi nga ana e shtetit. Komiteti i Helsinkit ka konstatuar se mungesa e mekanizmave dhe praktikave për vlerësimin e nxënësve, zhvillimi i tyre psikologjik dhe fizik, si dhe mungesa e arsimit dhe e informimit midis prindërve të bashkësisë rome dëftojnë për nevojën e shikimit të gjendjes në shkolla dhe të ndërmarrjes së masave gjegjëse për ndryshimin e praktikave të gjertanishme. Komiteti ka konstatuar se e drejta e arsimit dhe e qasjes së barabartë tek ajo është e drejtë e çdo fëmije, pa marrë parasysh përkatësinë e tij etnike dhe, në këtë pikëpamje, zhvillimi i fëmijëve duhet të jetë prioritet i të gjitha institucioneve relevante.

Në tetor të vitit 2013 drejtorët e të dy shkollave më të mëdha për fëmijë me nevoja të veçanta në shtet për mediat konstatuan se nuk pranojnë më nxënës pa dokumentacion të plotë dhe se problemet e hetuara tashmë janë tejkaluar.

- **Banimi dhe infrastruktura.** Sipas raporteve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që punojnë me romë, pjesëtarët e kësaj bashkësie etnike jetojnë në kushte varfërie dhe papunësie, në lagje me kushte substandarde për jetesë. Në vitin 2011 ishte miratuar legjislativi për rregullimin e objekteve të ndërtuara pa leje, i cili mund ta zgjidhë problemin e banimit të një numri të caktuar romësh, për shkak se shumë prej tyre nuk kanë të drejtën ligjore ku ata jetojnë dhe i nënshtrohen kërcënimit të vazhdueshëm të shpërnguljes.

- **Dokumentacioni dhe liria e lëvizjes.** Njëra prej vështirësive për një numër të caktuar romësh është edhe marrja e dokumenteve personale,⁸³ përfshi certifikatat, letërnjoftimet, pasaportat dhe dokumentet tjera, të nevojshme për të marrë sigurimin shëndetësor dhe kontributet për sigurimin social.

Problem shtesë për romët, të cilin e theksojnë edhe organizatat vendore edhe Stejt Departamenti, është kufizimi i të drejtës së romëve për të dalë nga shteti. Në të vërtetë, nëpunës të doganës i profilojnë qytetarët se a janë azilantë potencialë mbi bazë

83 Komisioni Evropian (2013) Raport për progresin e Republikës së Maqedonisë. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/mk_rapport_2013.pdf

të disa indikatorëve më parë të caktuar, e mbi bazë të këtij vlerësimi mund t'i kthejnë nga pikat kufitare të kalimit. Mes janarit dhe dhjetorit të vitit 2012, 4.360 qytetarëve, numri më i madh i të cilëve kanë qenë romë, nuk u është lejuar që ta lëshojnë shtetin për shkak të dyshimit se do të kërkojnë azil në BE.⁸⁴ Këtyre personave ligjërisht mund t'u merret pasaporta për pesë vjet, por pas reagimeve të organizatave vendore që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kjo periudhë shpeshherë shkurtohet në 1 vit. Më shumë organizata civile të vendit, në mesin e të cilave edhe KHAM, kanë dorëzuar parashtresa në lidhje me këtë problem, por përgjigjja nga institucionet udhëton ngadalë, në të shumtën e rasteve me muaj.

• **Fëmijët.** Shteti nuk ka programe efikase të mjaftueshme të drejtuara kah kategoritë e lëndueshme të fëmijëve, e sidomos kah fëmijët romë, veçmas vajzat, fëmijët në rrugë, fëmijët refugjatë dhe personat nën mbrojtje subsidiare. Avokati i Popullit dhe *Komiteti i Helsinkit* kanë konstatuar se fëmijët ballafaqohen me diskriminim, stereotipizim negativ dhe me segregacion në shkolla, për të cilën gjë kërkojnë ndërmarrjen e masave aktive dhe të politikave promotive në lidhje me romët përgjithësisht,⁸⁵ si dhe përkëqyrje më të mirë nëpër shkolla dhe ndërmarrjen e masave gjegjëse për ndryshimin e praktikave të gjertanishme.⁸⁶

Sipas të dhënave të UNICEF-it⁸⁷ për vitin 2008, prej 500 deri 1.000 fëmijë në shtet, më shumë prej tyre romë, kanë jetuar në rrugë. Sipas *Ambasadës së parë të fëmijëve "Megjashi"*, ky numër në vitin 2013 ka qenë rreth 1.500 fëmijë. Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale udhëheq 5 qendra ditore për fëmijë nga rruga, në të cilat 630 fëmijë nga kategori të lëndueshme kanë marrë arsimin fillor. Qeveria ka hapur edhe qendra transitore për fëmijë të rrugës, por ato janë me kapacitete relativisht të vogla për sigurimin e serviseve sociale.⁸⁸

Shkallët e shtazënisë së padëshiruar në moshën e tinejxherëve dhe të aborteve janë të larta në mesin e vajzave romë.⁸⁹ Komisioni Evropian në raportin e tij për vitin 2012 dëfton edhe shkallën e lartë të vdekshmërisë të fëmijët e sapolindur romë, por edhe numrin e madh të fëmijëve të cilët përgjithësisht nuk kanë qenë të vaksinuar.

• **E drejta për mbrojtje shëndetësore.** Njëri prej problemeve më të shpeshta me të cilat ballafaqohen romët është qasja e rëndë në shërbimet shëndetësore, edhe atë për shkak të kushteve të pavolitshme socio-ekonomike dhe jetësore, mungesës së dokumen-

84 Stejt Departamenti (2012) Raport për praktikimin e të drejtave të njeriut në Maqedoni. Arritur përmes: <http://www.state.gov/documents/organization/204523.pdf>

85 Avokati i Popullit (2012) Raport vjetor për shkallën e sigurimit, respektimit, përparimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Arritur përmes: www.ombudsman.mk

86 Komiteti i Helsinkit (2012) Raport vjetor për gjendjet në sferën e të drejtave të njeriut në RM. Arritur përmes: <http://www.mhc.org.mk>

87 Stejt Departamenti (2012) Raport për praktikimin e të drejtave të njeriut në Maqedoni. Arritur përmes: <http://www.state.gov/documents/organization/204523.pdf>

88 Ibid

89 Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave (ESE) dhe grupi i organizatave civile maqedonase (2013) Akt i dorëzuar KB për përgatitjen e Raportit universal periodik.

tacionit gjegjësis për të marrë sigurimin shëndetësor, si dhe për shkak të mosrealizimit të politikave shëndetësore që kanë të bëjnë me romët. Nëna dhe fëmijët nga bashkësia rome janë të përfshirë në nivel të pamjaftueshëm në mbrojtjen shëndetësore preventive, përfshi imunizimin dhe edukimin shëndetësor; qasja në shërbimet gjinekologjike në territorin e Maqedonisë, sidomos për gratë rome, është e rënduar; përdorimi i mjeteve kontraceptive është në nivel shumë të ulët, ndërkaq numri i aborteve është veçanërisht i lartë në mesin e grave rome; ka qasje joadekuade dhe diskriminatore ndaj romëve në kuadër të organizatave shëndetësore etj.⁹⁰

Organizatave civile *Roma S.O.S.* nga Prilepi dhe *KHAM* nga Dellçeva para dy vitesh e iniciuan, e këto ditë edhe e fituan, procesin gjyqësor për shkak të veprimit të pandërgjegjshëm mjekësor me një pacient nga përkatësia etnike rome. Ndërkaq, shoqata *ROMA S.O.S.* në tre vitet e kaluara ka ngritur dava për 4 raste pacientësh romë, për të cilët ka dyshim se janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë gjatë qasjes së tyre për të marrë shërbimet shëndetësore. Deri më tani vetëm në një rast gjyqi ka marrë vendim, me të cilin dëshmohet se ka pasur gabim mjekësor në mënyrën e shërimit të pacientit, si dhe ajo që mjeku gjatë kryerjes së profesionit të vet nuk ka vepruar në pajtim me shkencën mjekësore. Megjithatë, pacienti tashmë që tre vjet pret të marrë shërbimin shëndetësor, përkatësisht t’i vihet nyja artificiale.

- **Polarizimi etnik i mediave.** Ky fenomen rezulton me raportim dominues vetëm për bashkësitë e veta etnike. Me këtë rast, siç tregojnë më shumë hulumtime, krijohet realiteti mediatik paralel, me ç’rast ndodh që bashkësitë e ndryshme etnike të raportojnë ndryshe-ndryshe për të njëjtat ngjarje, përkatësisht përmes prizmit të grupit të vet etnik. Për romët, për shembull, siç ishte vërejtur në hulumtimin e *MIM-it*, raportohet më shpesh në kontekst negativ, gjë që krijon pamje stereotipe për këtë bashkësi etnike. Nga ana tjetër, organizatat civile që punojnë me këtë grup etnik bëjnë vërejtje se romët janë të marginalizuar në programet informative, përkatësisht edhe atëherë kur ka, madje, tregim të mirë, mediat shpesh nuk kanë vullnet që ta mbulojnë.

Në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2012 konfirmohet ekzistimi i diskriminimit ndaj romëve, sidomos ndaj grave rome, “përfshi dhe stereotipizimin e vazhdueshëm në media dhe rrjetet sociale.”⁹¹

90 Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave (ESE) dhe grupi i organizatave civile maqedonase (2013) Akt i dorëzuar KB për përgatitjen e Raportit universal periodik.

91 Komisioni Evropian (2012) Raport për progresin e Republikës së Maqedonisë. Fq. 21. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/kev_documents/2012/package/mk_rapport_2012_en.pdf

Prioritete në bashkëpunimin midis OC që punojnë në këtë sferë dhe mediave

• Ulja e paragjyqimeve ndaj bashkësive të tjera etnike

Gazetarët dhe mediat duhet të jenë më të ndjeshme kur raportojnë për çështje që lidhen me pjesëtarët e bashkësive të tjera etnike, e sidomos për romët, me qëllim që të ulen paragjyqimet, stereotipat dhe gjuha e urrejtjes ndaj këtyre grupeve, që vazhdimisht ekzistojnë jo vetëm në mediat tradicionale, por edhe në ato të rejtat dhe në rrjetet sociale.

Në shumë situata në të kaluarën kur kanë ndodhur incidente të karakterit ndëretnik ose ndërreligjioz (rrahje midis të rinjsh në autobus, incidente në terrenet sportive, vrasja e pesë qytetarëve te Liqeni i Smilkovës etj.) te disa media ishte vërejtur raportimi sensacionalist, me ç'rast "incidentet tërësisht i vënë në kornizat e kontekstit ndëretnik, krijojnë atmosferë tensioni dhe të konfliktit potencial dhe flasin me gjuhën e urrejtjes, ku, krahas stereotipizimit të qëllimshëm, janë të pranishme edhe elemente të racizmit, stigmatizimit, segregacionit, ksenofobisë dhe të diskriminimit".⁹² Mu për këtë, gazetarët duhet të kenë distancën profesionale dhe kritike nga ngjarjet, me kujdes ta kontrollojnë çdo informatë dhe të mos lejojnë që të jenë të manipuluar nga asnjëra anë, rekomandojnë hulumtuesit e sferës mediatike.

Plus kësaj, fëmijët dhe pjesëtarët tjerë të bashkësisë etnike rome në media më shpesh paraqiten si të varur nga ndihma e huaj dhe nga shoqëria, e jo si persona që mund t'i kontribuojnë bashkësisë.⁹³ Shembull për nxitjen e stereotipisë është ai kur gjatë mbulimit mediatik të Ditës botërore të romëve në Maqedoni mediat publikuan vetëm incizime dhe kontribute për atë se jeta e tyre është e zymtë dhe e mjerë, pa transmetuar në publik edhe shembuj pozitiv ose personalitete nga jeta e romëve. Profili i këtyre mediatik kontribuon në përforcimin e stereotipive.⁹⁴ Mu për këtë, organizatat ndërkom-bëtare bëjnë apel për promovimin e qasjes pozitive në trajtimin e temave që lidhen me këtë bashkësi etnike – në vend të pamjeve që shkaktojnë keqardhje, duhet të transmetohen pamje që e pasqyrojnë dinjitetin, angazhimin dhe inkluzionin e personit.

Duhet vërejtur se ka raste kur edhe vetë pushtetet marrin pjesë në krijimin e diskursit diskriminues, ose, ndërkaq, veprojnë me diskriminim ndaj bashkësive etnike të caktuara. Mediat duhet ta kthejnë vëmendjen e publikut edhe në rastin kur shteti/pushtetet i diskriminojnë qytetarët në baza etnike, siç ishte rasti me romët që deshën të udhëtonin jashtë shtetit, por ishin kthyer nga kufiri maqedonas vetëm për shkak se i janë përgjigjur njëfarë profili të përcaktuar më parë të azilantit. Ky është shembull i bërjes me gisht dhe i diskriminimit, të cilin institucionet u përpoqën që ta heshtin, megjithatë ai ishte identifikuar dhe zbuluar nga ana e mediave.

92 SHLGMP (2012) „Komunikata e MBRM për raportimin për dhunën në komunikacionin publik 2012.“ Arritur përmes: http://www.unescochair-vs.edu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=98&Itemid=38&lang=mk

93 Ueb-faqja e UNICEF (2013) „UNICEF promovoi prezantimin pozitiv të fëmijëve rom që të tejkalohet stigmatizimi dhe diskriminimi.“ Arritur përmes: http://www.unicef.org/tfyrmaqedonia/macedonian/12189_16497.html

94 SHLGMP (2011) „Gjetje kyç nga hulumtimi kualitativ i qëndrimeve, perceptimeve dhe praktikave të redaksive në pikëpamje të raportimit për diversitetet.“ Shkup: SHLGMP. Arritur përmes: www.vs.edu.mk

Organizatata mediatike, si dhe vetë mediat, përmes mekanizmave që i kanë në dispozicion (Gjyqi i nderit, Kodi etik) duhet të reagojnë dhe ta dënojnë çdo qëndrim të pahijshëm (fjalë, video, fotografi) të kolegëve të tyre, në pajtim me parimet profesionale dhe etike.

Organizatata civile, ndërkaq, që punojnë në këtë sferë duhet të jenë më aktive dhe ta rrisin presionin publik përmes alarmimit drejtuar mediave kur do të vërejnë raste të diskriminimit, si dhe përmes promovimit efektiv të temave pozitive, të cilat do t'i zhveshin pamjet negative për bashkësitë etnike.

- **Gazetaria inkluzive**

Në politikën mediatike evropiane çështja e pluralizmit mediatik dhe llojllojshmëria përmbajtjesore theksohen si aspekt qendror i realizimit të së drejtës së informimit dhe lirisë së shprehjes, të përcaktuara në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pluralizmi mediatik ka dimensione të ndryshme, prej të cilave njëri është sigurimi i *pluralizmit kulturor* në media, që do të thotë paraqitja dhe shprehja e drejtë e kulturave dhe e grupeve shoqërore të ndryshme në media, përfshi edhe pakicat etnike, gjuhësore dhe nacionale.

Më shumë hulumtime e imponojnë çështjen e funksionit integruar të mediave, që është me rëndësi të veçantë për shoqërinë multikulturore maqedonase. Edhe pse kjo, sipas definicionit, është obligim i servisit radiodifuziv publik, megjithatë dimensionin integruar duhet ta kultivojnë edhe mediat tjera komerciale. Këto thënie kanë vend në hulumtimin e Shkollës së Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun, ku bashkësia gazetareske nxitet seriozisht që të debatohet për rolin dhe ndikimin integruar që mediat kanë në shoqërinë maqedonase.⁹⁵

Në dallim prej këtyre angazhimeve dhe rekomandimeve, te më shumë media në shtet është e dukshme praktika e ndjekjes së aktiviteteve të organizatave civile që i takojnë bashkësisë së njëjtë etnike, me të cilën gjë krijohet raportimi mediatik paralel në kuadër të etnikumeve të ndryshme që jetojnë në Maqedoni.

Problem shtesë është raportimi “i centralizuar”, përkatësisht në media gjithnjë prioritet më të madh kanë OC më të mëdha, të cilat më shpesh punojnë në Shkup, në dallim prej atyre që janë aktive në nivel lokal. Sipas asaj që kanë vërejtur disa prej OC me të cilat ka bashkëpunuar MIM gjatë përpunimit të Librit të Bardhë,⁹⁶ mediat lokale janë burimi primar i informatave për ngjarjet relevante politike, ndëretnike, kulturore e të tjera në kuadër të bashkësisë lokale, së këndejmi edhe rëndësia e tyre si mekanizëm i rëndësishëm, përmes të cilit qytetarët mund të marrin pjesë në jetën publike të bashkësisë, t’i artikulojnë interesat e tyre dhe të ndikojnë ndaj vendimeve të pushteteve. Megjithatë, realiteti është i tillë që prodhimi i temave që i trajtojnë marrëdhëniet dhe çështjet ndëretnike lidhur me të drejtat e njeriut në nivel lokal është minimal.

95 SHLGM (2011) „Raportim për diversitetet në Maqedoni“ (2012) dhe „Analizë kualitative raportimit mediatik për çështjet ndëretnike dhe ndërreligjioze në RM“. Arritur përmes: www.vs.edu.mk

96 Sipas sugjerimeve të organizatave civile Qendra për zhvillimin e mediave të bashkësive MEDIUM dhe Roma S.O.S.

Organizatave civile e theksojnë dhe nevojën e rritjes së “ndjeshmërisë mediatike” gjatë raportimit, si dhe stërvitjen e gazetarëve dhe të redaktorëve rreth të drejtave të njeriut, raportimit etnik dhe gjinor, por dhe për problemet aktuale që i prekin bashkësitë lokale.

• **Përfshirja e OC në krijimin e politikave publike**

Qeveria ka perceptim negativ për organizatat civile, sidomos për ato që janë me pikëpamje kritike ndaj politikave të saj, siç tregojnë disa analiza.⁹⁷ Ajo që ishte parë si problem në vitet e kaluara, ishte krijimi i organizatave civile organizuar nga ana e Qeverisë ose të ashtuquajturat GONGO (Government organized NGOs), të cilat ndaj protestave të sektorit civil përgjigjeshin me kundërprotesta, duke i promovuar ose arsyetuar politikave dhe masat qeveritare. Rekomandimet nga organizatat ndërkombëtare janë që shteti duhet të tregojë më tepër transparencë ndaj sektorit civil dhe duhet ta përfshijë në procesin e krijimit të politikave. Komisioni Evropian rekomandon që duhet të përparojnë bashkëpunimet dhe dialogu midis Qeverisë dhe organizatave civile, sidomos organizatave që punojnë në sferën e reformave sociale, të barazisë gjinore dhe seksuale, romët, me popullatën LGBTI etj.

II.4. PËRPARËSI NË SFERËN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME PENGESA ZHVILLIMORE

Organizatave vendore dhe ndërkombëtare⁹⁸ konstatojnë se personat me pengesa zhvillimore në shtet ballafaqohen me probleme dhe diskriminim gjatë marrjes së mbrojtjes shëndetësore dhe të shërbimeve të tjera publike dhe sociale, arsimit, punësimit, transportit publik dhe të sferave të tjera. Në lidhje me legjislacionin që ka të bëjë me vetë sferën, shteti e ka ratifikuar Konventën e KB për të drejtat e personave me pengesa zhvillimore në vitin 2011, me të cilën u obligua që do t'i respektojë të drejtat dhe do të mundësojë kushte për një jetë me dinjitet për këta qytetarë përmes përfshirjes dhe pjesëmarrjes efikase në të gjitha sferat dhe përmes krijimit të mundësive të njëjta dhe sigurimit të qasjes adekuate të të gjitha të mirat dhe shërbimet. U nxor edhe Strategjia nacionale për barazimin e të drejtave të personave me invaliditet (2009-2010), ndërkohë që u themelua edhe Trupi koordinues nacional për të drejta të njëjta të personave me invaliditet. Plus kësaj, edhe Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi e ndalon diskriminimin mbi bazë të pengesës fizike dhe intelektuale. Edhe krahas kësaj, Komisioni Evropian në Raportin e tij të vitit 2013⁹⁹ konstatoi se implementimi i dokumenteve të miratuara është i ngadaltë dhe i kufizuar, ndërsa integrimi social i personave me pengesa zhvillimore mbetet i ulët.

97 USAID (2012) Indeksi i vetëpërmbytjes së organizatave civile për Evropën Qendrore e Lindore dhe për Euroazinë. Arritur përmes: <http://www.usaid.gov/europe-eurasia-civil-society/cso-sustainability-2012/macedonia>

98 Avokati i Popullit (2012) Raport vjetor për shkallën e sigurisë, respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Fq. 79-81 dhe Stejt Departamenti (2012) Raporti për respektimin e të drejtave të njeriut në Maqedoni

99 Komisioni Evropian (2012) Raporti për progresin e Republikës së Maqedonisë. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/mk_rapport_2012_en.pdf

Kjo pjesë e Librit të Bardhë që ka të bëjë me personat me pengesa zhvillimore është përgatitur në bashkëpunim me shoqatën *Hapni Dritaret*, e cila që tetë vjet promovon qasjen në teknologjinë informative në të gjitha sferat e shoqërisë, ndërsa që katër vjet punon në projektin e USAID për e-qasje arsimore, me qëllim përmirësimin e mundësive arsimore të nxënësve me pengesa zhvillimore në shkollat e rregullta fillore, përmes shfrytëzimit të teknologjisë informative asistive. Sipas informatave të *Hapni Dritaret*, në shtet nuk ka të dhëna statistikore për numrin e personave me pengesa zhvillimore. Konsiderohet se midis 8-10% të popullsisë në Maqedoni ka ndonjë pengesë zhvillimore. Përvoja e shoqatës pohon se, edhe krahas asaj që shkallë-shkallë po nxirret legjislati i volitshëm, praktika tregon se këta qytetarë ballafaqohen me mungesën e mundësive, me marginalizim dhe diskriminim në shoqëri. Gjatë shkrimit të kësaj pjese nga Libri i Bardhë janë konsultuar edhe raportet e Avokatit të Popullit, të Stejt Departamentit dhe të Bashkimit Evropian.

- **Arsimi.** Avokati i Popullit në vitin 2012 ka vërejtur rritjen e numrit të parashtresave që lidhen me të drejtat e personave/fëmijëve me pengesa zhvillimore. Ombudsmani ka konstatuar probleme në realizimin e të drejtës për arsim të fëmijëve me pengesa zhvillimore të përfshirë në arsimin e rregullt, edhe krahas asaj që shteti e promovon konceptin e arsimit inkluziv. Avokati i Popullit në raport thekson se fëmijët me nevoja të veçanta, varësisht nga gjendja e tyre, duhet të regjistrohen në arsimin e rregullt dhe me këtë rast të kenë trajtim të njëjtë si dhe fëmijët tjerë, pa kurrfarë diskriminimi dhe pa paragjykime, të jenë të pranuar nga mjedisi dhe t'u sigurohen kushte për ndjekjen e rregullt të arsimit me ndihmën profesionale nga persona profesionist për ta përvetësuar materialin. Raporti i Stejt Departamentit bën të ditur se Ministria e Arsimit nuk ka arritur që të sigurojë shërbime arsimore të veçanta gjegjëse për fëmijët me pengesa shëndetësore, edhe pse ata janë të përfshirë në sistemin arsimor.

Edhe Komisioni Evropian në Raportin e vitit 2013 vëren se ende nuk ka të dhëna të mbledhura në mënyrë sistematike dhe bazë të dhënash për fëmijët me nevoja të veçanta, të cilët mbeten grupi më i ndjeshëm. Inkluzioni i tyre social është i penguar nga stigma sociale, diskriminimi, mungesa e infrastrukturës dhe qasjes adekuate në shërbimet sociale. Ekzistojnë vetëm vlerësime se 15% e fëmijëve me pengesa zhvillimore janë të përfshirë në sistemin arsimor.¹⁰⁰

- **Punësimi.** Në lidhje me punësimin e personave me pengesa zhvillimore, Ombudsmani, por edhe Raporti i Stejt Departamentit, bëjnë të ditur se edhe pse ka legjislativë të përshtatshme, mungon implementimi konsekuent dhe i plotë. Edhe krahas përfitimeve ligjore që kompani të caktuara i fitojnë gjatë punësimit të personave me nevoja të veçanta, organizatat joqeveritare kanë vërejtur se ato mundësi megjithatë janë të kufizuara, ndërsa rrogat e ulëta që iu ofrohen personave me hendikep i dekurajojnë ata që të kërkojnë punësim.¹⁰¹ Qeveria ndërmerr masa të caktuara, siç është për shembull punësimi i 300

100 Komisioni Evropian (2012) Raporti për progresin e Republikës së Maqedonisë. fq. 46. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/mk_rapport_2012_en.pdf

101 Stejt Departamenti (2012) Raporti për praktikimin e të drejtave të njeriut në Maqedoni. Arritur përmes: <http://www.state.gov/documents/organization/204523.pdf>

Nuk ka evidencë sistemore të nxënësve me pengesa zhvillimore

Shoqata *Hapni Dritaret* në vitin 2010 realizoi një hulumtim në nivel nacional për aplikimin e teknologjisë informative asistive në Republikën e Maqedonisë, e cila përmban edhe të dhëna për përfshirjen e nxënësve me pengesa zhvillimore dhe qasje në shkolla. Në hulumtim konstatohet se të dhënat për përfshirjen e nxënësve me pengesa zhvillimore janë indikative dhe jooficiale, për shkak se nuk ka procedura sistemore të përcaktuara për evidentimin dhe përcjelljen e tyre. Hulumtimi konkludon se nxënësit me nevoja arsimore të veçanta përgjithësisht ballafaqohen me vështirësi të caktuara gjatë shfrytëzimit të pajisjes kompjuterike standarde në shkolla, gjë që më tepër është e theksuar në mjediset fshatare sesa në ato të qyteteve. Kjo pjesërisht ka të bëjë me përqindjen e ulët të përdorimit të kompjuterëve në arsim në shkollat e fshatit, por mbase edhe për qasjen më të vogël të kompjuterët për fëmijët e mjediseve fshatare jashtë shkollës.

Më tej, hulumtimi konkludon se teknologjia asistive pothuajse tërësisht nuk shfrytëzohet në arsimin e rregullt fillor, përkatësisht se mungon iniciativa sistemore për sigurimin e aparateve asistive dhe se ka mungesë dijesh e shkathtësish për shfrytëzimin e opsioneve tashmë të pranishme që janë pjesë e paketave të softuerëve të instaluar në shkollat fillore.

Hapni Dritaret ka përcaktuar se ka nevojë të dukshme për përmirësimin e qasjes në shkolla, si në kuptimin fizik, ashtu edhe në kuptimin e kapacitetit të personelit shkollor për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (defektologë), si dhe mbindërtimin e diturive dhe të shkathtësive të arsimtarëve për përpunimin e plan-programeve individuale në pajtim me nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

personave me pengesa zhvillimore në administratë (e shpallur në nëntor 2013), mirëpo këto aktivitete duhet të jenë sistemore dhe të prodhojnë rezultate afatgjate.

- **Shikimi dhe promovimi i të drejtave të personave me pengesa zhvillimore.** Konstatim i shoqatës *Hapni Dritaret* është se mediat rrallë i ngrenë çështjet që lidhen me pengesa zhvillimore, ashtu që do të promovojnë inkluzionin dhe përfshirjen aktive të personave me pengesa zhvillimore në rrjedhat shoqërore në programe të ndryshme ose në edicionet informative. Më shpesh ndodh që mediat të transmetojnë statistika dhe numra ose, ndërkaq, tregime që dihet të shkaktojnë empati dhe keqardhje te shikuesit. Këtu nuk guxon të lihet anash ndikimi pozitiv të cilin e kanë bërë tregimet mediatike në jetën e personave me pengesa zhvillimore. Me zbulimin e rasteve të ndryshme të harruara nga shteti, mediat shpeshherë kanë iniciuar aksione për ndihmë nga ana e organizatave civile dhe vetë qytetarët, ose i kanë çuar pushtetet që të reagojnë.

Megjithatë, organizatat civile që punojnë me persona me pengesa zhvillimore iu bëjnë apel mediave që të transmetojnë më shumë tregime afirmative, që do t'i paraqesin si qytetarë të barabartë të cilët i kontribuojnë shoqërisë.

Prioritete në bashkëpunimin midis OC që punojnë në këtë sferë dhe mediave

- **Sensibilizimi i gazetarëve për temat që lidhen me personat me pengesa zhvillimore.**

Në mbulimin mediatik rrallë janë të përfshira temat që merren me të drejtat e personave me pengesa zhvillimore, që pjesërisht varet edhe nga vetë aftësia e gazetarëve që ta njohin problemin ose ta “njohin” tregimin. Kjo ka të bëjë me njohjen e pamjaftueshme të sferës nga ana e disa gazetarëve, që reflektohet edhe në tekstet kushtuar kësaj teme, ku hetohet raportimi steril dhe “sipërfaqësor”, përdorimi i terminologjisë joadekuate, bile dhe shkelja e të drejtave të këtyre personave, e sidomos të fëmijëve, nga vetë media. Sipas analizave të ekspertëve¹⁰², “gazetarët duhet të jenë sidomos të kujdesshëm gjatë përdorimit të termave për njohjen e bashkësive dhe grupeve të diskriminuara, për shkak se njëra prej formave më të zgjeruara të diskriminimit është identifikimi gjuhësor negativ dhe nënçmues. Sfidë e veçantë etike është përdorimi i termave respektues për personat me pengesa zhvillimore, për shkak se gjuha mosrespektuese mund të shkaktojë ndjenjën e përjashtimit.” Për këtë shkak, nevojitet sensibilizimi i gazetarëve dhe njohja e tyre me rregullativën vendore dhe ndërkombëtare, siç është për shembull Konventa për Personat me Pengesa Zhvillimore.

Nevojitet të ngrihet vetëdija te gazetarët dhe te publiku për faktin se personat me pengesa zhvillimore nuk kërkojnë të drejta shtesë, por edhe ata duan që t’i gëzojnë të njëjtat të drejta me të gjithë qytetarët tjerë. E, që të realizohen ato të drejta, nevojitet vetëm të vihen mekanizma institucionalë efektivë.

- **Përfshirje më e madhe e temave që lidhen me pengesat zhvillimore në media.**

Sipas perceptimeve të organizatave civile, në media mungojnë emisione ose tekste tematike të cilat do të përpunojnë çështje nga sfera e pengesave zhvillimore, si dhe tregime personale nga jeta e përditshme, siç është për shembull emisioni “Tunel” në MTV1. Produktet mediatike (emisionet ose tekstet) kushtuar kësaj kategorie njerëzish duhet të jenë të liruara nga sensacionalizmi, dramatizimi ose keqardhja. Përkundrazi, ato duhet të promovojnë qasje afirmative dhe të tregojnë se si këta njerëz mund t’i kontribuojnë shoqërisë me angazhimin e tyre. Kjo qasje është më adekuate nga prodhimi i emisioneve të specializuara për lloj-lloj grupesh të marginalizuara, për shkak se emisionet e këtilla emetohen jashtë termineve qendrore dhe kanë arritje të vogël, shkojnë te një segment i kufizuar i publikut. Përmes qasjes inkluzive ndaj temave që lidhen me pengesat zhvillimore, të cilat do të kishin marrë hapësirën adekuate në media, publiku i gjerë mund të njihet me sfidat me të cilat ballafaqohen personat me pengesa zhvillimore. Kjo është njëra prej mënyrave se si mund të ndikohet ndaj vetëdijes publike përgjithësisht, por

102 Trajanovski, Zharko. „Përse mediat i injorojnë problemet e personave me pengesa zhvillimore.” Ueb-faqja Servisi për Kontrollimin e Fakteve nga Mediat. Arritur përmes: <http://mediumi.vistinomer.mk/zoshto-mediumite-gi-ignoriraat-problemite-na-licata-so-poprechenost-1/> (pjesa I) dhe <http://mediumi.vistinomer.mk/zoshto-mediumite-gi-ignoriraat-problemite-na-licata-so-poprechenost-2/> (pjesa II)

edhe të informohen edhe vetë personat me pengesa zhvillimore ose pjesëtarët e grupeve të tjera të marginalizuara për të drejtat që i kanë.

- **Bashkëpunim më i madh midis OC dhe mediave.**

Është e nevojshme që të intensifikohet bashkëpunimi midis sektorit civil dhe mediatik, ashtu që OC duhet t'i "ushqejnë" me informacione rreth situatës në praktikë, për implementimin e rregullativës, ose t'i alarmojnë kur ndodh që të shkelen të drejtat e njeriut në raste të ndryshme që të promovojnë tregime "pozitive". Përfshirja e këtyre temave në agjendën mediatike mund të kontribuojë në krijimin e presionit ndaj institucioneve për mbrojtje më efektive të të drejtave të njeriut të kësaj kategorie të lëndueshme qytetarësh.

Kështu, për shembull, *Hapni Dritaret* bëjnë të ditur se tema përfshirje (inkluzion) e nxënësve me pengesa zhvillimore në procesin e rregullt arsimor pothuajse aspak nuk është e përfshirë në media. Tema përfshin shumë çështje që mund të aktualizohen përmes mediave, e kjo do t'u ndihmojë qytetarëve që të informohen për të drejtat e veta, si për shembull: rregullativat për regjistrimin në shkolla dhe fakultete, ekipimin e ekipeve profesionale, përgatitjen profesionale të ekipeve për punë me nxënës dhe studentë me pengesa zhvillimore, qasjen në objekte, futjen e metodave bashkëkohore në punë, për shembull të teknologjisë informative asisitive, prezantimin e storjeve të suksesshme etj.

Megjithëkëtë, ajo që gazetarët vazhdimisht e theksojnë është nevoja për "njerëz që flasin" në tregim. OC këtu mund të ndihmojnë, ashtu që do t'u mundësojnë gazetarëve që të vënë kontakt me qytetarët, interesat e të cilëve i përfaqësojnë. Aktivistët civilë duhet të kuptojnë dhe t'u shpjegojnë personave me të cilët punojnë se me zbulimin e tregimeve të tyre, dhe të sfidave me të cilat ballafaqohen, mund t'u ndihmojnë edhe personave të tjerë, e do të ndikojnë edhe në ngritjen e vetëdijes publike. Gazetarët, nga ana tjetër, duhet ta garantojnë privatësinë e personave me pengesa zhvillimore që duan ta rrëfejnë tregimin e tyre. E gjithë kjo mund të kontribuojë në inkluzionin më të lehtë të personave me pengesa zhvillimore në shoqëri.

II.5. PRIORITETET NË SFERËN E TË DREJTAVE TË PJESËTARËVE TË POPULLATËS LGBTI

Njëra prej vërejtjeve më të mëdha në Ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, të cilin e theksojnë edhe organizatat vendore edhe ato ndërkombëtare, është ajo se në definicionet nuk është përfshirë edhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor si bazë për diskriminim. Në vitet e kaluara në vend ishin regjistruar më shumë incidente të lidhura me pjesëtarët e bashkësisë LGBTI dhe me aktivitetet e tyre, që përfshinin përdorimin e gjuhës së pahijshme ose ofenduese, por edhe të maltremit fizik. Qeveria tashmë një kohë të gjatë po udhëheq fushatën me të cilën i promovon vlerat familjare tradicionale, e në të njëjtën kohë në disa raste e aktualizon ndryshimin e Kushtetutës, që do të nënkuptonte definimin e familjes si bashkësi ekskluzive midis burrit dhe gruas. Propozimi i fundit i partisë në pushtet nuk u përkrah nga shumica parlamentare në vitin 2013.

Komisioni Evropian dhe Stejt Departamenti në raportet e tyre për vitin 2013, përkatësisht për vitin 2012, konstatojnë se bashkësia LGBTI vazhdon të jetë lëndë diskriminimi, stigmatizimi, maltremiti dhe cak i gjuhës nënçmuese, bile edhe nga ana e mediave. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave në kuadër të KB e notifikon mospunuesin e shtetit që ta ndalojë diskriminimin mbi bazë të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor.¹⁰³

Ndërkaq, në tetor të vitit 2012 në Çarshinë e Vjetër të Shkupit ishte hapur Qendra për Mbështetje LGBTI, e para e këtij lloji, si filial i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Misioni i Qendrës për Mbështetje LGBTI është përforcimi i bashkësisë LGBTI për vetëpërfaqësim, si dhe ndryshimi i statusit juridik dhe social i personave LGBTI në Maqedoni. Qendra u ofron ndihmë edhe shoqatave dhe grupeve të tjera formale dhe joformale që punojnë në sferën e të drejtave të njeriut. Prej hapjes së saj Qendra ishte sulmuar pesë herë, ndërsa vetëm një herë pati përfundim gjyqësor.

Për raportin e gazetarëve ndaj temave që lidhen me personat e marginalizuar, përfshi edhe pjesëtarët e bashkësisë LGBTI, hulumtimi “Mediat dhe bashkësitë e marginalizuara”¹⁰⁴, realizuar në vitin 2011, ka identifikuar disa strategji të cilat i shfrytëzojnë gazetarët gjatë raportimit në këto tema: të strategjisë përfshirëse/përrashtuese (a i jepet hapësirë adekuate, a janë të injoruar apo të marginalizuar në aspektin mediatik, a raportohet në mënyrë josensacionaliste); strategji predikative (krijimi i stereotipave negativ, moralizimit, kriminalizimit të pjesëtarëve të grupeve të marginalizuara), dhe strategjive argumentative (a ekziston theksimi mediatik i diskriminimit ndaj grupeve të marginalizuara, minimizimi i dhunës ndaj tyre, legjitimimi i përjashtueshmërisë, diskriminimit, shtypjes së pjesëtarëve të grupeve të marginalizuara). Të gjitha këto trende janë të pranishme në eterin mediatik, me ç’rast edhe vetë mediat shpeshherë janë jo vetëm transmetues të porosive prej qendrave të ndryshme, por edhe përforcues edhe

103 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit të Grave (CEDAW) (2013) Vëzhgime përmbyllëse raportit periodik të katërt dhe të pestë të RM nga Komiteti i sesionit të 54-të. Arritur përmes: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cedaw/cedaws54.htm>

104 Trajanovski, Zharko (2012) Mediat dhe bashkësitë e marginalizuara –Diskurset mediatike dhe diskriminimi mbi pjesëtarët e grupeve të marginalizuara. Shkup: Koalicioni “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara”

gjeneratorë të diskursit diskriminues.

Komisioni Evropian në Raportin e vitit 2013¹⁰⁵ bën të ditur se përmbajtjet mediatike transmetojnë porosi homofobike, për të cilën gjë profesionistët dhe pronarët e mediave duhet të ndërmarrin përgjegjësi më të madhe në ballafaqim me injorimin dhe mostolerancën ndaj këtyre grupeve të qytetarëve.

Prej organizatave vendore, *Komiteti i Helsinkit* dhe *Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim – H.E.R.A.* i ndjekin nga afër gjendjet me respektimin e të drejtave të personave LGBTI, për të cilën gjë kjo pjesë e Librit të Bardhë mbështetet kryesisht mbi ekspertizën e tyre, konsultimet e bëra me ta, si dhe në raportet e përgatitura nga ana e tyre.

- **Pushtetet si përforcues të homofobisë dhe transfobisë.** Sipas *Komitetit të Helsinkit*, homofobia dhe transfobia në shoqërinë tonë ende janë shumë të pranishme, gjë që shihet përmes sulmeve ndaj Qendrës për Mbështetje, sulmeve ndaj aktivistëve të “Marshit të tolerancës” të organizuar, gjuhës së urrejtjes në media dhe mendimeve të shprehura në rrjetet sociale. Problem plotësues përbën edhe heshtja nga ana e institucioneve qeveritare, të cilat nuk e dënuan përhapjen e urrejtjes ndaj një grupi të caktuar njerëzish dhe në mënyrë indirekte promovuan përjashtimin e tyre nga shoqëria, e nuk e dënuan as shkeljen e ligjeve ekzistuese. Komiteti konsideron se përfaqësuesit e pushteteve shtetërore kanë qenë pjesë e problemit, me të cilën gjë vetëm e kanë forcuar idenë dhe statusin e popullatës LGBTI si deviacion në shoqëri.

- **Mediat si përforcues të homofobisë dhe të transfobisë.** Fushata kundër pjesëtarëve të bashkësisë LGBTI ishte mbështetur dhe forcuar nga raportimi në disa prej mediave, të cilat e harruan ose e injoruan përgjegjësinë publike që duhet ta kenë ndaj të gjithë qytetarëve në mënyrë të njëjtë. Ky është një prej elementeve më shumë në nxitjen e mllefrit dhe të homofobisë, që në disa raste rezultoi madje edhe me dhunë. Aktivistët dhe organizatat që punojnë me popullatën LGBTI ballafaqohen me qasje të kufizuar dhe selektive në media, ndërsa informatat shpeshherë dalin të interpretuara ndryshe. Në disa prej mediave rrjedha e informatave ishte e pamundësuar ose informatat ishin paraqitur në mënyrë joobjektive, duke ofruar vetëm një shikim të njëanshëm të situatës në Maqedoni. Përveç kufizimit të hapësirës mediatike, mund të vërehej se disa media në mënyrë direkte morën pjesë në fushatën homofobike përmes nxjerrjes së informatave subjektive me mbështetje në qëndrime personale.

- **Gjuha e urrejtjes dhe sulmet fizike.** Përveç sulmit ndaj Qendrës LGBTI, edhe anëtarët e kësaj bashkësie i janë nënshtruar në mënyrë konstante kërcënimeve me jetë, me gjuhë të urrejtjes, bile dhe me sulme fizike dhe me goditje me gurë, për të cilën flasin informatat e *Komitetit të Helsinkit*. Komiteti ka konstatuar se institucionet shtetërore gjer më tani nuk kanë ndërmarrë hetime të plota për gjetjen dhe dënimin e të gjithë autorëve. Kjo për Komitetin është indikator se nga ana e shtetit nuk ka vullnet të mjaftueshëm për mbrojtjen e pjesëtarëve të bashkësisë LGBTI, me të cilën gjë këta persona vihen në një pozitë më të pavolitshme kundrejt qytetarëve të tjerë.

105 Komisioni Evropian (2013) Raporti për progresin e Republikës së Maqedonisë. Arritur përmes: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/mk_rapport_2013.pdf

Raport i Komitetit të Helsinkit për Rekomandimin e Këshillit të Evropës

Komiteti i Helsinkit përgatiti një raport në hije për realizimin e Rekomandimit CM/Rec(2010)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (CoE) për luftë kundër diskriminimit mbi bazë të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor. Komiteti konstaton se pushtetet maqedonase nuk kanë ndërmarrë kurrfarë hapash për realizimin e Rekomandimit të Këshillit të Evropës. Rekomandimi as që është përkthyer në gjuhën maqedonase, ndërsa arsyetimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme është se rekomandimet e CoE nuk janë të obligueshme për vendet-anëtare. Njëkohësisht, Rekomandimi nuk u është dorëzuar institucioneve kompetente, organizatave joqeveritare dhe vetë bashkësisë LGBTI. Komiteti i Helsinkit u ka dërguar ekzemplarë nga Rekomandimi të gjitha institucioneve kompetente gjatë kohës së realizimit të këtij projekti. Rekomandimi i përkthyer dhe shtojcat e tij u ishin dorëzuar të gjithë deputetëve në Kuvend. Këto janë një pjesë e konkluzioneve që i përmban Raporti në hije:

- Orientimi seksual ishte hedhur nga Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi si bazë e veçantë, ndërsa identiteti gjinor as që ishte marrë parasysh gjatë përgatitjes së Ligjit.

- Interesat dhe nevojat e bashkësisë LGBTI nuk ishin marrë parasysh gjatë përpilimit dhe miratimit të Strategjisë nacionale për barazi dhe mosdiskriminim, e cila përfshin vetëm katër baza: përkatësinë etnike, moshën, pengesën zhvillimore mentale dhe trupore.

- Çiftet njëgjinore janë të diskriminuara në Ligjin për familje në raport me çiftet me partner të gjinive të ndryshme, por kompetentët nuk ndërmarrin masa që ta zgjidhin këtë problem. Çiftet njëgjinore nuk janë të mbrojtura nga dhuna në familje në kuadër të Ligjit për familje.

- Nuk ka procedura saktë dhe qartë të përcaktuara për ndryshimin e numrit amë, që është e domosdoshme për njohjen ligjore të ndryshimit të gjinisë në rastin e personave transgjinorë, për të cilën gjë krijohet konfuzioni i veprimit si te nëpunësit shtetërorë, ashtu edhe te vetë personat transgjinorë.

- Edhe krahas asaj që shteti ofron trajtim endokrinologjik dhe psikologjik, që është i nevojshëm për personat transgjinorë, të njëjtat nuk janë as efektive as adekuate, nga shkak se nuk ka praktikë as stërvitje për punonjësit profesionalë të shëndetësisë për rastet e personave transgjinorë. Shteti nuk ofron intervenime kirurgjike për ndryshimin e gjinisë dhe nuk ka dëshmi për kthimin e mjeteve nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor, bile edhe në rastet kur personat e kanë bërë operacionin jashtë vendit, me mjetet e tyre.

- Në sferën e sportit, organet shtetërore nuk kanë kontribuar me përpjekje plotësuese për ta tejkaluar diskriminimin mbi bazë të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor, si dhe gjuhën e urrejtjes.

- Në shëndetësi, përveç programeve preventive dhe studimeve bihejviorale në kuadër të Fondit global për luftë kundër HIV/SIDA, malaries dhe tuberkulozit, nuk ka programe dhe shërbime të tjera të arritshme për personat LGBTI.

- Edhe pse në klasifikimin tonë të sëmundjeve orientimi seksual nuk përbën sëmundje, në librat shkollorë për arsim të mesëm dhe të lartë autorët shfrytëzojnë interpretime, qëndrime dhe kualifikime që nuk bazohen në mendimin shkencor bashkëkohor dhe në definicionet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe nuk janë në pajtim me dokumentet zyrtare ekzistuese për klasifikimin e sëmundjeve/çrregullimeve.¹⁰⁶

Prioritete në lidhje me bashkëpunimin midis OC që punojnë në këtë sferë dhe mediave

- **Pengimi i gjuhës jotolerante nga ana e pushteteve**

Debati në opinion për çështje të caktuara që lidhen me pjesëtarët e popullatës LGBTI në disa raste ishte i nxitur nga politikanë të njohur. Përfaqësues të pushtetit dhe persona publikë duhet të kufizohen nga gjuha jokorrekte, e pahijshme dhe ofenduese ndaj një kategorie të caktuar qytetarësh, sidomos duke i pasur parasysh pjesëtarët e bashkësisë LGBTI, pa marrë parasysh që këta persona nuk janë të përfshirë në rregullativën antidiskriminuese. Në një shoqëri e cila synon të kultivojë tolerancën ndaj tjetrit, pa marrë parasysh dallimet, nxitja e homofobisë i rrezikon vlerat demokratike. Plus kësaj, personat publikë duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre dhe për fuqinë e çdo fjale të shqiptuar publikisht, për shkak se ajo reflektohet në media dhe i bën kreacion vetëdijes së qytetarëve. Mu për këtë edhe Komisioni Evropian në Raportin për vitin 2013 u bën thirrje pushteteve që në të gjitha nivelet të bëjnë më shumë përpjekje për rritjen e vetëdijes dhe promovimin e tolerancës.

Mediat në një pjesë më të madhe të rasteve në periudhën e kaluar vetëm e kanë ndërmarrë retorikën nga politikanët, pa bërë distancën profesionale dhe kritike, e në disa raste, bile, edhe e kanë nxitur. Raportimi i mediave është varur nga anshmëria e tyre politike, prandaj dhe në këtë drejtim e kanë udhëhequr debatin, në masë të madhe pa i konsultuar fare organizatat civile që punojnë në këtë sferë.

- **Pengimi i diskriminimit, stereotipizimit dhe i gjuhës së urrejtjes në media.**

Sipas perceptimeve të Komitetit të Helsinkit dhe të H.E.R.A., raportet e mediave shpeshherë përmbajnë edhe gjuhë jotolerante ndaj disa grupeve të marginalizuara, si për shembull ndaj bashkësisë LGBTI, që në të vërtetë i përforcon stereotipat dhe paragjykimet ndaj këtyre personave në opinion. Në periudhën e kaluar janë vërejtur disa raste kur disa media kanë marrë pjesë në fushata ose i kanë udhëhequr ato ndaj disa grupeve të marginalizuara, kështu që ka ndodhur që përmes transmetimit të deklaratave të personave publikë, mediat shpesh ta përsërisin dhe ta përforcojnë diskursin homofobik. Kodi etik i

¹⁰⁶ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM dhe LGBTI-Qendra për përkrahje (2012) Raporti për zbatimin e Rekomandimit CM/Rec(2010)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për masat për luftë kundër diskriminimit mbi bazë të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor në RM. Arritur përmes: www.mhc.org.mk

gazetarëve të Maqedonisë e dënon përhapjen e diskriminimit dhe të gjuhës së urrejtjes, nxjerrjen e informatave subjektive mbi bazë të qëndrimeve personale në media, përveç nëse nuk bëhet fjalë për zhanrin e komentit, i cili duhet të jetë i shënuar qartë në media. Nevoja nga raportimi profesional, etik, me mundësi për të gjitha palët që të kenë qasje dhe të paraqiten në tregim, mbetet imperativ i çdo gazetari. Plus kësaj, në bashkësinë mediatike në më shumë raste vërehet i ashtuquajti “solidaritet joparimor”, përkatësisht gazetarët në të shumtën e rasteve i heshtin shkrimet e mediave të tjera dhe në këtë mënyrë, me qëllim ose jo, “solidarizohen” me kolegët. Një sjellje e këtillë e mediave nuk kontribuon në përparimin e të drejtave të njeriut. Vetë bashkësia e gazetarëve dhe e organizatave mediatike duhet t’i aktivizojnë mekanizmat vetërregullatorë dhe të dënojnë gjuhën ofenduese, të pahijshme ose gjuhën e urrejtjes ndaj grupeve të caktuara në shoqëri.

Edhe Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor në kuadër të KB, në rekomandimet e veta drejtuar shtetit qysh në vitin 2007, ka theksuar se duhet të ndërmerren masa efektive për implementimin e Kodit etik, i cili ndalon gjuhën e urrejtjes përmes mediave, por dhe duhet të aplikohen edhe sanksionet kriminale të parapara në nenin 319 nga Kodi Penal kundër gazetarëve që promovojnë diskriminim, racizëm dhe tensione ndëretnike, si dhe armiqësi përmes mediave.¹⁰⁷ Edhe krahas distancës kohore prej shtatë vjetësh, këto rekomandime ende janë relevante, për shkak se situata mbetet po ajo dhe nuk sanksionohet.

Bashkimi Evropian në Raportin e tij për vitin 2013, ndërkaq, konstaton se ka përmbytje homofobike në media, për të cilën gjë u bën thirrje profesionistëve dhe pronarëve të mediave që të ndërmarrin përgjegjësi më të madhe në ballafaqimin me injorimin dhe mostolerimin ndaj pjesëtarëve të kësaj bashkësie.

- **Nevojë për raportim gjithëpërfshirës për të drejtat seksuale dhe riprodhuese.**

Raportet mediatike të lidhura me të drejtat e njeriut, përfshi edhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese, duhet të bazohen mbi informatat gjithëpërfshirëse të fokusuara në një rast të caktuar, rekomandojnë aktivistët nga *Asociacioni për hulumtime shëndetësore dhe edukative – H.E.R.A.* Problemi për të cilin paralajmërojnë OC është ai që mediat shpeshherë transmetojnë informata parciais, ndonjëherë sipas manisë “sensacionaliste”, të cilat nuk bazohen në transmetimin e fakteve që lidhen me rastin. Kështu, ndodh që qytetarët të marrin pamjen e pjesërishme ose të shtrembëruar për situatën ose rastin.

Bashkëpunimi midis OC dhe mediave duhet të jetë në drejtim të alarmimit kur do të paraqitet ndonjë problem që lidhet me këtë sferë, me qëllim që të arrihet përfshirja sa më e madhe mediatike e temave, por dhe për ngritjen e vetëdijes publike në përgjithësi. Nga ana tjetër, ndërkaq, mediat duhet ta ndjekin në mënyrë sistematike sferën dhe të raportojnë në mënyrë më konsistente, jo vetëm kur ka shkase të veçanta që lidhen me çështje nga kjo sferë, por duhet të transmetojnë edhe tregime pozitive me qëllim që të ndryshojë perceptimi negativ për këta njerëz.

107 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor në kuadër të KB (2007) Vëzhgime përmbyllëse të Komitetit për Maqedoninë. Paragrafi 9. Arritur përmes: <http://www.refworld.org/country,,CERD,,MKD,4562d8b62,469b2f9b2,0.html>

- **Nevojë për mbrojtjen e identitetit gjatë raportimit për grupet e marginalizuara.**

Raportimet mediatike shpeshherë përmbajnë informata ose fotografi të cilat direkt ose indirekt e zbulojnë identitetin e personave. Kjo është veçanërisht brengosëse kur bëhet fjalë për pjesëtarë të grupeve të marginalizuara, përkatësisht për njerëz që jetojnë me HIV, pjesëtarë të bashkësisë LGBTI, shfrytëzues drogash ose, ndërkaq, punëtorë seksualë. Megjithëkëtë, mediat në bashkëpunim me OC duhet t'i transmetojnë tregimet njerëzore në mënyrë profesionale dhe etike, pa lënduar dinjitetin dhe të drejtat e këtyre njerëzve. Në të vërtetë, tregimet për jetën e këtyre njerëzve për problemet dhe paragjykimet me të cilat ballafaqohen, më lehtë mund ta tërheqin vëmendjen e lexuesit përmes shembujve konkretë, ku me kërkesë të bashkëbiseduesit do të mbrohet identiteti i tij.

II.6. PRIORITETE NË SFERËN E TË DREJTAVE TË TË RINJVE

Në Maqedoni nuk ka rregullativë që e përfshin popullatën e të rinjve të moshës nga 15 deri 24 vjeç, edhe pse një ligj i tillë ishte propozuar nga ana e qeverisë, por ishte tërhequr nga procedura kuvendore në tetor të vitit 2011, me qëllim që të sigurohej një konsultim më i gjerë me organizatat e të rinjve. Qeveria në vitin 2005 e nxori Strategjinë nacionale për të rinjtë, ndërsa në vitin 2012 e miratoi Planin aksional për punësimin e të rinjve, të parin e këtij lloji, si rezultat i shkallës së lartë ekstreme të papunësisë në mesin e të rinjve. Megjithatë, rezultatet nga implementimi i këtyre dokumenteve do të shihen në të ardhmen.

Në nivel lokal krijohen strategji dhe plane aksionale për të rinj, qëllimi i të cilave është rregullimi i pjesëmarrjes së të rinjve në krijimin e politikave në nivel lokal, por edhe që t'u përgjigjen nevojave të të rinjve. Strategjitë për të rinjtë, të plotësuara me plane aksionale, duhet të ofrojnë mundësi se si komuna t'u ndihmojë të rinjve, me të cilën gjë do t'i mbajë në mjediset ku jetojnë dhe do t'i motivojë që të japin kontributin e tyre në zhvillimin e bashkësisë. Perceptimet e organizatave civile që punojnë në këtë sferë janë se komunat nuk mbajnë shumë llogari për nevojat e të rinjve dhe shpesh i vënë në fund të prioriteteve të tyre. Edhe pse ka bashkëpunim midis institucioneve dhe sektorit civil, problemi është se institucionet i huqin punët gjatë realizimit dhe implementimit të aktiviteteve të parapara në dokumente të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e të rinjve dhe mbrojtjen e tyre. Institucionet duhet të mbështeten në bashkëpunimin me organizatat civile, nëse duan që në mënyrë të vërtetë t'i identifikojnë, por dhe të përgjigjen ndaj problemeve që i kanë të rinjtë.

Kjo pjesë e Librit të Bardhë është përgatitur në bashkëpunim me OC *Multikultura* nga Tetova, ndërsa gjatë identifikimit të problemeve janë shfrytëzuar të dhëna nga organizata të tjera rinore dhe institucione ndërkombëtare. Në vazhdim janë theksuar disa prej sferave problematike, por dhe me prioritet, me të cilat ballafaqohen të rinjtë në Maqedoni.

- **Vetëdija e ulët për të drejtat e të rinjve.** Vetëdija te të rinjtë në lidhje me të drejtat që i kanë, me mënyrat dhe mekanizmat përmes të cilëve mund t'i realizojnë, është në

nivel shumë të ulët, jo vetëm te të rinjtë, por në përgjithësi, edhe te mediat edhe tek opinioni. Nxënësit e shkollave të mesme, për shembull, janë të vetëdijshëm se kanë të drejtë arsimit, por jo edhe të drejta që i mbrojnë nga diskriminimi dhe keqpërdorimi, shpjegojnë nga OC *Multikultura* si rezultat i përvojës dhe punës së tyre shumëvjeçare në këtë sferë.

- **Papunësia.** Papunësia është njëri prej problemeve kryesor me të cilin ballafaqohen të rinjtë. Sipas statistikave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, madje 53% e të rinjve në Maqedoni kanë qenë pa punë në vitin 2011,¹⁰⁸ që është shkalla më e lartë në rajon, edhe pse ky është problem në nivel evropian. Sipas vlerësimeve të organizatave rinore, të rinjtë presin për t'u punësuar prej 5 deri në 7 vjet pas diplomimit. Organizatat rinore dëftojnë të dhëna se 25% e kuadrit me kualifikim të lartë e braktis shtetin, ndërsa sipas disa hulumtimeve 50% e nxënësve të shkollave të mesme nuk e shohin veten në shtet në 10 vitet e ardhshme.¹⁰⁹ Në raportin e Komisionit Evropian për vitin 2013 notifikohet se Qeveria ka zhvilluar strategji për pengimin e “ikjes së trurit”, përkatësisht të personave me arsim të lartë, megjithatë rezultatet henez duhet të ndiqen.

- **Arsimi.** Sipas hulumtimit të *Multikultura*, realizuar me studentë nga të dy universitetet në Tetovë, problemet në këtë sferë fokusohen në mungesën e arsimit kualitativ, vlerësimit të pamjaftueshëm të diturisë, hiperproduksionit të kuadrit të kualifikuar për pozicione pune që nuk janë deficitare në shtet, gjithashtu dhe nepotizmi ose blerja e diplomave. Nga *Multikultura* konsiderojnë se ka nevojë për një strategji gjithëpërfshirëse për arsimin dhe motivimin e studentëve që të regjistrohen në drejtimet që kanë prosperitet më të madh, në vend se kuadri të kualifikohet në ato degë për të cilat nuk ka vende të mjaftueshme të lira pune në shtet.

Edhe Komisioni Evropian në raportin e tij për vitin 2013 e notifikon problemin e mospërputhjes mes shkathësive të studentëve të diplomuar, me nevojën e punëdhënësve potencial. Edhe krahas ndryshimeve në rregullativë, në drejtim të implementimit të standardeve evropiane që kanë të bëjnë me arsimin, kualifikimin dhe të rinjtë, miratimin e Strategjisë për reforma në arsimin profesional dhe instalimin e parimit sipas të cilit praktika duhet të jetë pjesë e obligueshme e arsimit, një progres i vogël është shënuar në lidhje me reformat e parapara, konstaton Raporti. Komisioni Evropian, ndërkaq, i thekson hapat që shteti i ndërmerr në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës dhe kualitetin e arsimit në të gjitha nivelet.

Plus kësaj, më shumë organizata rinore angazhohen edhe për një bashkëpunim më intensiv midis institucioneve arsimore dhe sektorit civil, në drejtim të promovimit të arsimit joformal si metodë e mësimin të përjetshëm („life-long”). Organizata civile, në mesin e të cilave dhe *Multikultura*, bëjnë apel për një transparencë më të madhe të institucioneve arsimore kur bëhet fjalë për këtë temë.

108 Organizata Ndërkombëtare e Punës. Arritur përmes: http://www.ilo.org/budapest/information-resources/press-releases/WCMS_192029/lang--en/index.htm

109 Radio Evropa e Lirë „Papunësia e madhe te të rinjtë”, prill 2013. Arritur përmes: <http://www.makdenes.org/content/article/24947065.html>

- **Përfshirje në krijimin e politikave.** Është e domosdoshme një përfshirje më e madhe dhe më aktive e të rinjve në krijimin e politikave në nivel lokal dhe qendror, për shkak se ata janë më mirë të njohur me nevojat dhe problemet e këtyre grup-moshave. Këto janë edhe disa prej rekomandimeve edhe të institucioneve ndërkombëtare, sipas të cilave të rinjtë duhet të nxiten në pjesëmarrje dhe të jenë qytetarë aktiv. Me formimin e këshillave rinore në kuadër të komunave, bëhet një hap përpara për përmirësimin e pozitës së të rinjve në fushën e pjesëmarrjes në procesin e marrjes së vendimeve për çështje kyç për punën e të rinjve. Me themelimin e Këshillit Rinor Nacional (KRNM) në vitin 2013, pritet që të nxitet dhe të intensifikohet pjesëmarrja e të rinjve në procesin e krijimit të politikave. Roli bazë i KRNM do të jetë paraqitja e nevojave dhe e interesave të të rinjve dhe të organizatave rinore, zhvillimi i kapaciteteve të sektorit rinor, promovimi i pjesëmarrjes së të rinjve dhe i qytetarisë aktive, si dhe përfaqësimi dhe veprimi në emër të të rinjve. Në praktikë, trupi përfaqësues si këshill nacional për të rinjtë është ai që duhet t'i shënojë dhe t'i diskutojë politikat rinore dhe të jetë partner i institucioneve në proceset e konsultimit dhe të marrjes së vendimeve që lidhen me të rinjtë.¹¹⁰

- **Tensionet ndëretnike midis të rinjve.** Viteve të fundit janë aktuale tensionet dhe rrahjet nëpër shkolla, në rrugë dhe në ndeshje sportive mes të rinjve nga bashkësi të ndryshme etnike, problem ky i notifikuar në raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare. Në më shumë raste, në të kaluarën mediat gjatë mbulimit të këtyre incidenteve kanë raportuar në mënyrë të njëanshme në aspektin etnik – vetëm për rastet kur kishte të sulmuar ose të lënduar vetëm nga një bashkësi etnike, duke heshtur ose injoruar incidentet e ngjashme ku kanë qenë të përfshirë të rinjtë nga bashkësia tjetër etnike. Një raportim i këtillë i njëanshëm në media çon vetëm drejt forcimit të tensioneve, përhapjes së jotolerancës dhe të ksenofobisë ndaj “tjetrit”.

Përparësi në lidhje me bashkëpunimin midis OC që punojnë në këtë sferë dhe mediave

- **Rritja e informimit për të drejtat e të rinjve**

Të drejtat e të rinjve janë një sferë që nuk është e hulumtuar sa duhet në Maqedoni, ndërsa vetëdijësimi, qoftë edhe për këtë kategori qytetarësh, për të drejtat e tyre, është në nivel të ulët. Edhe pse më shumë organizata civile punojnë në stërvitjen që lidhet me të drejtat e të rinjve, megjithatë ndikimi që kanë mediat ndaj të rinjve, sidomos mediat online dhe sociale, mund të ndihmojë në rritjen e vetëdijes për të drejtat e të rinjve. Këtë duhet ta shfrytëzojnë organizatat civile dhe t'i drejtojnë fushatat dhe strategjitë e tyre për komunikim me grupet e targetuara dhe kah ky tip i mediave.

Vetëm një numër i vogël organizatash, në mesin e të cilave *Forumi Arsimor i të Rinjve* dhe *Fondacioni Metamorfozis*, bëjnë ndonjë hulumtim në sferën e të rinjve dhe raportin e tyre me mediat. Megjithatë, është evidente nevoja për më shumë hulumtime,

¹¹⁰ Ueb-faqja e KNRM. Arritur përmes: <http://nms.org.mk/nms/shto-e-nmsm/>

rezultatet e të cilave do të tregojnë se ku duhet të fokusohet vëmendja e organizatave civile dhe e institucioneve në drejtim të rritjes së informimit për të drejtat e të rinjve dhe për mbrojtjen e efikase të tyre.

- **Bashkëpunimi i shtuar midis mediave dhe OC**

Më shumë hulumtime tregojnë se mediat kanë ndikim të madh ndaj të rinjve dhe mu për këtë shkak ato janë vendi i vërtetë përmes të cilit OC mund t'i promovojnë aktivitetet e tyre dhe të arrijnë deri tek ato. Çështjet që lidhen me të rinjtë dhe me OC që i përfaqësojnë të drejtat e tyre janë në margjinat e interesimit të gazetarëve dhe të hapësirës mediatike. Nevojitet forcimi i bashkëpunimit midis mediave dhe OC, ashtu që përmes tij do të promovoheshin më shumë përmbajtje që i përfshijnë të rinjtë, e që janë "të paketuara" në mënyrë atraktive, me qëllim që të zgjojnë edhe vëmendjen e tyre, por edhe vëmendjen e opinionit më të gjerë. Në këtë kontekst, OC duhet t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre për komunikim me mediat, t'i përforcojnë aftësitë e tyre për aktivizim dhe lobizëm, që janë vetëm disa prej mënyrave se si ta tërheqin vëmendjen e mediave. Nga ana tjetër, ndërkaq, mediat duhet të gjurmojnë forma kreative të produkteve mediatike, të cilat do t'i paraqesin problemet dhe sfidat e të rinjve në mënyrë adekuate. Vetëm përmes "sinergjisë" së bashkëpunimit media dhe organizata civile mund të kontribuohet drejt informimit dhe edukimit më të madh të të rinjve për të drejtat e tyre dhe për mekanizmat për mbrojtjen e tyre.

- **Përhapja e tolerancës dhe të vlerave të mira**

Bashkëpunimi midis OC dhe mediave është i domosdoshëm sidomos gjatë parandalimit të ndeshjeve, mosmarrëveshjeve dhe tensioneve mes të rinjve nga bashkësi të ndryshme etnike. Mediat shpeshherë me mënyrën e raportimit e transmetojnë fjalorin jotolerant dhe ofendues, me të cilën gjë vetëm që e theksojnë ose e përforcojnë diskursin e jotolerancës. Mediat dhe gazetarët duhet të jenë të ndjeshëm sidomos kur raportohet për situata fërkimesh ose tensionesh, duke i paraqitur të gjitha aspektet (palët) e ngjarjes, duke transmetuar mesazhe tolerance dhe bashkëjetese, sidomos në shoqëritë multi-etnike, siç është kjo e jona.

II.7. PRIORITETE NË SFERËN E TË DREJTAVE DIGJITALE

Me të drejtat digjitale nënkuptohet përmbledhja e të drejtave themelore të njeriut në rrethimin digjital, që përfshin të drejtën e privatësisë, të drejtën e mbrojtjes të të dhënave personale, të drejtën e shprehjes e të gjuhës së lirë, të drejtat e autorit, të drejtën e informimit e të ngjashme. Organizata Të Drejta Digjitale Evropiane - EDRI,¹¹¹ si organizatë-çadër e llojit të vet e nja 40 organizatave të veçanta që i përfaqësojnë të drejtat civile në sferën e shoqërisë informative, i definojnë kështu të drejtat digjitale, duke u udhëhequr në këtë rast nga direktivat dhe rregullativat e Bashkimit Evropian. Ajo çka është karakteristikë e veçantë për këto të drejta në shoqërinë informative, është që ato praktikohen dhe realizohen bashkërisht, në paketë. Kjo është kështu për shkak të konceptit përbashkues të teknologjisë informative digjitale dhe të mediave të reja.

Sipas ekspertëve nga kjo sferë, të drejtat digjitale janë sfera ku përputhen më shumë të drejta të lidhura. Teknologjitë e reja mundësojnë arritje më të mëdha, por edhe mundësi për të shkaktuar dëm në një rreth shumë të gjerë njerëzish dhe të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Të drejtat digjitale janë përfshirë me Rezolutën për promovim, mbrojtje dhe kënaqje të të drejtave të njeriut në Internet, miratuar nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut i KB më 5 qershor të vitit 2012.¹¹²

Në shkrimin e kësaj pjese të Librit të Bardhë ka marrë pjesë përfaqësuesi nga OC *Metamorfozis*, fondacion për internet dhe shoqëri, e cila tashmë qe 14 vjet punon në sferën informative.

• **Legjislacioni dhe aplikimi i legjislacionit.** Një pjesë e madhe e çështjeve nga e drejta digjitale në Maqedoni tashmë janë përfshirë në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, Ligjin për komunikime elektronike, Ligjin për radiodifuzion, Kodin penal dhe në Ligjin për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje, si dhe në më shumë ligje të tjera. Meqë të drejtat dhe obligimet e qytetarëve edhe në botën digjitale duhet të vlejnjë njësoj si dhe jashtë saj, në rastin e përgjithshëm nuk ka nevojë që të nxirren ligje të veçanta që do të kishin të bënin me sferën specifike digjitale.

Edhe pse është sferë relativisht e re dhe specifike, të drejtat digjitale kanë kthyer vëmendjen për vete kur, nisur nga disa arsye, u hapën çështje për rregullimin ligjor të segmenteve të ndryshme të shoqërisë që i prekin ose i ngacmojnë të drejtat digjitale. Ishte ky rasti kur organizoheshin iniciativa për rregullimin e mbrojtjes së të dhënave personale, kur filloheshin procedurat kuvendore për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që e rregullojnë ndjekjen e komunikimeve elektronike e të ngjashme.

Vëmendje të veçantë në atë kuptim gjatë dy viteve të fundit shkaktoi iniciativa e Qeverisë për nxjerrjen e legjislacionit të ri për mediat, ku më problematike ishte ten-

111 European Digital Rights – EDRI. Arritur përmes: www.edri.org

112 The United Nations Human Rights Council Resolution “The promotion, protection and enjoyment of human rights on the Internet” <http://bit.ly/RIGqcm>. Më shumë informata: Intellectual Property Watch. (05.07.2012). New UN Human Rights Council Resolution On Internet Rights <http://bit.ly/LWIS4a>.

denca e propozuesit që t'i mbulojë të gjitha tipat e mediave – radiodifuzionin, mediat e shtypura dhe ato elektronike. Gjatë kësaj propozohet që përgjegjësia për implementimin e ligjeve të jetë në duart e trupit të ri rregullator – Agjencia për Media Audiovizuale, “trashëgimtare” e Këshillit të Radiodifuzionit (KRD) – e cila për shkak të mënyrës së emërimit të anëtarëve të saj përsëri do të ishte nën kontrollin direkt të subjekteve politike qeverisëse. Bashkësia dominante e mediave, ekspertët, organizatat civile, si dhe institucionet ndërkombëtare që merren me lirinë e të shprehurit, reagues në qëllimin e këtillë të ligjvënësit.¹¹³

Disa nga organizatat mediatike profesionale i kushtuan vëmendje të veçantë rregullativës ligjore rigjide të propozuar për mediat e reja dhe sferën e internetit. Edhe organizatat ndërkombëtare, si për shembull, Asociacioni për Komunikime Progresive (AKP),¹¹⁴ me seli në Johannesburg (JA), e problematizuan mundësinë që ligji të vendos se çfarë është roli dhe cilat janë detyrimet e gazetarëve, të redaktorëve, bllogjerëve dhe anëtarëve të tjerë të bashkësisë së mediave. Problem tjetër në ligj është edhe ajo që “personat që duan ta informojnë publikun”, përmes publikimeve të shtypura dhe elektronike, duhet të regjistrohen tek agjencia e re, e cila do të kishte fuqi arbitrare për ta interpretuar ligjin. Për shembull, për shkak të definicionit sipërfaqësor për botuesit e mediave, personat individual dhe organizatat joqeveritare vihen në rrezik të mos mund të regjistrojnë portale informative. Nëse edhe përkundër asaj vendosin që t'i themelojnë portalet e tilla, ato mund të dënohen me të holla. Me dispozitat e këtilla, ligji i propozuar e kufizon lirinë e informimit dhe lirinë e të shprehurit në internet. Nga *Metamorfozis* paralajmërojnë se “interneti është hapësira e vetme e mbetur e lirë për diskurs publik kritik dhe për shprehje publike; Qeveria i kërcënohet arenës së fundit të lirisë së të shprehurit”.

- **Liria e të shprehurit përballë gjuhës së urrejtjes në internet.** Me rëndësi të veçantë për përparimin e lirisë së të shprehurit është përballimi me gjuhën e urrejtjes që është e pranishme në internet, si pasojë e aktiviteteve të aktorëve kyç politik, përkrahësve të tyre mediatik dhe (mosaktivitetit të) institucioneve nën kontrollin e tyre. Në radhë të parë, është e rëndësishme të demaskohet gjuha e urrejtjes si “dhunë verbale”, përkatësisht keqpërdorim i të drejtës së të shprehurit që të nxitet dhuna ose të krijohet klima në të cilën dhuna është e mirëseardhur.¹¹⁵ Përderisa rastet e gjuhës së hapur të urrejtjes në media janë relativisht të rralla, ato janë të pasura me mesazhe të koduara për ithtarët e opsioneve të caktuara ideologjike ose partiake, që më pas i interpretojnë dhe shpërndajnë në formë më pak të sofistikuar përmes rrjeteve sociale, komenteve në

113 SHGM, Sindikata e Gazetarëve, MIM, Fronti për Lirinë e Shprehjes – platformë e përbërë nga 9 organizata civile, siç janë Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, QZHM, Metamorfozis, Civil, FSHHM, OJQ Infoqendra, Koalicioni „Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësisë të marginalizuara“, MCEO, Javnost, Jadro dhe Kontrapunkt (www.sloboda.kauza.mk). Mendime ekspertësh në të njëjtin drejtim dhanë dhe Këshilli i Evropës dhe OSBE, ndërsa shqetësimet shfaqën edhe BE edhe SHBA nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

114 Asociacioni për Komunikime Progresive. Kumtesë: „AKP: Qeveria maqedonase tenton ta kufizojë lirinë e shprehjes në internet dhe ta forcojë kontrollin mbi mediat“, 4 qershor 2013. Arritur përmes: <http://mdc.org.mk/mk/apc-makedonskata-vlada-se-obiduva-da-ja-ogranici-slobodata-na-govorot-na-internet-i-da-jazajakne-kontrolata-vrz-mediumite>

115 Rekomandim: Ligjërata të Robert Beliçanecit për gjuhën e urrejtjes në konferencën „Engage“ në Shkup, me arritje në videoformat: <http://www.youtube.com/watch?v=Rj7fYUol79k>

shkrime, në portale dhe në forume (administratorët e të cilave e lejojnë këtë). Burimet e këtuja të definuara të gjuhës së urrejtjes janë objekt për reagime nga organizatat media-tike si *SHGM* (Këshilli i nderit), *MIM*, *QZHM*, por edhe organizata të tjera që punojnë për mbrojtjen e lirive në hapësirat digjitale. Të tilla janë, për shembull, analizat për aplikimin e standardeve gazetareske që bëhen përmes Servisit për Shqyrtimin e Fakteve nga Me-diat, komponentë e projektit të USAID për mbështetjen e mediave në Maqedoni, të cilën e zbaton *Metamorfozis* (<http://mediumi.vistinomer.mk>). Qëllimi i këtyre analizave është të lihet shenjë publike për keqpërdorimet në funksion të edukimit të qytetarëve.

Nga ana tjetër, ekzistimi i gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale shfrytëzohet si shkas për kërcënime dhe masa represive nga ana e pushtetit (për shembull, policia mbyll grupe paqësore dhe evenimente në *Fejsbuk*) dhe për nxjerrjen e ligjeve të reja, me të cilat edhe më tej zgjerohet kontrolli i tyre. Në të njëjtën kohë pushteti nuk i sanksionon, madje edhe refuzon të ngrejë procedura përkatëse penale në rastet e nxitjes së dhunës përmes mediave të shtypura dhe digjitale.

- **Arsimimi digjital.** Në një situatë kur pjesa më e madhe e popullatës çdo ditë i shfrytëzon teknologjitë e reja, qoftë në formën e qasjes në Internet përmes kompjuterëve ose telefonave celularë, termi arsimim digjital fiton kuptim më të gjerë nga vetëm aftësia që të shfrytëzohet një tip i caktuar i softuerit. Në shekullin XXI, arsimimi digjital përfshin edhe vetëdijen për atë se si teknologjitë e reja ndikojnë në jetën individuale të qytetarit, si mund t'i përparojnë ose rrezikojnë të drejtat e tij themelore të njeriut, ndërsa edhe t'i mundësojnë pjesëmarrjet direkte në proceset shoqërore që ndikojnë në jetën e tij dhe në jetën e bashkësisë së tij.

Te një pjesë e qytetarëve dhe gazetarëve që janë rritur pa “ekspozim” të madh të teknologjive digjitale, siç është rasti me gjeneratat e reja, ende mund të vërehet një nivel i caktuar i pakëndshmërisë (aq. teknofobi) ose rezistencë kur iniciohen çështje të lidhura me këto fusha, për shkak të paragjyqimit se për të nevojitet njohuri eksperte, të cilën e kanë vetëm informatikanët e specializuar. Përkundrazi, ashtu siç nuk guxojnë ta monopolizojnë konceptin e lidhur ngushtë me arsimimin mediatik vetëm komunikologët, ashtu edhe arsimimi digjital (me të cilën, për shkak të konvergencës mediatike, shpesh konvertohen njëra me tjetrën) duhet të bëhet fushë interesi edhe për OC edhe për mediat, pa dallim nga ajo se ato janë veç më të specializuara për mbulimin e fushave dhe çështjeve të caktuara.

- **Mbrojtja e privatësisë në komunikimet në internet nga mbikëqyrja e pakontrolluar.** *Qendra për Zhvillimin e Mediave (QZHM)*, *Fondacioni Metamorfozis* dhe *OJQ Infoqendra* kërkuar që Republika e Maqedonisë të bëjë vlerësimin se a përputhen legjislacioni nacional dhe aktivitetet në fushën e ndjekjes së komunikimeve me obligimet e ndërmarra në fushën e të drejtave ndërkombëtare të njeriut.

Këto organizata udhëzojnë në parimet ndërkombëtare kundër ndjekjes së pakontrolluar dhe mbikëqyrjes së komunikimeve¹¹⁶ me qëllim të rregullimit në këtë sferë. Këto parime, për herë të parë në histori, vendosin kornizë për vlerësimin e praktikave të

¹¹⁶ Ueb-faqja e Necessary and Proportionate. Arritur përmes: <https://NecessaryandProportionate.org>

ndjekjes dhe mbikëqyrjes, në kontekst të obligimeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Trembëdhjetë parimet e paraqitura para Këshillit për të Drejtat e Njeriut në KB janë: ligjshmëria e kufizimeve të privatësisë; kufizimet të kenë qëllim legjitim dhe të jenë të nevojshme; ndjekja e komunikimeve të jetë e përshtatshme dhe proporcionale me qëllimin e vënë; vendimin për ndjekje ta bëjë trupi kompetent gjyqësor; të respektohen të drejtat e qytetarëve dhe ata të informohen në kohë për ndjekjen e komunikimeve të tyre; shfrytëzimi i ndjekjes së komunikimeve të jetë transparent dhe t'i nënshtrohet mbikëqyrjes publike; të sigurohet integriteti i komunikimeve dhe i sistemeve; të sigurohen mjete mbrojtëse në bashkëpunimin ndërkombëtar; si dhe të ketë mbrojtje nga qasja joligjore në komunikimet.

Që të forcohet besimi i qytetarëve në institucionet shtetërore, dhe në të njëjtën kohë të sigurohet funksionimi i tyre demokratik në Maqedoni, organizatat civile kërkuar vendosjen e detyrueshme të mekanizmave për kontroll civil dhe të llogaridhënies të shërbimeve shtetërore që kanë autorizime dhe posedojnë pajisje për ndjekje dhe mbikëqyrje të komunikimeve në internet. Privatësia është e drejtë themelore e njeriut, e garantuar me Kushtetutën e RM dhe mbrojtja e të dhënave personale duhet të ngrihet në nivel më të lartë nga ana e të gjithë pjesëmarrësve relevantë në shoqëri: në sektorin shtetëror, afarist dhe joqeveritar. Rëndësia e kësaj të drejte është e riafirmuar me rezolutën *E drejta e privatësisë në erën digjitale*, e miratuar në KB më 26 nëntor të vitit 2013,¹¹⁷ në të cilën thuhet se njerëzit duhet t'i kenë të gjitha të drejtat "onlajn" sikurse dhe të drejtat që i gëzojnë jashtë botës virtuale, që në veçanti i referohet të drejtës së privatësisë. Me këtë rezolutë shtetet ftohen që t'i respektojnë dhe t'i mbrojnë këto të drejta në kontekst të komunikimit digjital.

- **Politika për privatësi.** Ueb-faqet sipas definicionit mbledhin të dhëna personale për shfrytëzuesit e tyre, edhe atë në mënyrë automatike – në regjistrimet e serverëve për çdo vizitë, shkruhet IP-adresa (ang. IP) e shfrytëzuesit dhe përmbajtjet që i ka shfrytëzuar, por edhe "në mënyrë manuale" – përmes mundësisë që shfrytëzuesit vetë të lënë të dhëna për vetveten përmes komenteve, e-mesazheve etj. Sipas ligjeve dhe dispozitave që vlejnë në RM, pronari i ueb-faqes ka rol të kontrollorit të këtyre të dhënave dhe është i obliguar të vendos sistem dhe procedura me të cilat do të sigurojë mbrojtjen e tyre maksimale.¹¹⁸ Pasqyrë publike e atij sistemi është shpallja e politikës së privatësisë, dokument me të cilin shfrytëzuesve iu sqarohet cilat të dhëna mblidhen, përse dhe çka bëhet me to. Shpallja e politikës së privatësisë nuk është obligim ligjor, por është praktikë e mirë që mundëson ndërtimin e besimit.¹¹⁹ Një pjesë relativisht e vogël e ueb-faqeve në Maqedoni i shpallin këto politika, me çka të parat janë e-shitoret, për të cilat ky obligim vihet nga ana e bankave.

117 Rezolutë e KB. E drejta e privatësisë në erën digjitale (nxjerrë më 26 nëntor 2013). Arritur përmes: <http://bit.ly/1fA6j47>

118 Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Elektronike. „Koment në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale“ dhe Doracak për zbatimin praktik të Rregullores për masat mekanike dhe organizative për mundësimin e fshetësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Arritur përmes: <http://dzlp.mk/mk/elektronski%20izdanija>

119 Metamorfozis. „Vodiç nr. 6: Si deri te politika për privatësi?“ Arritur përmes: http://www.metamorphosis.org.mk/mk/izdanija-resursi/doc_details/131----6-----

Mediat, në bashkëpunim me OC që angazhohen për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe trupa shtetërore kompetent, Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mund të sigurojnë nxitje të fuqishme që të ngrihen etnitetet që posedojnë ueb-faqe në nivel më të lartë të praktikës në këtë fushë.

- **Kultura e lirë dhe të drejtat e autorit.** Edhe pse në dukje bëhet fjalë për çështje të sferës ekonomike ose kulturore, të drejtat e autorit në botën digjitale janë në mënyrë direkte të ndërlidhura me realizimin e të drejtave themelore të njeriut, mes të cilave edhe e drejta për lirinë e të shprehurit. Përkatësisht, ligjet restriktive për mbrojtjen e të drejtave të autorëve në disa shtete shfrytëzohen edhe si mjet për heshtjen e kritikuesve të gjendjeve dhe praktikave të caktuara, si për shembull: përmes dënimeve për shfrytëzim të pjesëve të lajmeve, fotografive, bërjes së parodive, piraterisë softuerike etj. Nga ana tjetër, teknologjitë digjitale dhe aftësia e tyre për shumëzim mundësojnë shpërndarje të paparë deri më tani të informatave dhe të dijeve përmes bashkëpunimit të njerëzve nga e tërë bota, për të cilën shembull më i dukshëm është *Vikipedia*. Njoftimi me bazat e sistemit të të drejtave të autorit, si dhe iniciativat për aplikimin e tij me qëllim të shpërndarjes së diturive si *Krijetiv komons*¹²⁰ (për përhapjen e përmbajtjeve digjitale si tekst, fotografi dhe film) dhe *Softuer i lirë* (softuer me kod të hapur shfrytëzimi dhe mbindërtimi i të cilit është i lejuar nën kushte të caktuara) janë pjesë e arsimimit digjital. Ato janë komponentë të lëvizjes së quajtur *Kulturë e lirë* (ang. Free Culture Movement), ku bëjnë pjesë edhe iniciativat për përparimin e domenit publik si rrjet panevropian KOMUNIA,¹²¹ lëvizjes për *Qasje të Hapur* (ang. Open Access) në përmbajtjet akademike dhe shkencore që i nënshtrohen shqyrtimit specialist, si edhe lëvizja *Resurse të Hapura Arsimore* (www.oer.mk), qëllimi i së cilës është mundësimi komplet i afrimit digjital të librave, ndihmesave shkollore dhe krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit me qëllim përfundimtar-rritjen e kualitetit në arsim.

Në nivel praktik OC, e veçanërisht mediat, përmes kyçjes në këto rrjedha mund të kuptojnë në nivel minimal se si në mënyrë legale dhe në kushte ferr të marrin përmbajtje nga interneti, pa frikë se do të paditen për ndonjë lloj piraterie, e në rastin më të mirë se si të kontribuojnë në zhvillimin e bazës së hapur botërore të diturisë dhe me atë ta rrisin shikueshmërinë e aktiviteteve të tyre në funksion të plotësisht të misioneve të tyre.

- **Zhvillimi i e-qeverisjes: të dhëna të hapura dhe e-pjesëmarrja.** Përmes një varg dokumentesh strategjike dhe zgjidhjeve ligjore, pushtetet shtetërore dhe lokale në Maqedoni kanë obligim që ta zhvillojnë sistemin e e-qeverisjes (ang. e-governance), përkatësisht infrastrukturës për servise elektronike qeverisëse, që shkurtimisht quhet e-qeveri (ang. e-government). Përveç transmetimit të komunikatave dhe mbulimit të ngjarjeve, ky proces rrallë paraqet objekt hulumtimi nga ana e gazetarëve, pjesërisht edhe për shkak të perceptimit se bëhet fjalë për çështje të specializuara teknike nga sfera e inxhinierisë softuerike, përkundër asaj që thelbi i këtyre ndryshimeve është organizativ (menaxhment dhe procese) dhe ka të bëjë me zbatimin e më shumë

120 www.cc.org.mk

121 www.communia-association.org

dispozitive të miratuara. Nga ana tjetër, numri i organizatave joqeveritare që marrin pjesë ose e ndjekin këtë proces vetëm nga aspekti teknik është shumë i vogël. Për njohjen e pasojave dhe pasjes së një pasqyre më të madhe, gazetarët mund të zhvillojnë bashkëpunim edhe me organizatat që merren me ndjekjen e punës së institucioneve (ang. watchdog), që në masë të madhe është e lidhur me zbatimin e teknologjive të reja.

Pas impulsit fillestar të zhvillimit të e-qeverisjes në Maqedoni, që vërehej në periudhën prej disa vitesh pas nxjerrjes së Strategjisë nacionale për shoqëri informatike të vitit 2005, RM shënon ngecje ose kthim prapa sipas hulumtimit vjetor për e-qeveri të OKB (ang. United Nations E-Government Survey).¹²² Në periudhën deri në vitin 2011, kur u mbyll edhe Projekti me ndikim i USAID për e-qeveri (USAID e-Government Project), zhvillimi i e-shërbimeve që gjenerojnë të ardhura për shtetin u vu si prioritet. Mbetet një hapësirë e madhe për zhvillimin e e-shërbimeve që ndikojnë në jetën e përditshme të individëve, që edhe mediat edhe OJQ të mund të ndihmojnë në atë zhvillim përmes artikullimit të nevojave të qytetarëve, si edhe të nevojave të tyre organizative, në përgjithësi, dhe për sfera specifike të interesit.¹²³

Gjatë “skenarit” pozitiv, sistemet e e-qeverisjes shfrytëzohen për rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies së institucioneve, me këtë obligohen veçanërisht gjatë implementimit të tyre proaktiv të ligjeve, për shembull të Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik. Një pjesë e institucioneve janë të detyruara të shpallin të dhëna për punën e tyre, veçanërisht për aspektet financiare, të cilat mandej bëhen më të arritshme përmes analizës së tyre (për shembull, *Transparenca Maqedoni* dhe të dhënat nga Enti Shtetëror për Revizion) ose publikim i thjeshtë online (për shembull, rezultatet e kërkesave për qasje të lirë që azhurnohen në www.spininfo.org.mk). Prej këtyre të dhënave fitohet vlera edhe përmes sigurimit të mënyrave të reja të paraqitjes (për shembull, të dhëna për buxhetet komunale të paraqitura përmes servisit www.sledigiparite.mk).

Të dhëna të hapura

Republika e Maqedonisë është pjesë e iniciativës ndërkombëtare Partneritet për Pushtet të Hapur- PPH (ang. Open Government Partnership),¹²⁴ emër ky përkthimi zyrtar i të cilit në gjuhën maqedonase – Partner i Hapur Qeveritar është i gabuar, me ç’rast e ndërron fokusin nga pushteti i hapur, drejt partneritetit mes qeverive. Përmes PPH shtetet-anëtare obligohen se do t’i zbatojnë parimet e transparencës, përmes aplikimit të teknologjive të reja e në praktikë kjo në të shumtën e rasteve do të thotë promovim dhe zbatim i standardeve për të dhëna të hapura (ang. Open Data), përkatësisht vënien e të dhënave që i kontrollojnë institucionet e shtetit në dispozicion të publikut (në përjashtim të të dhënave të klasifikuara dhe atyre personale të qytetarëve). PPH iu ofron mundësi OC dhe mediave që të ndikojnë në këtë proces, duke i treguar të dhënat

122 <http://unpan3.un.org/egovkb/>

123 <http://www.metamorphosis.org.mk/mk/vesti/makedonija/2511-konferencija-e-vlast-i-otvoreni-denovi-na-seeita>

124 <http://www.opengovpartnership.org/>

që janë me prioritet, që “të hapen” përmes dorëzimit të kërkesës për këtë dhe përmes ndjekjes së obligimeve të ndërmarra.

E-pjesëmarrja qytetare në marrjen e vendimeve

Teknologjitë e reja ofrojnë mundësi efikase dhe të lira për t’u kyçur qytetarët në marrjen e vendimeve që ndikojnë në jetën e tyre. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve, që nënkupton informimin dhe ndikimin e vazhdueshëm nga ana e qytetarëve ndaj institucioneve, është njëra nga shtyllat e demokracisë moderne, kundrejt qëndrimit që dominon në Maqedoni, sipas të cilit, përveç në ditën e zgjedhjeve, qytetarët duhet të jenë vëzhgues pasiv të proceseve politike. Zhvillimi i mekanizmave për pjesëmarrje civile (ang. e-participation), që është obligim në procesin e afrimit të shoqërisë maqedonase drejt BE-së, është një qasje e cila mundëson shpenzime minimale për efekt maksimal, në situatën kur më shumë se gjysma e popullsisë ka qasje në internet (përqindja e saktë është e paarrtshme në mungesë të regjistrimit).

Në vitin 2008 Qeveria e RM e publikoi Regjistrin elektronik unik nacional të akteve të RM (www.ENER.gov.mk), si pjesë e procedurave për Vlerësimin e ndikimit të rregullativës (ang. Regulatory Impact Assessment - RIA). Të gjithë trupat unik janë munduar të sigurojnë mundësi “që palët e interesuara të përfshihen me kohë në krijimin e rregullativave” përmes komenteve në ENER. Në vitin 2011 Qeveria miratoi Kodin e praktikave të mira për pjesëmarrjen e sektorit civil në procesin e krijimit të politikave, që duhet të realizohet përmes sektorit për bashkëpunim me OJQ në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë (www.nvosorabotka.gov.mk), ndërsa, nga ana tjetër, përmes dekretit për konsultime publike, miratoi Kodin për konsultime me publikun gjatë kohës së përgatitjes së rregullativës dhe doracakun për administratën publike dhe për bashkësinë afariste.¹²⁵ Në vitin 2012 Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës e publikoi portalin e-demokratija (www.e-demokratija.mk), qëllimi i deklaruar i të cilit është rritja e pjesëmarrjes qytetare, e ngjashme me konceptin e ENER-it dhe me funksione shtesë, sikurse forum dhe seksion me lajme/bllog.

Niveli i shfrytëzimit të teknologjive të reja për komunikim me pushtetet nuk është hulumtuar tërësisht dhe përbën një fushë të frytshme bashkëpunimi midis mediave dhe OC nga të gjitha sferat. Pushtetet vetëm pjesërisht i plotësojnë obligimet formale për t’i publikuar projekt-ligjet dhe rregullativën tjetër të nivelit më të ulët, siç janë aktet dhe rregullativat nënligjore në sajtet e theksuara. Ueb-faqja e Kuvendit (www.sobranie.mk) zakonisht i paraqet të gjitha materialet me mbledhjet e tij (projekt-ligjet, rezultatet nga votimi, stenogramet), në atë mënyrë sa që qasja nuk është e lehtë, kështu që nevojitet një kërkim më i komplikuar dhe pa mundësi për interaksion.

Hulumtimi i sajteve komunale që ka bërë *Metamorfozis* në vitin 2010 tregoi se pothuajse gjysma e tyre janë jofunksionale ose jo të përhershme.¹²⁶ Qytetarët mund të komunikojnë me pushtetin qendror përmes komenteve në portalin www.uslugi.gov.mk, i cili duhet të shërbejë si ndërmjetës midis tyre dhe institucioneve. Ueb-faqet tjera me

¹²⁵ <http://www.vicepremier-ekonomija.gov.mk/?q=node/275>

¹²⁶ http://www.metamorphosis.org.mk/en/publications/doc_details/88-----

ekstensionin “gov.mk” ofrojnë mundësi të kufizuara komunikimi përmes formularëve për komente dhe e-posta, por në dallim nga e kaluara, pothuajse edhe nuk ka forume publike ku do të shihej për gjithë çka e intereson qytetarin dhe çfarë përgjigje kanë marrë. Disa prej trupave qeveritare shfrytëzojnë media sociale (*Fejsbuk, Tviter*) si primare për komunikim të njëanshëm. Vullneti politik është faktor kyç që mund të jetë lëndë hulumtimi nga ana e mediave dhe OC në këtë sferë, që mund të nxisin ndryshime pozitive në këtë nivel.

- E-inkluziviteti. Përfshirja, përkatësisht sigurimi i mundësive për përfshirjen e të gjithë qytetarëve në shfrytëzimin e arritjeve të shoqërisë informative është obligim, të cilin organet shtetërore e kanë ndërmarrë përmes një varg dokumentesh dhe rregullativash strategjike.¹²⁷ Kjo kap një spektër të gjerë nevojash që kanë të bëjnë me përfshirjen e grupeve të ndryshme të marginalizuara ose joshumicë, tejkalimin e jazit digjital në mjedise rurale dhe të varfra, përmes aplikimit të standardeve botërore për arritjen e përmbajtjeve digjitale gjatë përpunimit të zgjidhjeve softuerike, deri në mundësimin e përmbajtjeve në gjuhët që i flasin qytetarët në shtet. Në vitin 2006 grupi i punës i BE-së për zhvillimin e e-qeverisë inkluzive i përcaktoi këto kategori si objektivi i intervenimit nga kjo sferë:¹²⁸

1. Familje dhe fëmijë me rrezik, në mesin e të cilëve prindër që vete e mbajnë familjen, familje të dhunshme, familje të mëdha;
2. Të rinj me rrezik, përfshi dhe shtatzëninë tek adoleshentët;
3. Vendbanime me njerëz pa strehë, substandarde, me shpërngulje të shpeshta;
4. Papunësi dhe probleme me punën;
5. Persona më të moshuar;
6. Njerëz me pengesa zhvillimore;
7. Arsimit dhe stërvitje të ulët, me arsimim të ulët;
8. Sjellje kriminele ose jolegale (në mesin e të cilëve ish-të burgosur, shfrytëzues drogash etj.);
9. Viktima të sjelljes që shkakton mundim fizik ose mental (krime, dhunë në familje etj.);
10. Pakica etnike, kulturore dhe gjuhësore, në mesin e të cilëve edhe të huaj, prej të cilëve nuk janë të gjithë të nëpërkëmbur, por që sistemet e-qeveri mund ta rrisin izolimin e tyre;
11. Probleme gjeografike, zona pa mundësi shkaku i infrastrukturës së dobët ose i zhvillimit të ulët socio-ekonomik;
12. Probleme me mbrojtjen shëndetësore dhe nevojat për kujdes afatgjatë.

¹²⁷ Mes të cilave edhe Strategjia për e-qeveri, Plani strategjik i MSHIA 2012-2014 dhe Strategjia nacionale për e-kyçje 2011-2014.

¹²⁸ Më shumë në Roadmap for Inclusive eGovernment in the Western Balkans: Building e-Services Accessible to All (2008) http://www.metamorphosis.org.mk/en/publications/doc_details/44-roadmap-for-inclusive-egovernment-in-the-western-balkans

- **Bashkëpunimi me institucionet dhe azhurnimi i tyre.** Disa jopërputhshmëri në realizimin dhe aplikimin e të drejtave digjitale më shpesh paraqiten për shkak të dallimeve rreth mosharmonizimit midis asaj që e ofron legjislacioni si kornizë dhe kapacitetet e institucioneve që punojnë dhe i realizojnë aktivitetet në sferat që i përfshijnë të drejtat digjitale.

- Për shembull, trupi që është përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale edhe në sferën e internetit, Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk ka mjete buxhetore të mjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme. E ngjashme është situata edhe me shumë trupa të tjerë rregullatorë, sikurse Komisioni për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik, dhe kjo reflektohet në punën e tyre. Nga ana tjetër, ka më shumë trupa rregullatorë nga kjo sferë që janë të partizuar, si pjesë e problemit të përgjithshëm të partizimit të institucioneve. Kjo në masë të madhe e vë në pyetje efikasitetin e punës së institucioneve që janë me përgjegjësi për këto sfera, siç është Agjencia për Komunikime Elektronike ose Këshilli i Radiodifuzionit. Kjo gjendje, politizimi dhe partizimi i institucioneve, në vend se të jenë të pavarura dhe të mëvetësishme, i dekurajon qytetarët që duhet t'u drejtohen.

- **Të drejtat digjitale të fëmijëve.** Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në sferën digjitale ka të bëjë me të gjitha sferat e theksuara më lart, mirëpo është e ndarë për shkak të rëndësisë së saj të jashtëzakonshme për shkak të pasojave pozitive dhe negative që mund të dalin te kjo pjesë e popullsisë. Në të dy rastet me rëndësi kyç është përndarja e dijeve dhe shkathtësive, përkatësisht arsimi i fëmijëve, drejtpërdrejt ose përmes edukimit të dy grupeve të synuara të lidhura: prindërit/tutorët dhe arsimtarët. Është me rëndësi që të bëhet edhe një distinkcion plotësues edhe te “fëmijët”, të cilët në legjislacionin maqedonas barazohen me të miturit, përkatësisht me personat e moshës nën 18 vjeç. Edhe pse të gjithë ata në njëfarë mënyre shfrytëzojnë teknologji të reja dhe shpeshherë janë “indigjenë” në sferën digjitale,¹²⁹ nevojat e fëmijëve të moshës parashkollore (deri në 6 vjeç), fëmijëve që shkojnë në klasat më të ulëta dhe më të larta të shkollës fillore (6-10 dhe 11-14 vjeç), si dhe në shkollë të mesme (mbi moshën 15 vjeç, të cilët mbulojnë edhe me kategorinë të rinj ose rini), nga shumë aspekte dallojnë në mënyrë drastike dhe kërkojnë qasje të ndryshme.

Janë sidomos kritike sferat e mbrojtjes së të drejtave të privatësisë dhe të sigurimit në sferën digjitale, për shkak të lëndimit të fëmijëve dhe mundësive që ata t'u eksponohen ndikimeve dhe kontakteve të dëmshme, sidomos përmes shfrytëzimit joadekuat të rrjeteve sociale, të cilat sipas definicionit iu dedikohen shfrytëzuesve më të rritur. Për shembull, Fejsbuk është i ndaluar që të përdoret për persona më të rinj se 13 vjeç. Përveç se prej tyre vetë, të dhënat për fëmijët mund të jenë të publikuara nga prindërit/tutorët e tyre, me qëllim ose pa qëllim. Për shembull, përmes publikimit të fotografive të ‘geotaguara’ nga fëmijët e tyre, prindi pa dashje mund të zbulojë se ku jetojnë ata, ku mësojnë ose ku qëndrojnë gjatë ditës, duke e rritur kështu rrezikun për ta.

129 Teoricienë të caktuar e përdorin termin „indigjenë digjital“ (ang. digital natives), si pjesë e konceptit sipas të cilit fëmijët që janë rritur me teknologji digjitale, si për shembull, kompjuter shtëpiak ose telefon mobil, e perceptojnë botën ndryshe nga paraardhësit e tyre, të cilët për herë të parë kanë ardhur në kontakt me TIK në moshë më të vjetër.

Mundësia më efektive për përfshirjen e temave nga kjo sferë në kuadër të sistemit arsimor shtetëror është tejkalimi i perceptimit se fjala është për tema “teknologjike”, për shkak se ashtu kufizohen në mësimin fakultativ në kuadër të orëve nga informatika. Nevojitet përfshirja në planet mësimore dhe edukimi plotësues i pedagogëve, psikologëve dhe i kuadrit arsimor nga të gjitha lëndët, sidomos atyre të lidhura me zhvillimin e shkathtësive dhe diturive jetësore për sistemin shoqëror.

Burim tipik i resurseve që iu drejtohet të tri grupeve të targetuara është ueb-faqja www.bezbednonainternet.org.mk, zhvilluar nga fondacioni *Metamorfozis*, përmes një varg projektesh, në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me rrjetin e organizatave civile të specializuara për të drejtat e fëmijëve. Krahas udhëzimeve dhe lajmeve, kjo ueb-faqje ka edhe përmbajtje multimediale, si filma dhe lojëra edukative në më shumë gjuhë që fliten në Maqedoni, për shkak se për qasje efektive të fëmijët në shumë raste patjetër të aplikohet gjuha e tyre amtare.

Një tjetër aspekt i mbrojtjes së fëmijëve në sferën digjitale është nevoja për më shumë aktivitete të institucioneve shtetërore, mos/shfrytëzimi për të marrë mjete shtesë nga fondet që i ofrojnë BE si pjesë e Agjendës Digjitale për Evropë.¹³⁰ Mediat mund të kenë rol pozitiv shtesë në nxitjen e pushteteve që t’i mbështesin përpjekjet e këtilla përmes ndjekjeve të proceseve të plotësimit të obligimeve të ndërmarra dhe mobilizimit dhe harxhimit të mjeteve nga kjo sferë.

Prioritete në lidhje me bashkëpunimin midis OC që punojnë në këtë sferë dhe mediave

• Pengimi i gjuhës së urrejtjes në sferën digjitale

Përhapja e gjuhës së urrejtjes përmes Internetit direkt është e lidhur me polarizimin etnik dhe partiak të shoqërisë maqedonase. Mediat dhe OC që punojnë në drejtim të mbijetesës së mjedisit multi-etnik dhe multikulturor në Maqedoni mund ta shfrytëzojnë luftën e përbashkët kundër gjuhës së urrejtjes si pikë fillestare për zhvillimin e iniciativave të tjera që kontribuojnë për kohezionin shoqëror. Nga ana tjetër, ato duhet t’u bëjnë presion institucioneve që të reagojnë dhe ta sanksionojnë përhapjen e gjuhës së urrejtjes përmes mediave digjitale.

• Zhvillimi i vazhdueshëm i profesionistëve mediatik dhe civil për sferën digjitale

Arsimimi digjital duhet të bëhet fushë interesi edhe për OC edhe për mediat, pa marrë parasysh se ato tashmë janë të specializuara për mbulimin e sferave dhe çështjeve të tjera. Kjo është e domosdoshme në kushtet e sotme kur teknologjitë digjitale aplikohen dhe ndikojnë në të gjitha sferat shoqërore. Në të ardhmen ky ndikim edhe më do të rritet. Prandaj, të gjitha palët e interesuara duhet të pranojnë se është i domosdoshëm mësimi i vazhdueshëm, përkatësisht zgjerimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe diturive të tyre në sferën digjitale.

¹³⁰ <http://ec.europa.eu/digital-agenda/en/creating-better-internet-kids>

Organizatave civile duhet që në mënyrë më intensive dhe më efektive t'i shfrytëzojnë internet-mediat dhe mediat sociale që të depërtojnë te mediat dhe qytetarët dhe të stërviten për të bërë kreacione të përmbajtjeve multimediale për transmetimin sa më efektiv të porositave.

Nga ana tjetër, gazetarët duhet që në mënyrë intensive t'i shfrytëzojnë teknologjitë e reja digjitale në punën e tyre, qoftë për kërkimin e të dhënave, qoftë për të bërë kreacionin e produkteve mediatike multimediale. Shembull për përdorimin e të dhënave me qasje përmes internetit është e ashtuquajtura *Data driven journalism*, emër që ky u bë i popullarizuar në vitet 2009/2010 dhe ka të bëjë me procesin gazetaresk me bazë në analizë dhe filtrimin e bazave të mëdha të të dhënave (ang. Open data), me qëllim krijimin e tregimit gazetaresk.

• **Vënia e bashkëpunimit midis organizatave civile dhe mediave**

Çdo vit në shkurt, si pjesë e lëvizjes panevropiane, shënohet “Dita e internetit më të sigurt”, ku marrin pjesë edhe më shumë aktorë shoqërorë nga sektori joqeveritar, shtetëror dhe afarist të ne.¹³¹ Sikurse edhe në ditët tjera të ngjashme ndërkombëtare, kjo ditë bëhet shkas për organizimin e ngjarjeve dhe promovimeve mediatike, por mediat kanë mundësi dhe obligim që ato tema t'i trajtojnë edhe pa ndonjë shkas ose nxitje-PR të veçantë. Krahas gazetarisë hulumtuese, në të kaluarën ka pasur shembuj të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë midis OC dhe mediave të caktuara në drejtim të rritjes së shikimit të informacioneve që lidhen me të drejtat e fëmijëve në internet. Kështu, *Metamorfozis* në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2011 bashkëpunonte me gazetën “Vreme” dhe “Nova Makedonija” (përkatësisht, me shtojcën javore për fëmijë “Kolibri”), me ç'rast njëra palë kontribuonte me përmbajtje edukative, ndërsa tjetra duke lënë në dispozicion hapësirë falas. Hapi i parë për krijimin e partneriteteve të këtilla shpeshherë është vetëm dërgimi i ofertës për bashkëpunim nga ana e OC tek mediat.

131 Ueb-faqja e “Dita e internetit më të sigurt”. Arritur përmes: <http://www.saferinternet.org/safer-internet-day>

3

KAPITULLI

REKOMANDIME PËR PËRPARIMIN E BASHKËPUNIMIT MIDIS ORGANIZATAVE CIVILE DHE MEDIAVE

III. 1. REKOMANDIME PËR ORGANIZATAT CIVILE

- **Stërvitje për organizatat civile në komunikimin e tyre me mediat dhe publikun.**

OC duhet të kenë persona kompetentë, të cilët do të merren me komunikimin me mediat. Prandaj, nevojitet që të ofrohen stërvitje të ndryshme për OC, prej stërvitjeve “in-house” (brenda në organizatë), të cilat do t’i adresojnë nevojat konkrete të OC, por edhe stërvitje të tjera, të cilat OC mund t’i vizitojnë dhe të marrin bazat nga sfera e komunikimit me mediat dhe publikun. Më shumë hulumtime kanë treguar se OC nuk i shfrytëzojnë mediat e reja dhe sociale për shtrirjen e porosive të tyre dhe për komunikim me publikun. Problem shtesë është edhe ajo që më shumë OC nuk i “aktivizojnë” kapacitetet e të punësuarve të tyre, të cilët më parë veç janë stërvitur për komunikim me mediat, por as i transmetojnë njohuritë të të punësuarit e tyre në kuadër të vetë organizatës.

Prandaj, nevojitet që të ofrohen stërvitje për përfaqësuesit nga OC për profesionalizimin dhe përmirësimin e njohurive që lidhen me shkrimin e komunikatave për media, organizimin e konferencave të shtypit, krijimin e strategjive komunikuese ose prezantimin e aktiviteteve të veta, duke shfrytëzuar teknikat multimediale, mediat e reja dhe sociale.

Organizatrat civile duhet të mësohen ndonjëherë të përdorin edhe të ashtuquajturin “komunikim të dhunshëm”, përkatësisht në vend të konstatimit të gjendjeve dhe shpjegimit të aktiviteteve dhe të rezultateve, në situatat kur nevojitet mobilizimi nga ana e të gjithë aktorëve shoqërorë, ato duhet të jenë të zëshme, të sugjerojnë dhe të imponojnë zgjidhje. Ky lloj komunikimi shpeshherë është shumë tërheqës për mediat.

- **OC duhet ta njohin logjikën e punës me gazetarë.** Përfaqësuesit nga OC duhet të kuptojnë se si funksionojnë mediat dhe si bëhen lajmet. Mediat në të shumtën e rasteve kërkojnë informata dhe tema atraktive, të cilat kanë vlerë gazetareske dhe janë me interes më të gjerë publik. Gazetarët janë të interesuar për tregime të njerëzve, për personat që do ta rrëfejnë tregimin, raste konkrete gjatë të cilave janë shkelur të drejtat e njeriut, më shumë sesa statistika dhe analiza të cilat rëndom vijnë nga organizatat civile. Edhe pse duhet të merret parasysh edhe paralajmërimi i OC se kjo qasje bart rrezikun e zbulimit të identitetit të personave, të drejtat e të cilëve i mbrojnë, megjithatë, ato në bashkëpunim me mediat dhe me bashkëbiseduesit duhet të gjejnë mënyrën që t’i prezantojnë tregimet duke iu përmbajtur parimeve profesionale dhe etike. OC duhet t’ua shpjegojnë njerëzve të drejtat e të cilëve i prezantojnë se tregimi i tyre mund t’u ndihmojë shumë vetave që kanë probleme të ngjashme, e pastaj ta vënë kontaktin midis gazetarëve dhe “të mbrojturve”. Nga ana tjetër, ndërkaq, gazetarët duhet të garantojnë mbrojtjen e privatësisë të bashkëbiseduesve në tregimet që kanë karakter sensitiv.

Momenti tjetër që duhet ta kenë në mendje OC-të është të merret parasysh fakti se gazetarët dhe redaktorët gjithashtu të kujdesen që informata ose tema të mos kundërshtohet me politikën redaktuese, por edhe me interesat e pronarëve të mediave, qofshin ato të jenë politike ose ekonomike. Mu për këtë OC jo vetëm që duhet të mësojnë sesi prodhohen, sesi selektohen dhe sesi strukturohen lajmet, por ato në momente të

caktuara duhet ta dinë se cili tregim në cilën media mund të plasohet, që përfshin edhe njohjen e publikut të medias. Përgjithësisht ato duhet të dinë ose duhet të supozojnë se si i kupton publiku çështjet e caktuara që lidhen me të drejtat e njeriut.

Një kuptim më i madh për atë se si punojnë gazetarët dhe, në pajtim me këtë, se si duhet të përshtatet puna e vetë OC, mund të arrihet përmes stërvitjeve, inicimit të takimeve të përbashkëta, punëtorive, tribunave, përfshirjen e gazetarëve në stërvitjet që vetë OC i organizojnë, si dhe me kontaktet personale ose direkte midis përfaqësuesve të mediave dhe OC.

• **Përfaqësuesit e OC si aktivistë në terren.** Të punësuarit në OC nuk duhet të jenë vetëm profesionistë të OJQ, por ata duhet të jenë aktivistë civil në terren. Aktivitetet në terren shpeshherë janë vegël më efikase për tërheqjen e vëmendjes mediatike sesa vetëm dërgimi i komunikatave të thata për realizimin e aktiviteteve. Nevojitet më shumë iniciativë dhe kreativitet nga ana e OC që të tërhiqet vëmendja e mediave dhe e publikut. Vetëm si shembull do ta theksojmë një pjesë nga përvoja e OC që tregon se mediat në të shumtën e rasteve janë të pranishme kur ka persona zyrtarë ose të njohur në një ngjarje (politikanë, njerëz të estradës), të cilët mund të flasin për problemet ose të iniciojnë aksione. Kjo është vetëm njëra prej mënyrave përmes të cilave OC e promovojnë edhe punën e tyre, por edhe grupet e synuara dhe personat, të drejtat e të cilëve janë rrezikuar ose shkelur.

Aktivitetet në terren jo gjithnjë kërkojnë mjete të mëdha financiare ose profesionalizëm të madh për t'i realizuar, sidomos duke marrë parasysh faktin se persona të njohur rëndom duan të marrin pjesë në ngjarje që kanë qëllime fisnike. Përfaqësuesit e vetë OC që janë të stërvitur për të shfrytëzuar teknikat multimediale, mund ta iniciojnë ngjarjen dhe materialet audio dhe video thjesht t'i vënë në ueb-faqen e organizatës, por edhe t'i shpërndajnë përmes rrjeteve sociale.

• **Imponimi i temave që lidhen me të drejtat e njeriut.** Nevojitet më shumë iniciativë dhe angazhim nga ana e OC në drejtim të asaj që të hapin tema të ndjeshme, të cilat janë margjina të agjendës mediatike dhe për të cilat ka shumë pak informacione dhe njohje nga ana e qytetarëve. Por, OC vazhdimisht duhet të jenë “të zgjuara” dhe të zbulojnë e të tregojnë rastet kur thyhen të drejtat e njeriut. I tillë ishte shembulli me kthimin e romëve nga pikat kufitare, me arsyetimin se ata i përgjigjen profilin të azilantit potencial.

OC duhet të reagojnë menjëherë në rastet kur ka dukuri të shkeljes së të drejtave të njeriut, diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, dhunës nga urrejtja dhe çrregullimeve të tjera të dinjitetit njerëzor. Këto dukuri nuk duhet të ruhen për nevojat e raporteve vjetore ose për press-konferencat “sezonale” të planifikuara. Statistikat për raportet periodike janë një, ndërsa dëftimi dhe reagimi i vazhdueshëm janë diçka tjetër. Ato vazhdimisht duhet ta mbajnë gjallë vëmendjen e mediave dhe të publikut. Nuk duhet të priten shkasat, siç janë, për shembull, festimet e ditës së gruas 8 Marsi, ose Dita botërore e luftës kundër HIV/Sida – 1 Dhjetori. Vazhdimisht duhet të reagojnë OC dhe t'i promovojnë aktivitetet e tyre gjatë tërë vitit.

• **Alarmimi në raste diskriminimi dhe të gjuhës së urrejtjes.** Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, si fenomene gjithnjë e më të pranishme në shoqërinë maqedonase, transmetohen përmes mediave tradicionale, onlajn dhe sociale. Si bartës paraqiten edhe politikanët, por edhe vetë mediat – në disa raste si transmetues të mesazheve pa kurrfarë distancimi profesional, e në disa raste të tjera gazetarët e tyre drejtpërdrejt e përdorin gjuhën e urrejtjes.

Nevojitet të vihet mekanizmi për alarmim dhe reagim në nivel sektori – midis organizatave civile dhe mediave. Gjatë çdo rasti të vërejtur të diskriminimit ose të gjuhës së urrejtjes, të transmetuar përmes mediave, prej cilitdo qoftë burim, OC menjëherë duhet t'i alarmojnë shoqatat dhe institucionet mediatike. Shoqatat mediatike, ndërkaq, duhet t'i aktivizojnë mekanizmat ekzistues të vetërregullacionit (për shembull, Gjyqi i nderit në kuadër të SHGM), me ç'rast do të dënohet gjuha e këtillë.

• **Krijimi i koalicioneve të gjera të organizatave civile.** Bashkimi i organizatave civile në fronte më të gjera civile shpeshherë është mënyra më efikase për të bërë lobimin, përfaqësimin për ndonjë qëllim të përbashkët ose për krijimin e presionit ndaj institucioneve, sesa paraqitja e mëvetësishme e OC që punojnë në një sferë. Të tilla janë, për shembull, koalicioni i organizatave rinore “Sega”, koalicioni “Të drejta seksuale dhe shëndetësore për bashkësitë e marginalizuara”, pastaj koalicionet joformale, siç janë, për shembull, veprimi i përbashkët i SHGM, MIM, MDC dhe Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe të Punonjësve të Mediave në lidhje me rregullativën e re mediatike etj.

Në rastet kur për një qëllim ose iniciativë të caktuar organizohen koalicione, është e pëlqyeshme që ato të kenë strategji të përbashkët për bashkëpunim me mediat, pa i harruar aktivitetet që lidhen me praninë mediatike dhe të çdo organizate veç e veç. Në këtë mënyrë më lehtë tërhiqet vëmendja edhe e mediave, edhe e publikut dhe imponohet tema. Plus kësaj, fronti më i gjerë civil mund të ndikojë në mënyrë efikase edhe ndaj kreatorëve të politikave.

• **Të drejtat e njeriut si përmbajtje në arsim.** Vetëdija e ulët për të drejtat e njeriut në opinion mes faktorëve të tjerë është pasojë edhe e mungesës së përmbajtjeve që lidhen me sferën në kuadër të arsimit formal. Disa organizata civile, si për shembull Qendra memoriale „Nikolla Klusev“ ose Multikultura nga Tetova organizojnë stërvitje për nxënës dhe arsimtarë, me fokus të drejtat e njeriut. Megjithatë, ajo që theksohet është se nxënësit duhet të njihen me të drejtat e njeriut dhe me mekanizmat për mbrojtjen e tyre që në moshë të re, në kuadër të arsimit formal, ndërsa përmbajtjet të jenë më gjithëpërfshirëse.

Organizatave civile duhet të bëjnë lobim në institucione për zgjerimin e përmbajtjeve mësimore për të drejtat e njeriut. Ky është njëri prej atyre objektivave që hyn tek objektivat afatgjatë dhe për të cilët nevojitet përkushtim, qasje dhe vazhdimësi serioze, pa iu shmangur, shkaku i vështirësive, realizimit të tyre. Ajo që gjithashtu nuk guxon të përjashtohet si alternativë është bashkëpunimi i OC me shkollat në nivel të komunave, edhe atë për përmbajtjen që i takojnë pjesës së arsimit joformal ose si mësim shtues, edhe për

arsimtarët edhe për nxënësit. Koncepti për një zgjidhje të këtillë alternative për shtimin e njohurive për të drejtat e njeriut për nxënësit, duhet të zhvillohet në mënyrë kreative dhe interesante, me qëllim që të tërhiqet vëmendja e nxënësve, të cilët ashtu-ashtu janë “të stërngarkuar” me aktivitete plotësuese.

- **Forcimi i identitetit dhe rritja e shikueshmërisë së organizatave civile.** Në pamje të parë duket që ky rekomandim nuk ka lidhje direkte me mediat, mirëpo kjo ndodh kështu vetëm në pamje të parë. Puna e vazhdueshme e profilizimit të organizatave civile në organizata me nivel të lartë profesional, të gjithëpranishme dhe me kredibilitet në fushën e të drejtave të njeriut, do t’i bëjë ato “partner” atraktiv për mediat. Është ky një shans i madh për t’i promovuar të gjitha aktivitetet dhe reagimet e atyre organizatave në hapësirën mediatike dhe publike.

Disa prej mënyrave përmes të cilave organizatat civile mund ta ndërtojnë “imazhin” e tyre dhe të imponohen si faktor me kredibilitet janë aktivitetet e shpeshtuara dhe demonstrimi i ekspertizës së tyre, promovimi i informatave rreth asaj se sa i kontribuojnë bashkësisë dhe eksponimit më të madh të partnerëve të tyre. Për këtë gjë iu duhet ndihmë e madhe edhe nga mediat, të cilat do të duhet “ta njohin” shoqërinë civile si partner relevant dhe konstruktiv. Përkundër kësaj, ka ndodhur dhe ende ka situata kur mediat promovojnë stereotipe negative për OC dhe e nënçmojnë rolin e tyre si partner në proceset shoqërore.

- **Përdorimi i teknologjive dhe mediave të reja digjitale** në mbrojtje të promovimit të të drejtave të njeriut. Që t’u iket “kurtheve” të polarizimit politik dhe etnik në hapësirën mediatike, organizatave civile iu mbetet edhe alternativa e shfrytëzimit të hapësirës onlajn për promovimin e tyre. Është me shumë rëndësi që të pranohet fakti që arsimimi digjital përfshin edhe vetëdijen e asaj se si teknologjitë e reja ndikojnë në jetën individuale të qytetarit, si mund t’i përparojnë ose t’i rrezikojnë të drejtat e tij themelore të njeriut, por edhe si mund t’i mundësojnë pjesëmarrjet direkte në proceset shoqërore që ndikojnë në jetën e tij dhe të bashkësisë së tij.

OC dhe anëtarët dhe aktivistët e tyre duhet ta tejkalojnë mungesën eventuale të komoditetit (teknofobinë) ose rezistencën ndaj çështjeve që lidhen me sferën digjitale, që e kanë për shkak të paragjyqimit se për të duhet njohje ekspertësh nga sfera e informatikës. Vazhdimisht duhet pasur parasysh se mediat e reja e ndihmojnë afirmimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe prandaj duhet që në mënyrë intensive të shfrytëzohen. Për këtë shkak emancipimi digjital dhe “sundimi” me teknologjitë duhet të bëhen pjesë përbërëse e punës së organizatave civile. Prandaj OC-ve iu nevojitet që të jenë në rrjedhë me teknologjitë dhe mundësitë e reja që ato i mundësojnë dhe vazhdimisht të stërviten në këtë sferë.

III. 2. REKOMANDIME PËR MEDIAT

• **Stërvitje për gazetarët.** Redaksitë në të shumtën e rasteve nuk kanë gazetarë të specializuar, të cilët e ndjekin vetëm sektorin civil, edhe më pak-të tillë që merren me sferën e të drejtave të njeriut. Rotacioni i gazetarëve nëpër rubrika dhe migrimi i tyre në media të ndryshme është dukuri e shpeshtë, për të cilën gjë paraqitet nevoja e edukimit të vazhdueshëm të gazetarëve të rinj nga sfera komplekse e të drejtave të njeriut. Duhet të ngrihet niveli i vetëdijes në mesin e vetë gazetarëve për rëndësinë e temave që lidhen me të drejtat e njeriut, të përmirësohet dituria dhe mirëkuptimi për këtë sferë. Gazetarëve duhet t'u ndihmohet që më lehtë t'i njohin dhe t'i identifikojnë rastet me shkeljet e të drejtave të njeriut, por dhe ta paraqesin tregimin në mënyrë etike dhe profesionale, duke i ikur me këtë rast shkeljes plotësuese të të drejtave të njeriut (zbulimit të identitetit, shkeljes së rregullës së prezumimit të pafajësisë etj.) Gazetarët duhet të kenë parasysh edhe atë se edhe pse aspekti i të drejtave të njeriut nuk është udhëheqës, ai shpeshherë është element i pamungueshëm në tregim.

Mediat duhet të bëjnë më shumë kujdes në stërvitjen e mëtejshme të gazetarëve në sferën e të drejtave të njeriut, pa marrë parasysh se a do të jetë stërvitja brenda (transferimi i njohurive nga kolegët më të vjetër te më të rinjtë, stërvitjet “in-house”) ose jashtë redaksive, nga ana e ekspertëve të kësaj sfere. Nevojitet që të ofrohen stërvitje për gazetarë fillestarë dhe për gazetarë në mesin e karrierës së tyre për përmirësimin e njohurive të tyre në lidhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni vendor, me punën e sektorit civil, prioritetet dhe problemet në sferë të ndryshme të të drejtave të njeriut, terminologjinë adekuate etj. Megjithatë, stërvitjet duhet të përfshijnë edhe përfaqësues nga sektori civil, të cilët do ta arsyetojnë natyrën dhe mënyrën e punës së tyre, ose do t'u ofrojnë tregime të cilat gazetarët rrallë i çelin, e që kanë rëndësi të madhe për bashkësinë. Stërvitjet e këtilla të gazetarëve do t'u ndihmojnë atyre që ta identifikojnë dhe ta integrojnë aspektin e të drejtave të njeriut në tregimet e tyre.

• **Shmangia e diskriminimit dhe e gjuhës së urrejtjes.** Në mediat shpeshherë vërehet, me vetëdije ose pa vetëdije, transmetimi i porosive diskriminuese ose me stereotipi kur raportohet për çështje që lidhen me bashkësitë etnike, me grupe të marginalizuara ose të lëndueshme qytetarësh. Gjuha e urrejtjes bëhet problem në rritje në shoqëri si e mediave tradicionale, ashtu edhe të reja. Kur raportohet për tema me karakter multi-etnik ose multireligjioz, hulumtuesit u rekomandojnë gazetarëve që të kenë distancë kritike, vazhdimisht të jenë skeptik, të mos lejojnë që të manipulohen nga asnjëra anë dhe me kujdes ta kontrollojnë çdo informatë. Roli shoqëror i gazetarit, përveç informimit, përfshin edhe promovimin e dialogut, mirëkuptimit dhe tolerancës.¹³²

Përmes stërvitjeve, punëtorive dhe tribunave kushtuar gazetarëve, ku do të përfshihen edhe përfaqësues të organizatave civile, duhet të adresohen trendet e dukurisë gjithnjë e më frekuentuese të diskriminimit dhe të gjuhës së urrejtjes në mediat dhe në

132 SHLGMP (2012) Çrregullim i standardeve profesionale në informimin gazetaresk për incidentet me dhunë. Shkup: SHLGMP. Arritur përmes: http://www.unescochair-vs.edu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=98&Itemid=38&lang=mk

përgjithësi në shoqëri. Këto dukuri duhet të jenë edhe tema për debate ose tekste në media. Mekanizmat vetërregullator, në kuadër të vetë mediave ose në kuadër të profesionit, duhet të aktivizohen kur do të vërehen përmbajtje që përfshijnë diskriminim ose gjuhën e urrejtjes mbi çfarëdo lloj baze. Respektimi i Kodit të etikës duhet të paraqes imperativin për çdo gazetar, pa marrë parasysh polarizimin politik ose etnik të bashkësisë mediatike.

- **Gazetari hulumtuese.** Sfera e gjerë e të drejtave të njeriut ka plot ide dhe tema, të cilat janë të përshtatshme për punën hulumtuese të gazetarëve. Stërvitjet e specializuara dhe komunikimi i vazhdueshëm me organizatat civile mund t'u ndihmojë shumë gazetarëve në zbulimin e tregimeve, njohjen dhe identifikimin e rasteve ku ka pasur thyerje të të drejtave të njeriut, si dhe qasjen në dokumente dhe burime.

Stërvitje për gazetari hulumtuese, me fokus të drejtat e njeriut, me ç'rast do të përfshihen edhe përfaqësues të organizatave civile të cilat do të paraqisnin shembuj dhe raste karakteristike, të cilat do t'u ndihmojnë gazetarëve që më lehtë t'i identifikojnë temat dhe do t'u shtojnë teknika dhe aspekte të reja tregimeve të tyre.

- **Më shumë hapësirë mediatike për të drejtat e njeriut.** Mediat duhet të lënë më shumë hapësirë për tema dhe emisione që lidhen me të drejtat e njeriut. Me këtë rast mediat duhet ta kenë parasysh se ato, në pjesën më të madhe, marrin pjesë në formimin dhe ngritjen e vetëdijes publike për çështje të ndryshme, në mesin e të cilave edhe për këtë sferë. Prandaj, përmbajtjet mediatike duhet të informojnë dhe arsimojnë, duhet t'i tregojnë shkeljet e të drejtave të njeriut, por edhe shembujt afirmativ, përkatësisht se si njerëzit nga grupe të ndryshme të marginalizuara i kontribuojnë shoqërisë. Ato përmbajtje nuk duhet të zhvendosen në margjinat e programeve, për shkak se ashtu arrijnë vetëm te një numër i kufizuar i publikut.

Mediat dhe gazetarët mund të kontribuojnë për rritjen e vetëdijes publike dhe mbrojtjen efikase të të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve shtetërore përmes emisioneve tematike për çështje që lidhen me aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut; raportimit të thelluar dhe të plotë, në vend të transmetimit bartës të komunikatave dhe të numrave të thatë; përmes gjetjes së aspekteve specifike të tregimeve që lidhen me të drejtat e njeriut; zbulimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut, me të cilën gjë fokusohet vëmendja e grupeve të caktuara të lëndueshme.

- **Gazetari inkluzive.** Qëllimi i gazetarisë inkluzive është që më mirë të kuptohen bashkësitë, kulturat, identitetet, qëndrimet politike dhe shoqërore të tjera në shoqëritë ku jetojnë. Mediat mund të japin kontribut të dukshëm në artikullimin e zërave të qytetarëve të ndryshëm, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, racore dhe religjioze, aftësinë fizike ose mentale, statusin social, moshën ose gjininë. Kjo arrihet përmes gazetarisë së përgjegjshme, të cilën Instituti për Llojlojshmëri Mediatike nga Londra e definon si “fer, të saktë, të balancuar, sensitive dhe inkluzive”. Inkluziviteti nënkupton se “mediat përfshijnë zëra të ndryshëm në cilindo qoftë debat për çështje që janë të rëndësishme për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë”.¹³³ Më thjeshtë thënë, gazetaria inkluzive nënkupton kyçje

133 Media Diversity Institute (2009) Inclusive Media for Inclusive Societies. Arritur përmes: <http://www.euromedalex.org/sites/default/files/MDI%20%20Brochure%20Inclusive%20Journalism.pdf>

dhe pasqyrim të dallimeve në mënyra të ndryshme – jo vetëm në kornizë të një tregimi gazetaresk, por dhe në përbërjen e vet redaksisë, në çdo prodhim gazetaresk dhe në funksionimin e përditshëm të medias.

Gazetaria maqedonase ende duhet të zhvillohet në këtë drejtim. Edhe në pjesën e arsimimit të gazetarëve në Maqedoni, gazetaria inkluzive ende nuk është e pranishme në nivel të mjaftueshëm. Vetëm disa prej institucioneve ekzistuese të arsimit të lartë për gazetari, media ose komunikime (siç është Shkolla e Lartë për Gazetari dhe për Marrëdhënie me Publikun) e përpunojnë këtë temë si lëndë të veçantë. Kështu, gazetaria inkluzive duhet të jetë kombinim i praktikës dhe moduleve teorike me të cilat zhvillohet dituria e studentit dhe të kuptuarit kritik të proceseve të qeverisjes dhe të arritjes së njohurive për dallimet kulturore, çështjet kyç në komunikimet interkulturore dhe aspekte të ndryshme të sociologjisë së lajmeve.

Në një shoqëri multietnike dhe multireligjioze, siç është kjo e jona, dallimet duhet të gjejnë pasqyrim në programet dhe në përmbajtjet e produkteve mediatike. Kjo mund të arrihet në mënyra të ndryshme, si për shembull: duke ndjekur vazhdimisht përfaqësuesit e bashkësive të marginalizuara ose përfaqësuesi të tyre nga OC dhe përfshirjen e tyre në përmbajtjet mediatike, përmes reflektimit të grupeve dhe pikëpamjeve të ndryshme në përmbajtjet e produkteve mediatike, përmes mundësive për të përkthyer programet nga gjuhë të ndryshme që fliten në shtet, përmes përmbajtjeve që promovojnë kohezion social, nëpërmjet përbërjes së redaksisë etj.

Për punonjësit mediatik, përfshi këtu gazetarët dhe redaktorët, kameramanët dhe producentët, vazhdimisht duhet të organizohen stërvitje për raportim për dallimet, sesi të tejkalohen stereotipat e rrënjosur ndaj grupeve të ndryshme, sesi duhet shfrytëzuar gjuha dhe fotografia korrekte etj.

Në mësimin për studentët nga gazetaria duhet të përfshihen module praktike, të orientuara, të cilat do t'u mundësojnë një bazë gjithëpërfshirëse konceptuale dhe teorike, si dhe arritjen e tyre përmes shkathtësive praktike. Në këtë mënyrë, si gazetarë të ardhshëm do të dinë se çfarë do të thotë raportim mediatik për diversitetet.

• **Arsimimi digjital.** Arsimimi digjital patjetër të bëhet fushë interesi e mediave përgjithësisht, por edhe e gazetarëve veç e veç, pa dallim se ata tashmë janë të specializuar për mbulimin e sferave dhe çështjeve të tjera në shtyp, në TV ose në radio. Konvergjenca e mediave i detyron edhe vetë shtëpitë mediatike që të fillojnë ta ndryshojnë teknologjinë e punës dhe të zgjerohen përmes platformave të ndryshme. Për shkak të zhvillimit të shpejtë të teknologjive digjitale që aplikohen dhe ndikojnë ndaj të gjitha sferave shoqërore, kjo bëhet domosdoshmëri profesionale për gazetarët, prej të cilëve gjithnjë e më shpesh (do të) kërkohet që të prodhojnë përmbajtje multimediale (tekst, audio/video, fotografi, shkrime për ueb etj.)

Puna e vazhdueshme në ngritjen e shkathtësive duhet të jetë parakusht edhe për punonjësit mediatikë. Në këtë kuptim, ngritja e nivelit profesional të gazetarëve në sferën komplekse të teknologjisë digjitale është e domosdoshme për ngritjen e mëtejshme

të kapaciteteve dhe diturive të tyre, të cilat duhet t'u përgjigjen kërkesave të reja të industrisë mediatike. Gazetarët e "kohës së re" duhet të jenë të gatshëm që të përgjigjen edhe ndaj shprehive të reja të publikut, i cili gjithnjë e më shumë shkon edhe në Internet.

III. 3. REKOMANDIME PËR BASHKËPUNIM MIDIS OC DHE MEDIAVE

- **Fushata për ngritjen e vetëdijes publike.** OC vazhdimisht duhet të jenë të prashme në publik jo vetëm përmes reagimeve, komunikatave, informatorëve, por ato duhet të iniciojnë fushata për ngritjen e vetëdijes publike, të bëjnë kreacionin e ngjarjeve, të iniciojnë programe edukative për qytetarët për njohjen me të drejtat e tyre.

OC dhe mediat bashkë duhet të reagojnë, të bëjnë lobim dhe presion tek institucionet për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

- **Mekanizmat për alarmim të ndërsjellë kur thyhen të drejtat e njeriut.** OC dhe mediat duhet të punojnë në zhvillimin e mekanizmave për alarmim kur do të vërehet rasti i thyerjes së të drejtave të njeriut. OC vazhdimisht duhet të jenë "të zgjuara" dhe të reagojnë tek mediat gjatë shfrytëzimit të fjalorit joadekuat (gjuhë e urrejtjes, diskriminim, stereotipi, fjalor të pahijshëm ...), të paralajmërojnë, të hapin rast, ose t'i dëftojnë disa prej këtyre trendeve brengosëse.

Për këtë qëllim, OC duhet të jenë në bashkëpunim me trupat vetërregullator në nivel redaksish (nëse i kanë) ose me Gjyqin e nderit në kuadër të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, për të dëftuar lëshimet ose joprofesionalizmin e disa mediave ose gazetarëve.

- **Përfshirja e publikut të ekspertëve në hapësirën mediatike.** Njëra prej pikave të lidhjes dhe të komunikimit midis sektorit civil dhe mediave janë pikërisht mendimet e ekspertëve, të cilat gazetarët i kërkojnë nga organizatat civile. Megjithatë, duhet vërejtur se gazetarët shpeshherë konsultojnë ekspertë për të cilët prej më parë e dinë se do ta mbështesin tezën e tyre, pa përfshirë në raportet e tyre mendime të ndryshme, kundërshtuese, me të cilën gjë në të vërtetë nuk promovohet pluralizmi i ideve dhe pikëpamjeve. Gazetarët, ndërkaq, vërejnë se shpeshherë përfaqësuesit e OC nuk janë mjaft të arritshëm, nuk duan të flasin për tema të caktuara, ose, ndërkaq, në rastin më të keq-aspak nuk duan të japin deklaratë për media të caktuara.

OC duhet t'i promovojnë ekspertët e tyre, të cilët janë burimi relevant i informatave, mendimeve dhe ekspertizave, por edhe t'ua lehtësojnë mediave kontaktin me ta, duke i promovuar në ueb-faqet e organizatave, përmes rekomandimit të tyre si bashkëbisedues e të ngjashme. Kështu e ndërtojnë imazhin e tyre të organizatës me kredibilitet, e cila mund të ndikojë në institucionet dhe proceset.

- **Debat. Debat. Debat.** Mediat dhe OC bashkë duhet të nxisin dhe të iniciojnë debat të vazhdueshëm për gjendjen me të drejtat e njeriut në shtet. Mediat duhet t'i kthejnë emisionet e veta debative në programet e tyre dhe t'u japin mundësi përfaqësueseve nga grupe të ndryshme në shoqëri që t'i artikulojnë mendimet e tyre.

Debati duhet të jetë inkluziv, duke iu mundësuar zërave të ndryshëm të marginalizuar të vijnë në shprehje dhe duke promovuar pluralizmin e mendimeve për vlerat demokratike. Në këtë mënyrë, edhe publikut do t'i mundësohet qasja në pikëpamje të ndryshme dhe më mirë të informohet për të drejtat civile dhe për mekanizmat e mbrojtjes së tyre.

• **Stërvitje të përbashkëta sipas parimit “mësim i përvetshëm”.** Përparimi i të drejtave të njeriut, por edhe i teknologjive të reja si platformë e afirmimit të tyre, janë vetëm një pjesë e temave që mund të jenë pikëtakimi kur fjala është për organizimin e stërvitjeve të përbashkëta, të iniciuara edhe nga OC, edhe nga mediat.

Stërvitjet për gazetari të cilat si temë do të përfshinin edhe të drejtat e njeriut, do të kishin mundur të “forcoheshin” edhe me praninë e aktivistëve civil që punojnë në këtë sferë dhe që mund të ofrojnë studime të rastit, shembuj, ekspertiza dhe informata të tjera të ndryshme. Nga ana tjetër, ndërkaq, stërvitjet për organizatat civile mund të përfshijnë edhe përfaqësues nga mediat, të cilët do t'i kishin shpjeguar proceset e krijimit të lajmeve dhe logjikën e funksionimit të mediave.

OC dhe mediat mund të formojnë edhe “koalicion” ose rrjete komunikative (onlajn) për informim të ndërsjellë, por dhe për të iniciuar stërvitje për dukuri dhe trende aktuale në zhvillimin e të drejtave të njeriut dhe të formave të mbrojtjes së tyre. Kështu, për shembull, kur flitet për stërvitje të përbashkëta në sferë të specializuara, siç janë të drejtat digjitale dhe teknologjitë e reja, ka potencial për bashkëpunim midis mediave dhe OC që merren me këtë sferë.

1

ANEKS

GJETJE KYÇ

**NGA HULUMTIMI KUALITATIV I QËNDRIMEVE DHE PERCEPTIMEVE
TË PËRFAQËSUESVE NGA ORGANIZATAT CIVILE DHE MEDIAT PËR
BASHKËPUNIMIN NË SFERËN E TË DREJTAVE TË NJERIUT**

1. Shkurtimisht për hulumtimin

Në periudhën prej 8 shkurt deri në 10 mars të vitit 2013 MIM realizoi 29 intervista kualitative me përfaqësues të organizatave civile dhe të mediave, me qëllim që t'i hulumtojë praktikata, qëndrimet dhe problemet gjatë bashkëpunimit të ndërsjellë, por dhe të tregojë mekanizmat për intensifikimin dhe lehtësimin e komunikimit të përbashkët, e sidomos për promovimin e të drejtave të njeriut.

Në intervista kanë marrë pjesë 16 përfaqësues nga OC që punojnë në sferën e të drejtave të njeriut në vend, e që ishin paraqitur në thirrjen publike të cilën MIM e shpalli gjatë janarit të vitit 2013. Gjatë zgjedhjes së pjesëmarrësve në intervista mbahej llogari që të përfshihen OC që mbulojnë aspekte të ndryshme nga të drejtat e njeriut (të drejtat civile, të drejtat e grave, të të rinjve, të bashkësive të marginalizuara, të drejtat e romëve ...), të ketë balancë në përfshirjen e OC me përvojë dhe atyre më të reja, dhe të përfshihen OC që veprojnë në Shkup, por dhe në qytete të tjera të Maqedonisë. Në hulumtim kanë marrë pjesë këto OC: *Civil – Qendra për liri, Instituti për të Drejtat e Njeriut, ARA – Asociacioni Rajonal Akademik, LGBTI-Junajted, Porta e Hapur – “La Strada”, qendra memoriale “Nikolla Klusev”, Gazetarët për të Drejtat e Njeriut, Hapni Dritaret, Forumi i të Rinjve – Manastir, Iniciativa civile e grave “Klea” nga Manastiri, Organizata e Grave nga Sveti Nikolla, Agjencia Lokale për Zhvillim – Strugë, Roma SOS nga Prilepi, Rinia Demokratike nga Dellçeva, Qendra për ndihmë për personat me hendikep PORAKA nga Negotina dhe Multikultura nga Tetova.*

Plus kësaj, janë intervistuar edhe 13 gazetarë dhe redaktorë nga mediat e shtypura dhe elektronike në nivel nacional dhe lokal. Gjatë zgjedhjes, është shikuar që të përfshihen më shumë gazeta me ndikim (sipas tirazhit), për shkak se vetë projekti parasheh stërvitje për gazetari hulumtuese për gazetarë nga mediat e shtypura, ndërsa janë përfshirë edhe përfaqësues nga televizionet nacionale dhe disa lokale. Është mbajtur llogari që të ketë përfaqësues edhe nga mediat në gjuhën shqipe. Përfaqësues të këtyre mediave ishin pjesë e hulumtimit: *Dnevnik, Utrinski vesnik, Nova Makedonija, Koha, Fokus (gazetë ditore), MTV1, TV Sitel, TV Kanal 5, TV Alfa, Media diversiti (media onlajn), TV Koha nga Tetova, TV Vizija nga Prilepi dhe TV Iris nga Shtipi.*

Gjetjet nga ky hulumtim ishin pikë nistore për të shkruar Librin e Bardhë rreth prioriteteve dhe mekanizmave të përparimit të bashkëpunimit midis organizatave civile dhe mediave për mbrojtjen efikase të të drejtave të njeriut.

2. Gjetje kyç nga intervistat me përfaqësuesit e organizatave civile

1. Si shkas më të shpeshtë për bashkëpunim me mediat përfaqësuesit e intervistuar të organizatave civile e theksojnë informimin për aktivitetet projektuese të organizatave, transmetimin e reagimeve të caktuara të organizatave civile, ose dhënien e mendimeve nga ekspertët në lidhje me zhvillime të caktuara shoqërore që janë në fokus të punës së tyre, si dhe promovimin e vetë organizatave. Vetëm një numër i vogël i bashkëbiseduesve (vetëm tre prej 29) bashkëpunimin midis OC dhe mediave e shikojnë si mundësi për lobim të përbashkët për ndonjë objektiv civil, gjë që dëshmohet edhe në praktikë – rrallë vërehet “koalicionimi” ose shoqërimi i ndërsjellë i OC dhe mediave me qëllim që të bëhet presion ndaj institucioneve dhe opinionit publik.
2. Më shumë organizata civile janë deklaruar se tek ato ka njerëz që janë të obliguar për komunikim teknik me mediat (përgatitja dhe dërgimi i komunikatave, i ftesave dhe informatave dërguar mediave lidhur me punën e OC), e kur bëhet fjalë për të marrë pjesë në emisione për të dhënë deklarata dhe intervista për mediat, këtë më shpesh e bëjnë personat udhëheqës në organizata ose përgjegjësit e projekteve. Edhe krahas kësaj, përfaqësuesit e OC konsiderojnë se në media nuk jepet hapësirë e mjaftueshme për aktivitetet e OC, kështu që OC-të shihen në një nivel të pamjaftueshëm në publik.
3. Frekuenca e publikimit të informatave nga OC në media, sipas bashkëbiseduesve varet nga më shumë faktorë: nga aktivitetet që i realizojnë në një moment të caktuar, nga kontaktet personale të vëna me gazetarët, atraktiviteti i mysafirëve që janë pjesë e ngjarjeve që i organizojnë (përfaqësues të institucioneve, ministra, kryetarë komunash), politika redaktuese e mediave. Një pjesë prej tyre, si faktorë të rëndësishëm e tregojnë edhe politizimin e mediave dhe të shoqërisë në tërësi.
4. Përfaqësuesit e intervistuar të OC, në pjesën më të madhe konsiderojnë se mediat shpeshherë janë të interesuara për tema e tregime nga jeta dhe ngjarje sensacionale, të cilat do ta kishin tërhequr vëmendjen e publikut më të gjerë, ose tema që për momentin janë më të nxehta për qytetarët (“*Mediat interesohen vetëm po pati sensacion, përkatësisht informatë që ofron ‘gjak’*”). **Të vetëdijshëm për këtë, përfaqësuesit e OC thonë se shpesh nuk kanë mundësi që mediave t’u tregojnë personin ose tregimin konkret, për shkak se nga njëra anë duan që t’i mbrojnë pjesëtarët e grupeve të lëndueshme, ndërsa nga ana tjetër, ndërkaq, ata persona nuk janë të përgatitur për të dalë në publik shkaku i frikës se do të ballafaqohen me dënimin e mjedisit. Sipas një pjese të bashkëbiseduesve nga OC, mediat më shumë interesohen për politikë, “...sesa për problemet kyç të qytetarëve dhe konkretisht të grupeve të marginalizuara”.** Organizatat civile më lehtë e bëjnë bashkëpunimin me televizionet (sidomos me ato në nivel lokal, por edhe me ato në nivel nacional) sesa me mediat e shtypura, të cilat, sipas asaj që tregojnë, janë më inerte, në dallim nga mediat elektronike.

5. Bashkëbiseduesit bashkëpunimin me mediat e përshkruajnë në mënyra të ndryshme. Ata që kanë qëndrim negativ në lidhje me këtë bashkëpunim, konsiderojnë se mediat nuk janë të interesuara mjaftueshëm për atë se çka punojnë organizatat civile, shpeshherë takojnë gazetarë të papërgatitur dhe të painformuar për tema të caktuara, ose se *“gjithçka kthehet thjesht në transmetimin e informatave, pa kurrfarë analize, pa kurrfarë mundësie për ndonjë bashkëpunim plotësues”*. Problemet tjera, për të cilat bashkëbiseduesit konsiderojnë se e rëndojnë bashkëpunimin midis OC dhe mediave, janë: politizimi i mediave, interpretimi i gabuar i informatave në media, kërkesa për të paguar kompensimin për publikimin e informatave të OC, mediat shpeshherë promovojnë stereotipe dhe i përforcojnë paragjykimet ndaj disa bashkësive, si për shembull ndaj romëve. Bashkëbisedues të tjerë nga OC janë vetëkritikë dhe konsiderojnë se faji për bashkëpunimin e pamjaftueshëm me mediat duhet ta kërkojnë edhe te vetja, para së gjithash nga aspekti i mënyrës se si iu qasen mediave dhe si i paketojnë informatat kushtuar mediave. Përfaqësuesit nga OC, të cilët pozitivisht e përshkruan bashkëpunimin me mediat, theksuan se relacionet e mira janë rezultat i ngritjes së kapaciteteve për komunikim me mediat dhe për plasimin e informatave.
6. Pjesa më e madhe e bashkëbiseduesve nga OC konsiderojnë se ndikimi i sektorit civil në publik është shumë i vogël ose i pamjaftueshëm. Si shkak për këtë ishte theksuar ajo që OC-të shumë pak punojnë në ngritjen e imazhit të tyre (*“OC-të nuk arritën të bëhen zë i popullit; të tilla u bënë partitë politike”*), ndërsa mediat lënë hapësirë të pamjaftueshme për temat që lidhen me OC, edhe atë më shpesh në programet e mëngjesit, të cilat janë me qasje vetëm për një pjesë të vogël të popullatës (*“... ndikim kanë vetëm OC të cilat mjaftueshëm janë të pranishme në media...”*).
7. Në lidhje me atë se si mediat mund t’u ndihmojnë OC-ve në punën dhe në rritjen e ndikimit të tyre, aktivistët civil i kanë theksuar këto mënyra: dhënia më shumë hapësirë për tema që lidhen me OC; informimi profesional dhe i paanshëm për çështjet që janë të rëndësishme për qytetarët; trajtimi hulumtues i temave që i imponojnë OC-të; ndërtimi i marrëdhënieve të partneritetit me organizatat civile; përfshirja më e madhe në rrjetet sociale; transparenca më e madhe ndaj qytetarëve; përparimi i bashkëpunimit të ndërsjellë të OC; ngritja e kapaciteteve për bashkëpunim me mediat, por dhe stërvitja e vazhdueshme e përfaqësuesve nga të dy sektorët, me qëllim që të përmirësohet dukja e sektorit joqeveritar.
8. Një pjesë e madhe e OC të intervistuar deklaruan se kanë nevojë për stërvitje për përparimin e shkathtësive për komunikim me mediat dhe për mënyrën e paketimit të informatave për mediat (*“Kemi nevojë për stërvitje në lidhje me atë se si t’i bëjmë më interesante tregimet tona për mediat...; ueb-faqja është njëra prej mënyrave përmes së cilës ne promovohemi në publik dhe për këtë shkak duhet të jetë interesante dhe duhet të tërheq vëmendjen e disa gazetarëve...”*).
9. Më shumë aktivistë dhe përfaqësues të intervistuar nga mediat konsiderojnë se mbajtja e debateve të hapura, inkluzive dhe të vazhdueshme është njëra prej mënyrave për përmirësimin e komunikimit të ndërsjellë, për promovimin më të

madh të temave që janë me rëndësi qenësore për qytetarët, por dhe për përparimin e lirisë së shprehjes. Përfaqësuesit e intervistuar nga OC konsiderojnë se debati midis shoqërisë civile, mediave dhe institucioneve është i rrallë, jofunksional, parcial dhe i politizuar (*“Do ta kisha quajtur debat politik, që në të vërtetë është ngucje klasike, për shkak se një media e caktuar mbulon një organizatë, një tjetër media mbulon organizatën tjetër dhe ato ngucen ndërmjet vete”*).

11. Debati midis mediave dhe OC mund të përmirësohet përmes forcimit të kapaciteteve të gazetarëve për mbulimin e temave civile, iniciativa e tyre më e madhe për përfshirjen e sektorit civil në rubrikat informative, si dhe përmes përparimit të bashkëpunimit dhe të besimit të ndërsjellë. Një pjesë e bashkëbiseduesve të intervistuar nga OC konsiderojnë se mediat tek OC duhet të shohin burimin e mirë, të cilin do ta shfrytëzojnë më shpesh.
12. Pjesa më e madhe e bashkëbiseduesve konsiderojnë se liria e shprehjes në vend momentalisht është rrezikuar për shkak të ndikimeve politike ndaj mediave, gjë që shprehet ndaj dukjes së OC. (*“...mediat kanë të njëjtin drejtim dhe të njëjtën mënyrë raportimi, e cila më shumë është proqeveritare...; kjo ndikon shumë kur në pyetje janë lobimi dhe përfaqësimi”; “...OJQ ekzistojnë që të jenë korrektor i pushtetit, ta thonë atë që e mendojnë, dhe këtë t’ua thonë mediave, dhe në këtë mënyrë të depërtojnë te qytetarët. Mediat... duhet ta transmetojnë informatën, mirëpo ato ndonjëherë i selektojnë informatat varësisht nga interesat e padronëve të tyre”, theksojnë disa nga bashkëbiseduesit.*)
13. Problemin e politizimit edhe të OC edhe të mediave e hetojnë pothuajse të gjithë të intervistuarit nga të dy sektorët. Ata, në të njëjtën kohë, janë vetëkritikë, por edhe bëjnë vërejte për politizimin e sektorit tjetër – OC, përkatësisht mediave. Sektori civil ishte devaluuar me paraqitjen e së ashtuquajturës GONGO (ang. GONGO), të cilët paraqiteshin si zë për mbështetjen e politikave qeveritare, në shumë raste kur OC përpiqeshin që të bëjnë kritika konstruktive, siç theksohet në Indeksën e konsistencës së organizatave civile që e realizon USAID. Ky është njëri prej shkaqeve që OC dhe mediat kanë besim të vogël njëra me tjetrën. Një bashkëbisedues nga OC thotë: *“Mediat që janë nën kapuçin e pushtetit ... nuk duan të raportojnë për disa prej OC-ve...”,* ndërsa një gazetare nga një gazetë ditore bën vërejtje: *“...Ka ndarje të rreptë, ka disa (OC) që komunikojnë me ne, ndërsa të tjerat kontaktojnë me të tjerat, për ne janë plotësisht të mbyllura”.*
14. Pjesa më e madhe e përfaqësuesve të intervistuar të OC konsiderojnë se nuk ka njohje të mjaftueshme për të drejtat e njeriut në opinion dhe në media. Sipas tyre, kjo rezulton nga informimi i pamjaftueshëm i qytetarëve, si nga ana e mediave, ashtu edhe nga ana e sistemit arsimor. Disa bashkëbisedues konsiderojnë se mediat pamjaftueshëm, ose dhe gabimisht, i trajtojnë çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut (*“Të drejtat e njeriut trajtohen vetëm kur janë në pyetje temat e zezë, nëse ndokush ndokë e ka varrë, ose nëse bëhet fjalë për mosrespektim mbi bazë të përkatësisë racore, etnike ose tjetër...”*)

15. Pothuajse të gjithë përfaqësuesit e intervistuar e organizatave civile konsiderojnë se temat që lidhen me të drejtat e njeriut janë shumë pak të pranishme në media, në dallim nga ato politike. Shkaqet për këtë një pjesë e bashkëbiseduesve i vë në ndikimin politik ndaj mediave, politika redaktuese të mediave, mosinteresimin e mediave për sektorin civil dhe për të drejtat e njeriut në përgjithësi, si dhe në përfshirjen e pamjaftueshme të të drejtave të njeriut në sistemin arsimor.
16. Pjesa më e madhe e bashkëbiseduesve konsiderojnë se mediat duhet të lënë më tepër hapësirë për informatat që lidhen me të drejtat e njeriut, si dhe të kontribuojnë në edukimin e qytetarëve dhe në ngritjen e vetëdijes publike, përmes informimit profesional dhe gatishmërisë gjegjëse të gazetarëve për temat nga sfera për të drejtat e njeriut. Ishte theksuar se mediat duhet ta ndryshojnë qasjen drejt çështjeve që lidhen me të drejtat e njeriut: *“...së pari, duhet të vetëdijesohen pronarët e mediave se çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut janë aktuale gjithkund në botë dhe se janë baza e gazetarisë. Gjithashtu, duhet t’u shpjegohet (atyre) se trajtimi i të drejtave të njeriut mund t’ua rrit tirazhin po qe se gazetarët dinë t’i mbulojnë ato çështje.”*

3. Gjetje kyç nga intervistat me përfaqësuesit e mediave

1. Shkaku më i shpeshtë për bashkëpunim me organizatat civile, sipas përfaqësuesve të mediave, ka qenë promovimi i aktiviteteve të OC, kërkimi i mendimeve të ekspertëve prej tyre, kontaktimi i OC kur trajtohen tema me interes shoqërorë që shkaktojnë vëmendje më të madhe tek opinioni dhe shumë rrallë – fushata dhe aksione të përbashkëta ose prodhimi i tregimeve hulumtuese. Vetëm një redaktor televizioni theksoi se përmes bashkëpunimit midis mediave dhe OC mund të *“... nxisin institucionet që të krijojnë politika të caktuara”*, dhe të forcohet sektori civil *“për shkak se është me rëndësi në këtë shoqëri të polarizuar dhe të parëzuar që tu jepet hapësirë, të fitojnë zë, njerëz që janë jashtë këtyre zinxhirëve politik”*.
2. Më shumë redaktorë dhe gazetarë theksojnë se OC shumë më shpesh vetëm në nivel informativ në kohë u dërgojnë komunikata dhe porosi elektronike gjitha mediave, të cilat shpesh herë janë *“sterile dhe paketuara në mënyrë jocilësore”*, por rrallë ndodh që OC tu drejtohen mediave për të publikuar ndonjë rast, me të cilin do të shkaktojnë reagime në opinion. Kjo e hap problemin e përmbajtjes së komunikimit midis OC dhe mediave, përkatësisht dërgimi intensiv i informatave në formë të komunikatave nga ana e OC a ju leverdis mediave dhe informatat *“e paketuara”* kështu nga ana e OC a mund të arrijnë te publiku.
3. Në lidhje me publikimin e shpeshtë të informatave nga OC, gazetarët dhe redaktorët e intervistuar ishin të ndarë në vlerësime – një pjesë e tyre thanë se publikohen shumë shpesh, një pjesë publikojnë një informatë në javë varësisht nga aktualiteti i temës, ndërsa të tjerët thanë se ka pamjaftueshëm informacione nga sektori civil. Ishin theksuar më shumë faktorë prej të cilëve varet dinamika e publikimit të informatave nga OC: dinamika e aktiviteteve të OC dhe transparenca e tyre; sa janë atraktive informatat; aktualiteti i informatës; rëndësia e informatës më gjerë, për shoqërinë. Disa prej përfaqësuesve të intervistuar të mediave theksuan se informatat nga OC nuk publikohen edhe për shkak të asaj se ata nuk dinë se si t'i *“paketojnë”* informatat dhe si ta joshin gazetarin. Mediat shpesh herë janë *“të kujdesshme”* dhe bile dinë edhe *“të kërcejnë informatën”* që vjen nga OC nëse e dinë se ajo OC është e afërt me ndonjë parti politike. Politizimi i sektorit civil është problem të cilin pothuajse të gjithë të intervistuarit e theksuan.
4. Në redaksi redaktorët janë ata që i marrin vendimet ndonjë informatë nga sektori civil a do të publikohet dhe kjo varet nga më shumë faktorë: a është lajmi në pajtim me politikën redaktuese, a është interesant, a është me interes publik dhe a prek një numër më të madh njerëzish, a ka hapësirë të mjaftueshme në lajme. Gazetari nga gazeta ditore nga përvoja e tij në më shumë redaksi shpjegon se redaktorët marrin vendimet se çka do të publikohet: *“... problemi është aty se gjithkush me ndokënd është i qortuar. Dhe, tashmë, kam harruar se prej kujt guxoj të marr deklaratë e prej kujt nuk guxoj. Ndonjëri prej redaktorëve është i qortuar me X dhe*

... nuk guxoj të kërkoj informatë prej tij, në një situatë tjetër (redaktori) është i qortuar me Y, i treti është i qortuar me Z. Edhe të marrësh deklaratë, edhe të përpiqesh të bashkëpunosh, të bojkotojnë redaktorët, shefi... këtu i kemi duart e lidhura. Dhe ke: 'Po doli ndonjë raport prej tyre, mos e merrni parasysh, nuk publikohet'".

5. Në lidhje me praktikën në redaksi, ku intervistuar gazetarë dhe redaktorë, me rëndësi është të theksohet se nuk ka një gazetar që mbulon sektorin civil, por më shpesh aktivitetet e organizatave civile mbulohen varësisht nga sfera. Kështu, për shembull, po qe se fjala është për dhunë në familje, atëherë lajmin e mbulon gazetari nga kronika e zezë, po qe se fjala është për çështje që lidhen me ekologjinë, atëherë kjo është detyrë e gazetarëve nga kronika e Shkupit. Kjo në momente paraqet edhe për vetë gazetarët, por edhe për organizatat civile, për shkak se shpeshherë nuk dinë se kujt t'i drejtohen në redaksi po të duan që personalisht të kontaktojnë gazetarin.
6. Njëri prej problemeve në praktikën dhe komunikimin mes OC dhe mediave, të cilën gjë shumica e të intervistuarve nga të dy sektorët e theksojnë, është që edhe njëra edhe tjetra më shpesh reagojnë vetëm kur hapet ndonjë rast në opinion, përkatësisht ndonjë ngjarje bëhet aktuale. Përfaqësuesit nga të dy sektorët bëjnë vërejtje ndaj të tjerëve se duhet të jenë më konsistent dhe se nuk duhet reaguuar "sipas trendit", por OC duhet të jenë vazhdimisht të pranishme në publik me aksione dhe aktivitete, me mendime dhe reagime nga ekspertët, ndërsa mediat duhet të kenë më shumë iniciativa dhe të jenë më proaktive kur bëhet fjalë për hapjen dhe ndjekjen e temave.
7. Përshtypjet e të intervistuarve për bashkëpunim midis organizatave civile dhe mediave, ishin të ndara në tri grupe, secili me numër pothuajse të njëjtë përgjigjesh: 1. Ato që thanë se bashkëpunimi është "i shkëlqyeshëm", "korrekt", ose në "nivel të kënaqshëm"; 2. Ata që konsiderojnë se bashkëpunimi është korrekt, por i pamjaftueshëm; dhe 3. Ata që nuk janë të kënaqur nga bashkëpunimi me OC. Shumica e atyre që konsiderojnë se bashkëpunimi midis mediave dhe OC nuk është në nivelin e kënaqshëm thonë se ai tani është më i keq se sa dhjetëra vite më parë, për shkak se: një pjesë e OC nuk kanë PR të mirë ose kuadër të arsimuar për PR, nuk arrijnë që të gjejnë mënyra kreative se si të depërtojnë në media që janë të stërngarkuara me lajmet politike; "pasivitet" të sektorit në dallim prej më parë; politizim i sektorit civil; vetë gazetarët shpesh nuk e kuptojnë se sa janë të rëndësishme organizatat civile për shoqërinë.
8. Në lidhje me problemet eventuale në komunikimin midis mediave dhe organizatave civile, gjysma e të intervistuarve konsiderojnë se OC janë "relativisht të hapura" dhe "gjithnjë të arritshme për komunikim", ndërsa gjysma tjetër ka më shumë vërejtje për punën dhe karakterin e OC. Megjithatë, më shumë se ata që konsiderojnë se nuk ka problem në komunikimin me OC, megjithatë kanë pasur sugjerime për organizatat civile. Si ilustrim i kësaj një gazetar në një gazetë ditore ka thënë: *"...OC duhet të ndër marrin më shumë iniciativë, në kuptimin se duhet të imponojnë më shumë tema, sesa t'i ndjekin temat... të voziten në ato tregime, ta trajtojnë atë që*

është me aktualitet shoqëror, e të mos imponojnë tema relevante për diskutim. Në të vërtetë, reagojnë për gjëra që rëndom janë nxitur nga politikanët dhe personalitetet tjera shoqërore”.

9. Vërejtjet tjera drejtuar sektorit civil, të cilat me profesionistët e intervistuar të mediave i kanë bërë, janë: mosnjohja e logjikës së punës gazetareske, mospasja e mjaftueshme e aftësisë për “paketim” atraktiv të informatave (“*informata sterile dhe komunikata jo atraktive*”; “*...OC duhet që vazhdimisht të kenë stërvitje se si duhet të komunikojnë me mediat dhe të mund ta kuptojnë logjikën e funksionimit të mediave*”); u mungon transparenca dhe azhurniteti më i madh për promovimin e aktiviteteve dhe të aktivistëve; “pasivitet” i sektorit (“*nuk kanë iniciativë*”); vetëm informojnë, por nuk i shtynë tregimet që të marrin epilog (e njëjta vlen edhe për gazetarët); nuk kanë komunikim personal me gazetarët. Nga ana tjetër, ndërkaq, si vetëkritikë, gazetarët konsiderojnë se pak jepet hapësirë në media për OC; pranojnë se nuk ka gazetarë që merren më thellë me sektorin civil; nuk paraqesin iniciativë për hulumtimin e situatave dhe të rasteve. Por, problemi më i madh të cilin e theksojnë gazetarët dhe redaktorët e intervistuar është politizimi i sektorit mediatik (“*politika ka ndikim të madh në politikat redaktuese të mediave dhe kjo nuk lë hapësirë të mjaftueshme për trajtimin e OC*”) dhe të sektorit civil (“*ndarje e rreptë në OC, në partiake dhe jopartiake*”).
10. Më shumë nga të intervistuarit konsiderojnë se imazhi i organizatave civile në vitet e fundit në opinion seriozisht është devaluuar për shkak të ndikimeve politike në sektor, gjë që e ka çrregulluar “kredibilitetin” e tyre dhe ka shkaktuar “dyshim dhe mosbesim” në sektorin civil. Disa prej tyre konsiderojnë se në opinion ka mendim se OC ende nuk bëjnë mjaftueshëm për qytetarët. Dy të intervistuar, duke folur për përshtypjen që lënë OC, bile e përmendin edhe frazën “lavanderi për para”, me ç’rast njëri flet për atë se si kanë qenë të perceptuara në të kaluarën, ndërsa tjetri konsideron se kjo pamje ende është ashtu siç ka qenë. Megjithatë, disa prej të intervistuarve konsiderojnë se qytetarët me kalimin e kohës do ta ndjejnë se kanë nevojë për sektorin civil dhe se OC ngadalë shndërrohen në faktorë të respektueshëm në jetën publike.
11. Më shumë të intervistuar konsiderojnë se ndikimi i OC është shumë i vogël për shkak të politizimit edhe të sektorit mediatik, edhe të atij civil. Disa prej të intervistuarve konsiderojnë se OC kanë kapacitete, por s’e kanë fuqinë që të ndërmarrin aksione të caktuara ose të ndikojnë në mendimin publik (“*Ja, merreni si shembull AMAN-in, që arriti aty ku arriti dhe ja si mbaroi*”). Disa prej të intervistuarve konsiderojnë se OC duhet të jenë “*më agresive në nxjerrjen e qëndrimeve të tyre, por edhe ajo që do ta thonë duhet të jetë vërtet me rëndësi për shoqërinë*”. Disa theksuan se pa mbështetjen nga mediat, OC “*asgjë nuk mund të bëjnë po që se informatat e tyre nuk i prezantohen publikut*”.
12. U theksua se përmirësimi i ndikimit të OC nuk varet vetëm prej tyre, por edhe nga politika redaktuese e medias, nga situata politike dhe shoqërore përgjithësisht, si

dhe nga mbështetja nga institucionet. Të intervistuarit treguan disa mënyra se si OC ta përmirësojnë ndikimin në opinion: bashkëpunimi i vazhdueshëm me gazetarë të caktuar që i ndjekin aktivitetet e sektorit civil dhe zhvillimi i kontakteve direkte; prani më e madhe në publik *“jo vetëm përmes mediave, por dhe përmes terrenit”*; më shumë t’i shfrytëzojnë teknologjitë e reja gjatë shpërndarjes së informatave të tyre; të kenë njerëz të stërvitur për komunikim me mediat; të kuptojnë se *“... mediave ju nevojiten tregime ... (për) ngjarje, njerëz që mund të shkaktojnë interes te opinioni... t’i nxisin edhe ata njerëz me të cilët punojnë që të jenë të gatshëm të dalin me tregimin e tyre në publik...”*

13. Më shumë redaktorë dhe gazetarë me të cilët biseduam pajtohen se debatet midis përfaqësuesve të sektorit civil, institucioneve dhe mediave janë të rralla; në të shumtën e rasteve, organizohen në kuadër të ndonjë projekti; nuk ka praktikë të rregullt për përndarjen e mendimeve, ideve dhe qëndrimeve; mysafir janë në mënyrë individuale/parciale nga palët e prekura dhe nuk ka duel rreth çështjeve; shkëmbimi i mendimeve ndodh më shpesh në nivel individual. Nën ndikimin e politikës, hapësira në media ngushtohet për temat civile, ndërsa emisionet e debatit po hiqen nga ekranet, vërejnë disa prej të intervistuarve. Debatit në rrjetet sociale është i rekomandueshëm, por ka rreze të kufizuara. Me qëllim që të përparohet debati, gazetarët dhe redaktorët konsiderojnë se vetë mediat duhet të iniciojnë më shumë përmbajtje, ku do të jetë i pranishëm sektori civil me temat e veta dhe duhet të organizojnë emisione debatuuese për të gjithë, *“e jo vetëm për bashkë mendimtarët”*. Ndërkaq, organizata civile duhet të demonstrojnë konsistencë, aktivitet dhe transparencë më të madhe ndaj gazetarëve dhe ndaj publikut.
14. Redaktorët dhe gazetarët konsiderojnë se OC mund të kontribuojnë në punën e tyre, së pari *“duke i ushqyer”* me informata, me analiza, ekspertiza, hulumtime relevante, e më pas si iniciator potencial të tregimeve hulumtuese, duke iu treguar kështu persona që do të flasin në tregime ose do të sigurojnë material relevant. OC duhet t’u sigurojnë mediave lidhje më të mirë me qytetarët dhe me problemet e tyre.
15. Përparimi i lirisë së shprehjes duhet të jetë imperativ gjatë bashkëpunimit midis organizatave civile dhe mediave, gjë që do të arrihet po qe se *“OC vazhdimisht kritikojnë publikisht dhe totalisht janë të hapura, pa kurrfarë prangash”*, po qe se edhe njëra palë edhe tjetra nxisin debat dhe ballafaqim mendimesh për probleme thelbësore, të cilat doemos duhet të zgjidhen. Megjithatë, të intervistuarit konsiderojnë se me shumë rëndësi është që të përparohet edhe liria e shprehjes në vetë mediat, gazetarët të shfrytëzojnë burime informacionesh të cilat politikisht janë neutrale, të shfrytëzohen mundësitë që i ofrojnë rrjetet sociale etj.
16. Përgjithësisht, përshtypje personale e më shumë gazetarëve dhe redaktorëve është se nuk ka vetëdije mjaft të ngritur për të drejtat e njeriut në publik, ndërsa qytetarët nuk i dinë mjaftueshëm të drejtat e tyre, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për të drejtat e konsumatorit, të drejtat në procedura gjyqësore, keqpërdorimin e fuqisë

së policisë etj. *“I tërë tregimi për të drejtat e njeriut komplet është i marginalizuar në media”*, thotë një gazetare në një gazetë ditore.

17. Shkaqet për këtë mund të vihen edhe te mediat edhe te sektori civil. Temat që lidhen me të drejtat e njeriut nuk janë mjaft të pranishme në media, për shkak se lajmi nuk është mjaft *“sensacional”* (*“përveç se në situata të shkeljes flagrante të të drejtave të njeriut”*); gazetarët në nivel të pamjaftueshëm i njohin dhe i identifikojnë situatat e shkeljes së të drejtave të njeriut; nuk ka qasje sistematike në trajtimin e tregimeve me adresë shkeljen e të drejtave të njeriut (ndjekja sipas trendeve dhe *“me fushata”* të rasteve, në nivelin e transmetimit të informatave); nuk ka gazetari hulumtuese nëpër redaksi; temat nuk trajtohen në mënyrë adekuate (*“Të drejtat e njeriut trajtohen vetëm nëse janë në pyetje tema të zeza, nëse ndokush e ka vrarë ndokë, ose nëse bëhet fjalë për mosrespektim mbi bazë racore, etnike, ose të një përkatësie tjetër...”*).
18. Përfaqësuesit e mediave konsiderojnë se sektori civil duhet t’ia dalë me ndikimet politike, të cilat përbëjnë rrezik për perceptimin e përgjithshëm që ndërton publiku ose që veç e ka për OC-të. Gazetarët u ankuan se shpeshherë nuk mund *“të gjejnë më shumë se një a dy veta që do të kishin folur në ndonjë temë”*, ose se nuk i njohin ekspertët nga sektori civil, për shkak se disa prej tyre shpeshherë nuk duan të flasin publikisht. Ata rekomanduan për OC-të që në mënyrë konstante ta ndjekin gjendjen me të drejtat e njeriut dhe të bëjnë presion ndaj mediave që t’i mbulojnë këto tregime. Shkakun për përfshirje të pamjaftueshme të të drejtave të njeriut në media disa prej gazetarëve dhe redaktorëve të intervistuar e shohin edhe në transparencën e pamjaftueshme të institucioneve.
19. Mediat, sipas më shumë të intervistuarve, mund të ndihmojnë në promovimin e të drejtave të njeriut, ashtu që do të kenë qasje proaktive dhe do të ndajnë më shumë hapësirë për temat, për informatat dhe aktivitetet që lidhen me të drejtat e njeriut. Një redaktor televizioni në nivel nacional konsideron se *“në esencën e mediave”* është promovimi i të drejtave të njeriut, por qasja duhet të jetë me gazetari analitike dhe hulumtuese (*“...t’i dënoj /unë/, t’i zbuloj, t’i demaskoj të gjitha gjërat që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut...”*). Përveç nevojës për gazetari hulumtuese, si sugjerime konkrete u theksuan edhe iniciimi, përkatësisht nxitja e debateve në media, si dhe promovimi i aktivizmit qytetar.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE: PËRSE SHKRUHET KY LIBËR I BARDHË?	3
HYRJE	5
I.1. ORGANIZATAT CIVILE DHE MEDIAT	6
I.2. KORNIZA NORMATIVE DHE MEKANIZMAT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT.....	8
I.3. GJENDJA ME TË DREJTAT E NJERIUT NË MAQEDONI.....	11
I.4. AMBIENTI SHOQËROR-POLITIK KU REALIZOHEN TË DREJTAT E NJERIUT.....	14
Prioritetet e bashkëpunimit midis organizatave civile dhe mediave në sferën e të drejtave të njeriut	23
II.1. PRIORITETET NË SFERËN E TË DREJTAVE CIVILE DHE POLITIKE.....	24
II.2. PRIORITETE NË SFERËN E TË DREJTAVE TË GRAVE.....	32
II.3. PRIORITETE NË SFERËN E TË DREJTAVE TË ROMËVE DHE TË PJESËTARËVE TË BASHKËSIVE JOSHUMICË NË MAQEDONI.....	42
II.4. PËRPARËSI NË SFERËN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME PENGESA ZHVILLIMORE.....	50
II.5. PRIORITETET NË SFERËN E TË DREJTAVE TË PJESËTARËVE TË POPULLATËS LGBTI.....	55
II.6. PRIORITETE NË SFERËN E TË DREJTAVE TË TË RINJVE.....	60
II.7. PRIORITETE NË SFERËN E TË DREJTAVE DIGJITALE.....	64
REKOMANDIME PËR PËRPARIMIN E BASHKËPUNIMIT MIDIS ORGANIZATAVE CIVILE DHE MEDIAVE	75
III. 1. REKOMANDIME PËR ORGANIZATAT CIVILE.....	76
III. 2. REKOMANDIME PËR MEDIAT.....	80
III. 3. REKOMANDIME PËR BASHKËPUNIM MIDIS OC DHE MEDIAVE.....	83

Gjetje kyç nga hulumtimi kualitativ i qëndrimeve dhe perceptimeve të përfaqësuesve nga organizatat civile dhe mediat për bashkëpunimin në sferën e të drejtave të njeriut.....	85
1. Shkurtimisht për hulumtimin.....	86
2. Gjetje kyç nga intervistat me përfaqësuesit e organizatave civile	87
3. Gjetje kyç nga intervistat me përfaqësuesit e mediave	91

